



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0035074/26 dt. 18.06.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për **të hënën** më dt. **29.06.2026**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
(Mbledhja e 9-të)

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2027/2029
3. Propozim Vendim Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit
4. Rregullimi dhe harmonizimi i numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore
5. Raport mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026
6. Raport i punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025
7. Raporte të komisionit për vlerësim të dëmeve ne rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera
8. Raporti vjetor i menaxhimit të mbeturinave Komunale për vitin 2025
9. Raportet në Lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
10. Informatë për gjendjen në Shëndetësi
11. Informatë e Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026
12. Pyetje dhe përgjigje

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021467/26 dt. 29.04.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës

Seanca e 8-të

Koha: 29.04.2026, ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: kryesAnëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Egzon Hamza, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Lavdim Zeneli, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Syl, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Xhylljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Igballe Islami

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, anëtarët të Kuvendit, organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, media dhe të pranishmit tjerë. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit i Kuvendit theksoi Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, në cilësinë e Kryesuesi i Kuvendit të Kuvendit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 8-të të rregullt të Kuvendit të Komunës, me rend dite siq është paraparë me thirrje (lexoi rendin e ditës), dhe e hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Kushtrim Zeneli: Përshëndetje për të gjithë. Kërkoj të mbahet një minutë heshtje në nderim të veprimtarit të çështjes kombëtare, i cili sot ka ndërruar jetë, bacës Ajete Uka.

Ajete Uka lindi në vitin 1945 dhe ndërroi jetë në vitin 2026. Ishte ushtar i UÇK-së, bashkëluftëtar i Bekim Berishës dhe Bedri Shalës, si dhe një nga aktivistët më të hershëm të Lëvizjes Vetëvendosje dhe i veprimtarisë ilegale për çështjen kombëtare. Ishte një prej atyre burrave që historia nuk i shënon me fjalë, por me vepra. Në vitin 1998 ishte i angazhuar në rrugët e furnizimit me armatim në Shqipëri. Më 17 korrik u përball me pritën e forcave serbe dhe nuk u tërhoq aty ku shumë të tjerë do të ndaleshin. Ai qëndroi i fortë në luftë dhe i palëkundur në paqe. Ishte kryeplaku i “Shqiponjave të Arta”, një njeri gjithmonë i qartë në qëndrime dhe shembull i sakrificës së heshtur. Sot nuk humbëm thjesht një njeri, por një epokë të qëndrësës. Ngushëllime familjes, bashkëluftëtarëve dhe të gjithë atyre që e njohën bacën Ajete.

Kryesuesi i Kuvendit: Falënderoi Kushtrimin për diskutimin e tij i ftoi të gjithë të pranishmit që me një minutë heshtje të nderojnë jetën dhe veprën e ish-ushtarit Ajete Uka.

Lavdi!

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, sa i përket pikave të rendit të ditës: Meqenëse kemi pranuar një vlerësimin e ligjshmërisë për Vendimin Nr. 02-60/01-0014451/26, Për formimin e komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomike-sociale të familjeve përfituese të banesave apo shtëpive që janë në pronësi ose menaxhim të komunës, rezultoi se ka disa vërejtje të cilat kërkojnë plotësim-ndryshim të këtij vendimi. Prandaj, kërkoj që kjo çështje të futet si pikë e 16 e rendit të ditës, A ka dikush propozime tjera lidhur me rendin e ditës?

Valon Brahimi: Para rreth një javë kam marrë një informacion se në fshatin Kqic të Madh, familjes së Sinan Haxhës i është djegur shtëpia, nuk po kërkoj që kjo çështje të futet sot si pikë e rendit të ditës, por do të ishte e

arsyeshme që një komision nga drejtoria përkatëse të shkojë në terren, ta vizitojë rastin dhe të vlerësojë mundësitë për ndihmë. Kërkesa e dytë është që të futet si pikë e rendit të ditës, ashtu siç jemi dakorduar në mbledhjen e KPF-së, diskutimi për gjendjen në arsim, për shkak të mungesës së madhe të stafit nëpër shkolla dhe humbjes së konsiderueshme të orëve mësimore për nxënësit. Po ashtu, kërkoj që propozim-vendimi për shfuqizimin e vendimit lidhur me çështjen e shujtave të tërhiqet sot nga rendi i ditës, me qëllim që të analizohet më mirë dhe të rikthehet në një seancë të ardhshme. Duhet të jemi të vetëdijshëm se, edhe pse ekzistojnë aspekte ligjore që duhen marrë parasysh, jemi në një periudhë inflacioni dhe një vendim i tillë mund të ndikojë drejtpërdrejt tek rreth 250 zyrtarë të komunës. Nuk e vlerësoj si moment të duhur për të vepruar në këtë fazë. Prandaj, propozoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës për sot dhe të rishqyrtohet nga ekzekutivi para se të rikthehet në kuvend. Ne e dimë që ekzekutivi i ka të dhënat dhe numrat, por po ashtu duhet të kemi parasysh që qytetarët dhe zyrtarët e administratës komunale na vëzhgojnë të gjithëve. Ata nuk na kanë votuar që të përkeqësojmë gjendjen e tyre ekonomike apo financiare. Këta zyrtarë nuk preken vetëm individualisht; ata janë prindër dhe pjesë e familjeve, dhe çdo vendim i tillë ndikon edhe tek më të afërmit e tyre. Me këtë mirëkuptim, kërkoj nga kryesuesi dhe Kryetari që kjo pikë të tërhiqet për sot dhe të analizohet më thellë. Duhet të shqyrtojmë mundësitë, përfshirë edhe rishikimin e buxhetit, pasi sipas disa shkresave kjo çështje mund të rregullohet dhe të vazhdojë njohja e të drejtave që i kanë gëzuar deri më tani.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Të nderuar anëtarë të asamblesë, drejtorë, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit, sa i përket pikave të rendit të ditës, unë si Kryetar i komunës kam një propozim për përfshirje të një pike të re. Propozimi im ka të bëjë me raportin teknik mbi rrëshqitjen e dheut në Lagjen Bair. Të gjithë jemi dëshmitarë të problemit të shkaktuar si rezultat i vërshimeve të vitit 2023. Dëmet e shkaktuara për një numër të konsiderueshëm të ekonomive familjare, si dhe në infrastrukturë, janë të mëdha. Mendoj që si institucione mund të jemi të vonuar, duke pasur parasysh se po flasim për një periudhë prej tre vitesh. Ky raport duhet të jetë pjesë e diskutimit dhe aprovimit, për të shqyrtuar më pas mundësitë e kompensimit, fillimisht nga institucionet qendrore, të cilat kanë kapacitete më të mëdha financiare, dhe më pas edhe nga ekzekutivi në të ardhmen. Kjo është një çështje me interes të madh për një numër të konsiderueshëm të familjeve që janë prekur nga rrëshqitja e dheut dhe dëmet në ekonominë familjare dhe infrastrukturë. Nëse më lejohet, do të ndërlihem edhe me kërkesën për tërheqjen e pikës së rendit të ditës që ka të bëjë me çështjen e shujtave. Ne kemi pranuar dhe jemi në dijeni për një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht në rastin nr. KO79/23, në të cilin është përcaktuar se kompensimi i shujtave për administratën bie ndesh me tre ligje: Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. Prandaj, vlerësoj se kjo nuk është më çështje interpretimi apo diskutimi, përderisa mekanizmat gjyqësorë kanë nxjerrë një vendim të qartë dhe kanë konstatuar se bëhet fjalë për shkelje ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë kam edhe një propozim lidhur me rendin e ditës. Meqenëse në seancën e parafundit kemi marrë vendim për themelimin e komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit, por në dy thirrjet që kam bërë për konstituimin e këtij komisioni nuk kemi arritur ta bëjmë këtë, për shkak të angazhimeve të anëtarëve dhe mungesës së përgjigjes nga ana e tyre, së paku sipas informatave që kam. Megjithatë, në bashkëpunim me sekretarinë, përkatësisht me sekretarin e Kuvendit, kemi hartuar planin e punës së Kuvendit për vitin 2026. Në fakt, edhe në të kaluarën ky plan kryesisht është përgatitur nga sekretaria, ndërsa komisioni më shumë e ka formalizuar atë. Planin e kemi përcjellë dje edhe te ekzekutivi, i cili ka dhënë vërejtjet e veta për përfshirjen e disa çështjeve në kuadër të këtij plani. Prandaj, kërkoj që plani i punës së Kuvendit për vitin 2026 të futet si pikë e rendit të ditës dhe të aprovohet si i tillë.

Xhylljeta Imeri: Kam një kërkesë nga banorët e fshatrave Vidimriq dhe Suhodoll, të cilët po përballen me mungesë të theksuar të një linje të transportit për në qytet, ndryshe nga lagjet dhe fshatrat e tjera këtyre banorëve kjo jo situatë po ua vështirëson ndjeshëm jetën. Duke marrë parasysh që një prind me një fëmijë e ka shumë të vështirë të udhëtojë drejt qytetit, kjo bëhet një barrë e madhe për ta. Udhëtimi me taksi ka kosto të lartë dhe është i papërbalueshëm për shumicën e familjeve. Për shembull, vetëm një udhëtim në relacionin Vidimriq – Mitrovicë kushton 5 €, pra 10 € vajtje-ardhje, pa llogaritur sa shpesh lind nevoja brenda ditës. Banorët jo të gjithë kanë vetura, prandaj sigurimi i transportit publik do ta lehtësonte dukshëm jetën e banorëve, duke marrë parasysh këtë gjendje, kërkoj që të ndërmerren hapa konkretë për riaktivizimin e një linje transporti për këto dy fshatra, drejtoritë përkatëse mund të kontaktojnë kompanitë që operojnë brenda qytetit, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje sa më e shpejtë dhe efikase.

Kushtrim Zeneli: Kam një kërkesë, ndoshta drejtuar juve. Në seancat e kaluara, si dhe në legjislaturën e kaluar, e kemi ngritur këtë çështje në fillim, por nuk kemi arritur ta zgjidhim, besoj që edhe kolegët e asamblesë janë në dijeni se kjo është në interes të të gjithë anëtarëve kuvendit, të gjithë asamblistëve komunalë, por edhe të drejtorëve. Për shembull, sa kam njohuri, ne kemi një marrëveshje me TV Mitrovicën që seancat e Kuvendit Komunal të publikohen. Prandaj, do të propozoja që incizimi që bëhet nga TV Mitrovica të lidhet drejtpërdrejt me transmetimin e seancës në

YouTube. Arsyeja është se gjatë transmetimit në YouTube, cilësia e zërit dhe grafika janë dukshëm më të dobëta krahasuar me transmetimin në TV Mitrovica. Kështu që, si sugjerim, nëse ekziston mundësia për ta lidhur drejtpërdrejt me transmetimin e TV Mitrovicës, do të ishte shumë më e përshtatshme. Kjo do të ndikonte pozitivisht edhe në promovimin e punës së ekzekutivit, por edhe të legjislativit.

Kryesuesi i Kuvendit: Me aq sa kam informata, seanca e Kuvendit transmetohet drejtpërdrejt, pasi janë të vendosura kamerat dhe e kemi edhe obligim ligjor që seanca të transmetohet live, si për shkak të Ministrisë së Pushtetit Lokal, ashtu edhe për shkak të transparencës ndaj qytetarëve. Sa i përket çështjeve teknike, përkatësisht rezolucionit dhe cilësisë së transmetimit, besoj që mund të diskutojmë më tej dhe të shohim, nëse ka hapësirë, çfarë mund të përmirësohet në bashkëpunim me IT-në.

Gjergj Beka: Atëherë, ne e kemi pikën e nëntë për shfuqizimin e pagesës së shujtave. Vetëm desha të kërkoj një sqarim. A bëhet fjalë për të njëjtën shkellje edhe në rastin e pagesave për Kryetarët e këshillave? Pra, nëse ato aprovohen, a bien në të njëjtën kategori shkelljeje? Gjithashtu, nuk e kam të qartë nëse këto pagesa janë të buxhetuara sipas ligjit vjetor, ashtu siç është cekur në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Kryesuesi i Kuvendit: Po e lidh me çështjen e kompensimeve për anëtarët e këshillave, por besoj se në këtë drejtim nuk ka shkellje ligjore. Sido që të jetë, mendoj që nëse vendimi i Kuvendit aprovohet si i tillë, atëherë është rregull të procedohet më tutje. Ky është një propozim që ka ardhur, dhe disa komuna të tjera e kanë gjetur formën e kompensimit. E vërteta është se, nëse ky vendim kalon në Kuvend, ai i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë në ministrinë përkatëse. Nëse ministrinë konstaton se vendimi është në rregull, ne vazhdojmë më tutje. Nëse konstatohet se është në kundërshtim me ligjin, atëherë ai rikthehet në Kuvend dhe shfuqizohet, dhe ne nuk vazhdojmë më tutje. Megjithatë, mendoj se është në interes të anëtarëve të Kuvendit që ky vendim të kalojë së paku këtë fazë dhe të shihet më tutje si do të vlerësohet nga aspekti i ligjshmërisë.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Sa i përket çështjes së ngritur për shqetësimin rreth transportit publik për fshatin Vidimriq, mendoj se kjo është një shqetësim në nivel komunal, jo vetëm i një fshati të vetëm. Sa i përket kalkulimit të kostos financiare për udhëtim në Vidimriq, sinqerisht nuk e kam të qartë si është bërë ky vlerësim, por e kuptoj shqetësimin e ngritur. Njëra prej zotimeve të mia, për të cilat jemi duke punuar, është ofrimi i transportit publik jo vetëm për Vidimriqin, por për të gjitha fshatrat e komunës së Mitrovicës, me tendencë dhe synim që në të ardhmen të zgjerohet edhe përtej komunës në raste specifike, jo vetëm për zonat kufitare, por edhe për fshatra të tjera si Çabër, Boletin, Zhazhë dhe të tjerë. Pra, qëllimi nuk është i kufizuar vetëm në një fshat, por në një sistem më të gjerë të transportit publik që do t'i përfshijë të gjitha zonat që kanë vështirësi në këtë aspekt. Po ashtu, jemi duke punuar në përgatitjen e dokumentacionit për themelimin e dy ndërmarrjeve publike, të cilat do të përfshijnë edhe këtë komponent të transportit, në mënyrë që të ketë zgjidhje afatgjate dhe të qëndrueshme. E marr si shqetësim të drejtë atë që u ngrit, dhe është pjesë edhe e prioritetëve tona për trajtim dhe zgjidhje si problem i përgjithshëm komunal.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 16-të e rendit të ditës shfuqizimin e vendimit nr. 02-60/01-0014451-11/26, përkatësisht për plotësim-ndryshimin e këtij vendimi.

Rezultati i votimit: 30 anëtarë të pranishëm, 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se propozimi u miratua unanimisht.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 17-të të rendit të ditës Raporti teknik për rrëshqitjen e dheut në Lagjen Bair, Mitrovicë (2023–2026), si dhe vlerësimi i dëmeve, analiza e shkaqeve dhe rrezikut për banorët.

Rezultati i votimit: 30 anëtarë të pranishëm, 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se propozimi u miratua unanimisht.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 18-të të rendit të ditës Plani i punës së Kuvendit.

Rezultati i votimit: 30 anëtarë të pranishëm, 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se propozimi u miratua unanimisht.

Materialet për planin e punës dhe për shfuqizimin, përkatësisht plotësim-ndryshimin e vendimit, ju janë përcjellë edhe në email, dhe besoj se keni pasur mundësi t'i shihni se për çfarë bëhet fjalë. Po ashtu, kemi pasur edhe një kërkesë nga z. Brahimi që gjendja në arsim të futet si pikë e rendit të ditës. Valon, nëse jemi në pajtim me planin e punës siç është planifikuar, apo dëshiron që së paku t'i jepet hapësirë drejtorit që kjo çështje të trajtohet në seancën e ardhshme, fillimisht në komitet e pastaj në Kuvend si pikë e veçantë?

Valon Brahimi: Ne nuk jemi që “me e vendos gurin sot dhe mos me lëviz më tutje”, por seriozisht po flasim për një mungesë të madhe të stafit mësimor nëpër shkollë. Tash, Kryetari e din mirë këtë situatë, pasi ka pasur edhe përvoja në sektorin e arsimit, por realisht nxënësit po mbesin pa zëvendësim në shumë raste. Në disa shkollë, ku janë emëruar drejtorë nga procesi arsimor, nuk është siguruar zëvendësimi i orëve dhe nxënësit po mbesin pa mësim. Ne

nuk po e bëjmë këtë për kritikë personale, por për faktin që nxënësit nuk duhet të mbesin pa përkujdesje dhe pa orë mësimore. Prandaj, a pajtoheni që kjo çështje të procedohet në rregull dhe të trajtohet si duhet? Ne po kërkojmë që në seancën e ardhshme të vijë një raport nga Drejtoria Komunale e Arsimit, me rekomandimin tonë që të bëhen përpjekje serioze që të mos humben orët mësimore.

Shefki Begu: Me gjithë respektin, nuk është e saktë siç u tha, ne kemi mungesë të kuadrit, por nuk kemi orë të humbura, domethënë nuk është se po humben orë mësimore. Ekziston mungesë e stafit për arsye se nuk kemi mundur të hapim konkurs, pasi qarkorja buxhetore nuk na e ka lejuar, duke marrë parasysh që aktualisht kemi 37 mësimdhënës më shumë të punësuar nga periudhat e mëhershme. Pra, këto janë të dhëna zyrtare që i kemi në dispozicion.

Valon Brahimi: Lëndët mjekësore, për shembull në vend të deputetit Sulejman Mehulli, 10 orë nuk i zëvendëson askush. Po ashtu, lëndët praktike në vend të mentorëve/profesorëve në disa raste nuk kanë zëvendësim adekuat. Nëse thuhet që zëvendësohen, atëherë kërkoj të jepen emra konkretë se kush i zëvendëson. Po flasim për raste specifike, jo në përgjithësi. Po ashtu, lëndët teorike dhe praktike në vend të Albinës, drejtoreshës, nuk kanë zëvendësim të rregullt. Në ekonomi dhe ndërmarrësi, për shembull në vend të Murselit, 20 orë nuk zëvendësohen nga askush. Thuhet që ka zëvendësime vetëm për tre-katër orë, ndërsa pjesa tjetër mbetet pa mbulim. Nëse ekzistojnë zëvendësues konkretë, atëherë kërkoj të na jepen emrat e tyre. Në atë rast, edhe unë e pranoj dhe kërkoj falje nëse kam gabuar në vlerësim.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Unë, që nga seanca e parë e datës përkatëse, kam theksuar se në parim e përkrahim çdo iniciativë të opozitës dhe të asamblistëve që ka për synim raportimin dhe informimin. Madje, si drejtor, ua kam përsëritur vazhdimisht se për çdo cent duhet të jenë të përgatitur të raportojnë për mënyrën e shpenzimit, dhe kësaj i qëndroj deri në seancën e fundit të këtij mandati. Prandaj, çdo iniciativë apo ide që kërkon raportim për gjendjen, mënyrën e menaxhimit të resurseve dhe aspektet financiare, e ka përkrahjen time deri në përfundim të mandatit. Sa i përket çështjes tjetër, nuk besoj se është e arsyeshme të pritet nga një drejtor që të dijë me emra të përveçëm zëvendësimet për mungesat e mësimdhënësve. Kjo është një kërkesë që e vë drejtorin në një pozitë të vështirë dhe jo reale për t'u përmbushur menjëherë. Unë jam përkrahës i plotë i transparencës, mirëpo nuk mendoj se është e drejtë që një drejtor të vihet menjëherë përballë përgjegjësisë duke i kërkuar emra konkretë në atë moment. Nëse drejtori deklaron se nuk po humben orë dhe se po bëhen zëvendësimet, atëherë për seancën e radhës ai duhet të sigurojë raport të detajuar, përfshirë edhe emrat, duke i mbledhur të dhënat nga secili drejtor i shkollës veç e veç. Në këtë mënyrë, do të kemi një pasqyrë më të qartë dhe besoj se do të arrijmë të adresojmë, në masën e mundshme, shqetësimin tonë lidhur me zëvendësimet, veçanërisht për profilet dhe kuadrot që janë angazhuar në ekzekutiv. Drejtor, ju faleminderit dhe kërkoj ndjesë nëse ndërhyra në diskutimin tuaj, por e bëra me qëllim që të përafrojmë qëndrimet dhe ta qartësojmë këtë pjesë të diskutimit. Për këtë çështje do të diskutojmë më gjerësisht edhe në seancën e radhës.

Valon Brahimi: Unë, me shumë mirësjellje, e shtrova këtë si një problem dhe, me mirëkuptim të plotë, pranova që për seancën e ardhshme të na vijë një raport më i detajuar. E kuptoj se drejtori mund të ketë tendencë që ta ketë informacionin e saktë dhe është mirë që e posedon atë, aq më tepër duke qenë se sot kishte disa informacione. Megjithatë, kur pyeta nëse mund të jepen emrat konkretë të atyre që po bëjnë zëvendësimet, e bëra këtë duke qenë në dijeni se në disa raste zëvendësimet nuk janë realizuar. Me këtë nuk kam për qëllim ta bëj përgjegjës drejtorin, por që kjo çështje të trajtohet seriozisht. Prandaj, drejtori duhet të merret me këtë problematikë dhe në javën e ardhshme të na paraqesë një raport të detajuar, në mënyrë që situata të jetë e qartë dhe në rregull për të gjithë.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë po vërej një hezitim nga ana e anëtarëve të Kuvendit, ndërkohë që besoj se kjo është një çështje që secili prej jush e ka ngritur vazhdimisht në zyrë, konkretisht çështja e laptopëve të mandatit të kaluar. Nuk po flas në emër të gjithëve, por ju lutem të më lejoni ta përfundoj atë që e nisa. Pra, bëhet fjalë për laptopët e legjislaturës së kaluar, për të cilët dihet se, sipas standardeve të vlerësimit nga viti në vit, vlera e tyre aktuale është zero. Megjithatë, duke qenë se ata janë të evidentuar si pronë komunale, anëtarët e Kuvendit kanë obligim që, në gjendjen në të cilën ndodhen, t'i dorëzojnë tek Kuvendi, përkatësisht tek pronari. Nga ana tjetër, ka pasur edhe vendime të mëhershme të Kuvendit, përmes të cilave është vendosur që këta laptopë të falen, me qëllim të lirimit, në aspektin ligjor, të anëtarëve të legjislaturës së kaluar nga kjo përgjegjësi. Po ashtu, ka pasur raste kur kryesuesi i Kuvendit dhe sekretari i Kuvendit janë penalizuar për shkak të mosdorëzimit të këtyre laptopëve. Duke pasur parasysh këtë situatë, si dhe kërkesat tuaja të vazhdueshme për t'u liruar nga kjo ngarkesë, konsideroj se kjo çështje duhet të trajtohet në mënyrë të qartë.

Prandaj, propozoj që kjo të futet si pikë e rendit të ditës dhe të diskutojmë se si të veprohet më tutje me çështjen e laptopëve. Konkretisht, propozoj që të formulohet si pikë e veçantë, ku të obligohet komisioni për zhvlerësim që të bëjë zhvlerësimin e laptopëve të legjislaturës së kaluar, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim propozimin që të hyjë si pikë e 19 të rendit të ditës propozim vendimi me të cilin obligohet komisioni i komunës për zhvlerësim që të bëjë zhvlerësimin e laptopëve të legjislaturës së kaluar, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Rezultati i votimit: 30 të pranishëm, 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se propozimi u miratua.

Xhyljeta Imeri: Unë kërkoj që në seancën e ardhshme drejtori i financave të na sqarojë të gjithëve lidhur me këtë çështje. Unë e kam marrë informatën pse nuk mund të zëvendësohen mësimdhënësit apo kushdo tjetër në vendin e punës nga një ekspert i nivelit qendror, por ne kemi nevojë që kjo të na sqarohet më detajisht në seancën e ardhshme. Sipas njohurive që kam, për shembull, një mësimdhënës nuk mund të zëvendësohet për arsye se numri është i kufizuar dhe ai numër nuk mund të zëvendësohet me një tjetër. Këtë nuk e lejon qarkorja buxhetore për shkak të nivelit qendror, e cila e ka krijuar këtë praktikë që po na shkakton barriera në të gjitha komunat. Prandaj kërkoj që të sqarohet edhe rasti konkret, për shembull në shkollën time, ku orët e drejtorit të arsimit zëvendësohen nga një mësimdhënëse dhe ato paguhen si shtesë. Kërkojmë që kjo çështje të na sqarohet.

Kryesuesi i Kuvendit sa i përket kësaj, kjo mundet të kompletohet kur të na vjen informata në seancën e radhës. Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim rendin e ditës të plotësuar ai në vijim:

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
2. Draft-Rregullorja për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale
3. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake, në vitin 2026
4. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, Kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026
5. Propozim vendim për subvencionimin e fëmijëve me autizëm
6. Propozim vendim për vendosjen e pllakës përkujtimore heroit Driton Velu
7. Propozim vendim për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës
8. Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005630-18/26, dt. 10.02.2026 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve
9. Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010
10. Kërkesa e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
11. Kërkesa e Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
12. Kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
13. Kërkesa e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare
14. Raport financiar për periudhën janar-mars 2026
15. Raport i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në biznese nga vërshimet
16. Vendim Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të komunës Nr. 02-060/01-0014451-11/26 dt. 27.03.2026 Për Formim të Komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomike-sociale të familjeve përfituese të banesave apo shtëpive të cilat janë në pronësi apo në menaxhim të Komunës
17. Raportit teknik mbi rrëshqitjen e dheut në Lagjen Bair, Mitrovicë (2023-2026)
18. Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026
19. Propozim Vendimi për obligimin e komisionit të komunes që të bëjë zhvlerësimin e laptopëve të legjislaturës së kaluar, në përputhje me rregulloret në fuqi.
20. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimisht miratoi rendin e ditës, të plotësuar.

Pika 1

Në vijim, Kryesuesi i Kuvendit njoftoi kalimin në pikën e parë të rendit të ditës, e cila kishte të bënte me miratimin e procesverbaleve nga mbledhja e kaluara. Hap për diskutim.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim e hedh në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, në sallë janë të pranishëm 29 anëtarë.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e kaluar u miratua unimishtë.

Pika 2

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket Draft-rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregullores nr. 01/2022 për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e administratës komunale. E shpall të hapur diskutimin rreth kësaj pike. Atëherë, nëse nuk ka diskutim rreth kësaj çështjeje, unë e qes në aprovim.

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se me votë unanime është miratuar Rregullorja 01/2026 për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e administratës komunale.

Pika 3

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për Propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe viteve paraprake, të cilat barten për vitin 2026.

Shkëlqim Ibrahim: Konsideroj që si dokument ka nevojë për rikthim dhe kompletim, sepse për të qenë i suksesshëm realisht nuk është një dokument i kompletuar dhe është kontradiktor, qoftë në aspektin e kontinuitetit të strukturës apo të ndërthurshmërisë. Kam dëshirë të diskutojmë kategori për kategori. Për shembull, te kategoria e parë kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime në nënprogramet e programit i referohemi nenit gjashtë, pika tre, të Ligjit për ndarjet buxhetore, që ka të bëjë me arsimin. Shumë specifikisht aty thuhet qartë se të hyrat vetanake komunale nga arsimi regjistrohen veçmas dhe si të tilla shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të arsimit. Domethënë, ligjërisht të hyrat vetanake që inkasohen në arsim duhet të përdoren vetëm për çështje të linjave të arsimit. Pyetja ime është: a është respektuar parimi i destinimit të hyrave vetanake? Për shembull, te pika 1.1 të arsytimit që keni dhënë, teknikisht i keni vendosur si 2.1, 2.2, 2.3 pra edhe ndërthurshmëria teknikisht është gabim. Ju jeni thirrur te neni për të hyrat vetanake të arsimit, ndërsa arsytimin e keni dhënë për hartimin e projekteve për investime kapitale. Cilat projekte kapitale? A kanë të bëjnë me arsim apo janë jashtë fushës së arsimit? Sepse aty është trajtuar mirëmbajtja e qendrave, ndriçimi, mirëmbajtja verore domethënë nuk është respektuar parimi i destinimit, kjo është çështje ligjore. Në pjesën tjetër, në shumicën e zërave të kategorive të paraqitura në dokument nuk tregohet burimi i saktë i mjeteve, nuk specifikohet cilat janë projektet konkrete, si duhet të financohen, nuk ka emra rrugësh, as numra rrugësh. Po ashtu mungon tabela sintetizuese ku tregohet burimi i të hyrave vetanake, nga ku kanë ardhur dhe ku do të destinohen. Ju kisha sugjeruar, drejtor, që shumë lehtë mund të merrni një vendim të vitit të kaluar dhe t'i hidhni një sy, ku shpjegohet baza ligjore, respektohet parimi i destinimit të hyrave vetanake, dhe konkretisht tregohet a janë kontrata aktive, a janë kontrata të reja, a janë projekte të reja. Po ashtu, nga bartja e tyre do të pritej të kishte një destinim edhe për çështje të vërshimeve por nuk është menduar fare për vërshime. Prandaj, drejtor, kam tre pyetje: Nëse mendoni që ky dokument është i kompletuar, a është respektuar parimi i destinimit të hyrave vetanake? Pse nuk janë bashkangjitur tabelat sintetizuese që lidhin burimin dhe destinimin e mjeteve? A është ky dokument vazhdimësi e kontratave aktive, apo paraqet borxhe të trashëguara dhe projekte të reja?

Valon Brahimi: Kisha kërkuar që te çështja e bartjes e të hyrave vetanake, një pjesë e tyre jo pjesa dërmuese të shkojë në shëndetësi dhe në arsim, sepse nga materialet që na janë shpërndarë nuk kam parë diçka konkrete në këtë drejtim. Pjesa tjetër kisha kërkuar që të ndiqet praktika, jo pse e kemi bërë ne, por për shkak se ka nevojë. Kur themi “qeverisja e kaluar”, nuk e themi për krahasim, por sepse ka nevojë qytetari i Mitrovicës që një pjesë e tyre të shkojë edhe për ndarje prej 100 € për familjet me asistencë sociale. Këtë praktikë e ka zbatuar edhe niveli qendror, duke ndarë nga 100 €. Mirë do të ishte që një pjesë të ndahet edhe në komunë, sepse kjo praktikë ka qenë e mirë.

Armend Begu: E thanë që mu u ndjek praktikat e tyre mirëpo për t'i ndjekur praktikat e tyre duhen shumë para. Për shembull, këtu përmenden 100.000 € për qentë endacak, ndërsa ju i keni shpenzuar 800.000 €. Domethënë, ne tani duhet të ndajmë 800.000 € për qentë endacak që t'i ndjekim praktikat tuaja. Këto janë praktikat tuaja.

Xhyljeta Imeri: Edhe unë kam pritur që nga këto të hyra vetanake të destinohet një pjesë për vërshimet. Unë kam dhënë një propozim në seancën e kaluar që 80% të subvencionohen për vërshimet. Domethënë, për secilën do të ishte e barabartë, sepse nëse caktohet një shumë e caktuar, nuk del e barabartë për secilën. Diku i bie rreth 640.000 €, por kjo mbetet të vendosni ju si ekzekutiv. Unë dua të ndalem tek pika 2.1. Hartimi i projekteve për investime kapitale – nevojiten 110.000 €. Më intereson për cilat projekte keni menduar të destinohen këto mjete. Pastaj, mirëmbajtja e

ndriçimit publik – 120.000 €. Janë të planifikuara edhe 126.000 € për këtë vit nga viti i kaluar. Unë kërkoj që në këtë kategori të bëhet ndriçimi në tunelin e parë ku gjenden 23 shtylla të ndriçimit publik dhe në hyrje të ndërtesave kolektive në këtë lagje. Tek riparimi dhe rregullimi i rrugëve dhe shesheve, më herët keni planifikuar rreth 300.000 €, ndërsa tash keni kërkuar 120.000 €. Unë kisha kërkuar që këtu të përfshihet edhe ndërtimi i rrugës Ymer Berisha, tek stadiumi Adem Jashari, të cilën qytetarët janë detyruar para disa javësh që me mjete vetanake t'i mbulojnë gropat, por prapë kanë filluar të dëmtohen. Gjithashtu, tek larja dhe fshirja e rrugëve 120.000 €. Më intereson a keni menduar të angazhoni ndonjë kompani të re apo t'i destinohet njësisë ekzistuese? Si keni menduar të shpenzohen këto mjete? Kurse tek 75.000 € që janë ndarë për bursat e studentëve janë shumë të arsyeshme dhe të qëlluara. Por unë mendoj dhe kërkoj nga ekzekutivi që së paku 10.000 € të ndahen për tabela digjitale nëpër shkolla, sepse as në buxhetin e këtij viti nuk janë planifikuar. Kryetar, ato janë shumë të rëndësishme. Ju e dini vetë, keni dhënë edhe premtim. Së paku 10.000 € të ndahen nga kjo shumë për tabela digjitale për shkolla. Po ashtu, për klubet më intereson: nga shërbimet kulturore janë kërkuar 80.000 €. Më intereson për cilat klube keni planifikuar të ndahen këto mjete?

Kushtrim Zeneli: Atëherë po i shkojmë pak me radhë dhe me argumentim, si dhe me arsyetimin e votës sime si asamblist pse e mbështes këtë pikë. Së pari, këtu bëhet fjalë për vendime që prekin drejtpërdrejt sigurinë, jetën dhe mirëqenien e qytetarëve, jo për shpenzime të zakonshme. Menaxhimi i katastrofave natyrore dhe pajisja e zjarrfikësve me mjete profesionale është obligim institucional, nuk mund të flasim për siguri publike nëse zjarrfikësit dhe ekipet emergjente nuk kanë pajisjet e nevojshme për reagim të shpejtë në rast zjarri, vërshimesh apo fatkeqësish të tjera. Trajtimi i qenve endacakë është bërë çështje e rëndë publike, me qindra ankesa dhe raste kafshimesh. Kjo nuk është më vetëm çështje komoditeti, por është çështje sigurie dhe shëndeti publik që kërkon zgjidhje serioze dhe të qëndrueshme. Por në këtë pikë është e domosdoshme të flasim edhe për përgjegjësi dhe transparencë, sepse nuk mund të vazhdojmë me vendime të reja pa sqaruar mënyrën se si janë shpenzuar mjetet e mëhershme. Për menaxhimin e fatkeqësive natyrore ka ekzistuar kontratë trevjeçare në vlerë prej 500.000 €, e cila sipas informacioneve është shpenzuar brenda vetëm një muaji. Kjo nuk është çështje teknike, por është çështje serioze e menaxhimit të parasë publike dhe kërkon përgjigje të qarta: ku kanë shkuar ato mjete dhe çfarë ka mbetur realisht në terren?

Po ashtu, për trajtimin e qenve endacakë ka pasur kontratë prej 315.000 €, ku janë raportuar kosto të larta për grumbullim dhe trajtim. Sot duhet të pyesim qartë: sa ka qenë efekti real i asaj kontrate, sa qen janë trajtuar dhe pse qytetarët ende e kanë të njëjtin problem në rrugë? Prandaj, nëse opozita ka dilema për këtë bartje, le të na tregojë: a janë kundër investimeve në zjarrfikësit, në siguri publike apo në zgjidhjen e problemit që prek çdo qytetar? Ndriçimi publik: Edhe pse është në rregullim e sipër, propozoj që të mirëmbahen zonat ku ka pasur kërkesa të përsëritura, si tek zona e Frashërit, ku janë shtëpitë e ndërtuara nga Jetimat e Ballkanit dhe organizata islamike "Relief" apo Katari. Pra, edhe pse është në proces, mirëmbajtja duhet të vazhdojë. Ujësjellësi në zonat periferike: Ne e diskutuam edhe me drejtorin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës. Në legjislaturën e kaluar, Kryetari i atëhershëm kishte ndarë 50.000 € për zonën e Vllahisë, Mazhiqit, Rashanit dhe Tërstenës për funksionalizimin e pompave të ujësjellësit, dy vite rresht janë ndarë ato mjete, por kurrë nuk është bërë asnjë investim. Prandaj propozoj që sipas mundësive, këto të parashihen nga të hyrat vetanake ose, nëse jo, të përgatiten si projekt në buxhetin e shtatorit për funksionalizimin e pompave, vlera e tyre është rreth 50.000 €, këtu po flasim për ujë për nevoja bazike dhe kemi detyrim institucional për funksionim të rregullt.

Prandaj, këto vendime nuk besoj që duhet të bllokohen, por të mbështeten, për interesin dhe funksionimin normal të shërbimeve bazike në komunë.

Shkëlqim Ibrahim: Kushtrim, krejt projektet që i përmende janë të mira dhe ne jemi për me ecë përpara, jo për me i blloku. Unë veç e kontestova bazën ligjore, te pika 1.1. aty thuhet që të hyrat nga arsimi duhet me u destinua prapë për arsim, ndërsa projektet që i keni paraqit nuk lidhen drejtpërdrejt me arsimin. Nuk jam kundër asnjë projekti, përkundrazi janë projekte të mira dhe vazhdimësi e punës së komunës. Veç duhet me qenë më specifik sipas ligjit: cilat janë projektet? për cilat rrugë apo ndriçime bëhet fjalë? dhe cili është destinimi i mjeteve?. Keni përmend 110.000 € për projekte kapitale, por duhet me u sqarua saktë prejardhja dhe destinimi i të hyrave. Nëse kjo arsyetohet dhe argumentohet ligjërisht, atëherë ne jemi në rregull. Shqetësimi im është vetëm te formulimi dhe baza ligjore e nenit 1.1, sepse janë përmend të hyra nga arsimi, ndërsa projektet nuk lidhen veç me arsimin.

Erseka Barani: Unë kam një kërkesë shumë simbolike, por me një peshë shumë të madhe. Kam një kërkesë për mbështetje financiare dhe sociale për viktimat e dhunës në familje në komunën e Mitrovicës. Duke pasur parasysh rritjen e vazhdueshme të rasteve të dhunës në familje dhe pasojat e rënda që kjo dukuri lë mbi viktimat, sidomos gratë dhe fëmijët, konsideroj se është obligim institucional dhe moral i komunës së Mitrovicës që të ndërmarrë masa konkrete dhe të menjëhershme për mbështetjen e tyre. Viktimat e dhunës në familje shpesh përballen jo vetëm me trauma fizike dhe psikologjike, por edhe me vështirësi të mëdha ekonomike. Shumë prej tyre detyrohen të largohen nga shtëpitë e tyre pa asnjë burim financiar, pa strehim dhe pa mundësi për të siguruar nevojat bazike për veten dhe

fëmijët e tyre. Studimet dhe raportet në Kosovë kanë theksuar se mungesa e mbështetjes ekonomike është një nga arsyet kryesore pse viktimat shpesh detyrohen të rikthehen te dhunuesi. Për këtë arsye kërkoj nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale të Komunës së Mitrovicës që të ndajë një fond të veçantë për subvencionim të njëhershëm prej 250 € për secilën viktimë të dhunës në familje, si mbështetje emergjente për përballimin e shpenzimeve fillestare dhe krijimin e një sigurie minimale. Ky subvencion i njëhershëm do të ishte një hap i rëndësishëm drejt fuqizimit të viktimave dhe rikthimit të dinjitetit të tyre, duke u mundësuar të sigurojnë ushqim, barna, veshmbathje dhe nevoja të tjera urgjente. Praktika të ngjashme janë zbatuar edhe në komuna të tjera të Kosovës. Për shembull, në Prishtinë ofrohet mbështetje direkte dhe subvencionim i qirasë për viktimat e dhunës në familje. Po ashtu, ka subvencionim mujor të qirasë për viktimat e kësaj kategorie. Gjithashtu kërkojmë që viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre të lirohen nga bashkëpagesa në kopshtet publike, duke marrë parasysh gjendjen e tyre të rënduar ekonomike dhe psikologjike. Fëmijët e këtyre familjeve janë ndër më të prekurit nga pasojat e dhunës dhe kanë nevojë për një ambient të sigurt, edukativ dhe social, pa krijuar barrë shtesë financiare për nënat apo kujdestarët e tyre. Një tjetër kërkesë thelbësore është mbulimi i pagesës së qirasë për viktimat e dhunës në familje për një periudhë të caktuar kohore, deri në stabilizimin e gjendjes së tyre sociale dhe ekonomike. Sigurimi i strehimit është një nga faktorët kyç që i ndihmon viktimat të mos rikthehen në ambientin e dhunës. Raportet për Kosovën theksojnë se subvencionimi i qirasë ka ndikim të drejtpërdrejtë në riintegrimin e këtyre viktimave dhe në shmangien e riviktimizimit. Gjithashtu dua ta theksoj se kjo kërkesë nuk është e rastësishme. Angazhimi im për trajtimin e çështjes së viktimave të dhunës ka filluar qysh gjatë mandatit tim si shefe e kabinetit, si drejtoreshë e shëndetësisë, si dhe gjatë mandatit tim si asambleiste në mandatin e kaluar. Fatkeqësisht, në atë kohë këto kërkesa nuk janë realizuar. Urojmë që këto mjete të mos kenë nevojë asnjëherë të shfrytëzohen për këtë kategori të ndjeshme. Mirëpo, sipas statistikave të marra nga Qendra “Raba Voca”, për vitin 2025 janë evidentuar 29 viktima të dhunës në familje për komunën e Mitrovicës. Meqenëse kjo qendër është strehimore rajonale, prej tyre janë 13 nëna dhe 16 fëmijë. Kjo nuk do të paraqiste barrë të madhe për komunën e Mitrovicës, por do të ishte një lehtësim shumë i madh për këtë kategori të ndjeshme. Prandaj kërkoj që kjo çështje të trajtohet me prioritet dhe të përfshihet në buxhetin komunal përmes Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, meqenëse besoj se ka hapësirë për këtë, në mënyrë që viktimat e dhunës në familje në komunën e Mitrovicës të kenë mundësi për një fillim të ri, të sigurt dhe dinjitoz.

Naser Muja: Sa i përket pyetjes së asamblistit Shkëlqim Ibrahim, të hyrat vetanake komunale nga arsimit regjistrohen veçmas. Domethënë, këtu kemi të bëjmë jo me të hyrat për arsim, por me të hyrat që regjistrohen veçmas dhe nuk kanë të bëjnë me ndarje të të hyrave vetanake për arsim. Duhet me qenë të qartë në këtë pikë: këto të hyra nuk kanë të bëjnë absolutisht me arsimin. Të hyrat e arsimit janë të ndara veçmas dhe nuk përfshihen në shumën që është për ndarje në këtë rast. Ato janë të regjistruara ndaras dhe nuk lidhen me këtë proces. Këto të hyra janë krijuar nga drejtoritë e tjera, si urbanizmi, shëndetësia, mirëqenia sociale dhe të tjera, por nuk kanë të bëjnë me të hyrat e arsimit. Prandaj, duhet me u kuptu saktë në titull dhe në përmbajtje. Për pjesën tjetër, unë mund të sqaroj më tutje, por për këtë çështje është kjo.

Kryesuesi i Kuvendit: Vazhdo të lutem z. Muja.

Naser Muja: Në mungesë të hartimit të projekteve për investime kapitale, ne si komunë nuk mund të zhvillojmë asnjë procedurë. Këtu nuk është e paraparë saktë se çka përfshin hartimi i projekteve për shkolla, çerdhe apo rrugë. Çdo ndërtim që bëhet duhet me pasë projekt të veçantë, nuk mund të zhvillohet asnjë projekt pa hartim paraprak të tij. Ne e kemi gjetur gjendjen pa hartim projektesh dhe ka qenë e domosdoshme me u ndërmarrë kjo. Investimi i parë që është dashur me u bë ka qenë pikërisht kjo. Edhe kontrata e parë që është tentuar me u lidhë ka qenë për hartimin e projekteve. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve, larjes dhe fshirjes, e kemi planifikuar që të bëhet përmes një njësie të veçantë dhe jo përmes një kompanie tjetër. Ndërsa riparimi i rrugëve, gropave dhe shesheve hyn në kategorinë e mirëmbajtjes dhe shërbimeve. Në kohën kur kam ardhur, e kam gjetur gjendjen pa planifikim paraprak për mallra dhe shërbime. Totali i planifikuar për vitin 2026 ka qenë 790.000 €, ndërsa sipas planifikimit të mëhershëm ka qenë rreth 1.900.000 €. Për këtë arsye është kërkuar që mjetet të rishpërndahen sipas nevojave reale. Kemi mbetur me rreth 400.000 € nën planifikimin paraprak. Sa i përket ndriçimit publik, bëhet fjalë për mirëmbajtje, jo zgjerim, është planifikuar mirëmbajtja e ndriçimit në gjithë qytetin e Mitrovicës dhe fshatra, nuk është e nevojshme të specifikohet çdo rrugë, sepse intervenimet bëhen sipas defekteve dhe kërkesave që paraqiten. Funkcionalizimi i rrjetit të ujësjellësit është një çështje tjetër, aktualisht nuk kemi kontratë aktive për këtë, kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga ujësjellësi, por edhe ata kanë vështirësitë e tyre. Është planifikuar që në vitin 2027 të bëhet një kontratë për rrjetin e ujësjellësit në përgjithësi, dhe për këtë gjithmonë nevojitet projekt. Domethënë, asnjë veprim nuk mund të bëhet pa projekt, sepse ligji që ka hyrë në fuqi kërkon që gjatë planifikimit të ketë projeksion për tre vite për me u zhvillu procedura, nëse mungon edhe një pjesë e vogël e buxhetit, nuk mund të lidhet kontrata pa u siguruar realizimi i plotë trevjeçar. Nëse keni pyetje të tjera, unë jam i gatshëm me u përgjigj. Deri më tani jam duke vepruar me kontratat ekzistuese dhe me

ato që duhet të lidhen për zhvillimin e komunës. Hartimi i projekteve për investime kapitale është domosdoshmëri dhe për këtë nuk kemi pasur lëvizje të mjaftueshme më herët.

Valon Brahim: Nuk e di nëse jeni në informacion, por Rruga e Malit në Fshatin Kqiç i Madh është asfaltuar. Në atë kohë ka qenë në rregull dhe është bërë investimi siç është paraparë. Mirë që është asfaltuar, por ndërkohë, për shkak të operatorëve të gurthyesve, ajo rrugë është dëmtuar. Pyetja ime është: a e keni paraparë që edhe ajo rrugë të rinovohet, në kuadër të mundësisë së bartjes së të hyrave edhe në pjesën e infrastrukturës?

Naser Muja: Po, e di saktë rrugën dhe kam qenë në vizitë para rreth një jave. Ajo rrugë është dëmtuar nga operatorët e gurthyesve, në kuadër të renovimit dhe riparimit të rrugëve, ajo rrugë hyn dhe trajtohet si çdo rrugë tjetër pa asnjë problem. Ne jemi të gatshëm me u dalë në ndihmë çdo qytetari dhe me trajtu çdo kërkesë që parashtrohet.

Artan Berisha: Edhe unë e kam një pyetje për z. Muja. Pyetja është për Kqiç tek familjet e Shoshollëve lartë. Pra a keni planifikuar ndonjë ndërhyrje për kanalizim, sepse gjendja atje është vërtet shumë e rëndë.

Naser Muja: Unë e di gjendjen, nuk them 100% sikur ti që e di që je aty, por e di situatën dhe problemet e rrugëve dhe kanalizimeve që janë këtë vit. Vetëm nëse marrim ndonjë përkrahje nga ministria, sepse nuk mund të realizojmë kanalizime të reja, ndërhyrje mund të bëjmë, por për kanalizime të reja nuk mund të jap premtim.

Rinesa Preteni: Sa i përket qëllimit të shfrytëzimit të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake, ne përshëndesim vendimin që përmes këtyre mjeteve të komunës është bërë e mundur rritja e vlerës së bursës komunale nga 630 € në 720 €, si dhe rritja e numrit të përfituesve të bursës. Po ashtu, përshëndesim edhe subvencionimin e klubeve sportive, duke marrë parasysh se Mitrovica është qytet i artit, kulturës dhe sportit. Kjo nënkupton vazhdimësi në zhvillimin e sportit dhe forcimin e traditës sportive në qytet. Në këtë kuadër, duhet theksuar se subvencionimet në vitin 2025 thuajse nuk kanë ekzistuar, dhe praktikisht asnjë klub sportiv nuk ka marrë mbështetje komunale.

Xhyljeta Imeri: Ju lutem drejtorë, vetëm për rrugën “Ymer Berisha” te stadiumi që e kam cekur më herët. Besoj që e keni harruar.

Naser Muja: E theksova se pa u alokuar këto mjete, pra me kalimin e këtyre mjeteve, lidhet kontrata dhe pastaj dalim në terren për ta bërë projektin, do të mundohemi që në një kohë sa më të shkurtër të mundshme ta realizojmë, sepse kemi shumë kërkesa për hartimin e projekteve dhe jemi të hendikepuar në lëvizje pa kontratën në fjalë.

Ramdan Beshiri: Fillimisht, rasti i djegies së shtëpisë së Sinan Xhafës më është adresuar nga z. Fatmir Saliu, përfaqësues i fshatit Kqiç. Është duke u trajtuar dhe e kemi diskutuar edhe me drejtoreshën e emergjencave, si dhe do ta diskutojmë edhe me drejtorin e urbanizmit për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme, duke marrë parasysh edhe kufizimet buxhetore. Sa i përket çështjes së dytë, ndihma prej 100 € për familjet me asistencë sociale ka qenë politikë e z. Bedri Hamza. Politikat tona sociale janë të orientuara në programe të qëndrueshme, me qëllim që qytetarët të dalin nga skema e asistencës sociale. Pra, ne synojmë t'i stimulojmë qytetarët që të bëhen vetë produktivë. Dëgjo, është shumë e shëndetshme opozita me pas reagim. Edhe unë kam qenë opozitar shumë i ashpër dhe e kuptoj këtë rol. Por ne, si Lëvizja Vetëvendosje, jemi demokraci sociale. Ne jemi të thirrur për të ndihmuar familjet me asistencë sociale, por sipas planit të punës dhe buxhetit që kemi, nuk e kemi paraparë ndihmën prej 100€ për familje, por programe që i nxjerrin nga asistenca sociale dhe i bëjnë më vetëproduktive. Nëse ju jeni më të përgatitur, mund të provoni ndryshe. Sa i përket kategorive të tjera, jemi fokusuar në mbështetjen e fëmijëve me autizëm dhe kategori të tjera që kanë nevojë për subvencione të drejtpërdrejta. Sa i përket përkrahjes së viktimave të dhunës në familje, tashmë i kemi dërguar rekomandimet për krijimin e mekanizmave dhe fondit emergjent për dhunë, siç parashihet edhe me ligj. Së shpejti do të përurohet “Shtëpia e Sigurt” në Frashër, e cila do të shërbejë për gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë. Po ashtu, kemi siguruar edhe grant qeveritar për strehimoren e fëmijëve, dhe gradualisht po e kompletojmë arkitekturën sociale në Mitrovicë, në përputhje me programin e Lëvizjes Vetëvendosje. Sa i përket bartjes së të hyrave vetanake, për shërbime sociale janë bartur 50.000 € për shkak të obligimeve të pashlyera nga viti i kaluar dhe ky vit, për subvencionimin e varrimeve të qytetarëve përmes Bashkësisë Islame.

Valon Brahim: Unë e vlerësoj çdo angazhim pozitiv që bëni në funksion të përmirësimit të jetës së komunitetit. Ju e thatë se ka qenë praktikë e Bedri Hamzës ndarja prej 100€. Ne mendojmë që duhet të rritet bartja e të hyrave në drejtori dhe të shpërndahet më shumë për familjet që përfitojnë nga asistenca sociale, pra jo vetëm 100€. Ne nuk jemi kundër kësaj ndihme, por nëse synoni përmirësim të kësaj praktike, atëherë ajo mund të rritet në 450€ për familje me asistencë sociale. Kërkesat tona përfshijnë edhe arsimin, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale. Po ashtu, nëse merren parasysh edhe çështjet e ngritura, përfshirë rregullimin e rrugës së Malit, qëndrimi im do të ishte pro; në të kundërtën, do të jem kundër.

Bajram Istrefi: Le të shqyrtohet mundësia buxhetore, në rast se ka hapësirë që të përfshihet përmes bartjes së të hyrave buxhetore, kërkesa e banorëve tek Rruga “Ramë Uka”, e cila nuk është shtruar asnjëherë, ka pasur kërkesa dhe peticione nga banorët, por asnjëherë nuk është rregulluar. Gjithashtu, Rruga “Sami Gashi” ka nevojë për trotuar, pasi nxënësit e shkollës “Skënderbeu” çdo herë rrezikohen në atë rrugë. Unë kërkoj që të rishikohet buxheti me

mundësi dhe të punohet ky projekt, si dhe të shikohen rrugët të cilat duhet të përfundojnë si projekte. Jo si në qeverisjen e z. Bedrisë, ku në rastin e Rrugës “Shkodra” u mbyllën edhe ujëmbledhësit me asfalt.

Shkëlqim Ibrahim: Krejt esenca erdhi në fund, domethënë të dilema që e pata unë: me i pas të emëruar në kuadër të bartjes së të hyrave. Me qenë me numër, nuk do të kishte asnjë pyetje, sepse do të dihej ku po shkojnë paratë. Domethënë, tash po diskutohet për buxhet, për mundësi devijimi. Ky është dokument i bartjes së detyrave, janë vlera fikse, ti nuk mundesh me devijuar jashtë kuadrit të ligjit. Edhe te çështja e destinimit që tha drejtori, unë nuk po e kuptoj logjikën pse u përdor ai nen, a nuk ka qenë e mundur të mos jetë fare. Nëse do të bëhej, do të kishim mësuar diçka bashkërisht. Nëse mundeni, më korrigjoni te projektet kapitale, drejtor: cilat të hyra shkojnë? Cilat të hyra ke të drejtë t’i destinoni për projekte kapitale, prej cilit burim kanë të drejtë të destinohen për investime kapitale?

Naser Muja: Është problemi që tregova, te investimet kapitale ndoshta nuk është dashur të bëhen gjithashtu investime që janë të parashikuara në buxhetin e këtij viti. Për shembull, Rruga “Ali Zeneli” është parashikuar me vlerë rreth 340.000 €, por ne mund të shpenzojmë vetëm 150.000 €, ajo ka ngecur, dhe me dëshirën time më të madhe do të kisha thënë që aty të hiqej prej asaj ndarjeje. Por te buxheti, domethënë te kapitalet, nuk mund të bëj ndryshime më shumë se 10%. Mund të bëhen vetëm ndryshime të kufizuara, dhe ato në përputhje me ligjin, për këtë arsye, këtu mund të destinohen aty ku kemi kërkesa më të mëdha. Domethënë, të hyrat vetanake mund të destinohen në ato kode ku është kërkesa. Të thashë edhe më herët ka qenë një kërkesë prej 1.000.000 €, por ajo është ndarë për arsye se drejtorët kanë pasur kërkesa të tjera. Prandaj, për të vazhduar tutje, kjo ndarje që kemi bërë deri tani është maksimumi që ka qenë e mundur.

Shkëlqim Ibrahim: Më fal, por drejtor, nuk po e ke të qartë pyetjen. Krejt projektet i ke të mira dhe të aprovuara, ishalla ecin përpara, unë vetëm po të pyes: cilat janë të hyrat vetanake? A janë nga tatimi në pronë, nga financat apo nga shëndetësia? Sa është shuma që mund të destinohet? Nuk po flas për përqindjen 10%. Nëse ti nuk e di destinimin, atëherë ka me t’u kthyer mbrapsht. Është e domosdoshme të kemi një vijë të qartë. Nëse thua se janë prej arsimit ose prej shëndetësisë dhe i destinon në investime kapitale, kjo është brenga ime. Përndryshe, krejt projektet le të ecin, sepse janë të mira për shtetin. Nuk po flas vetëm për Rrugën “Ali Zeneli”, por për të gjitha projektet. Ideja është kjo, a i ke shumën për secilën të hyrë, ku kemi destinuar? Nëse thua për investime kapitale, sa janë të hyrat vetanake që keni destinuar aty? Sepse të hyrat e tjera nuk ke të drejtë t’i përdorësh ligjërisht.

Naser Muja: Drejtoria e Financave duhet të jetë ajo që e përcaktojnë, por është edhe MAPL që, nëse ne kemi bërë gabim në hapa, ajo na kthen mbrapa. Patjetër, unë e di që gjithçka duhet të jetë në rregull, sepse Drejtoria e Financave nuk e fillon procedurën nëse nuk është në përputhje me ligjin. Janë zyrtarë që merren me atë çështje dhe e kontrollojnë me kujdes.

Visar Sylja: Kështu, vetëm një koment sa i përket kësaj çështjeje: po bëhet fjalë për hartimin e projekteve, trajtimin e qenve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen verore, larjen dhe fshirjen e rrugëve, riparimin dhe rregullimin e rrugëve, si dhe sinjalizimin rrugor. Pra, këtu po flasim për shërbime. Nuk ka investime kapitale, sepse këto të hyrat shkojnë vetëm për shërbime. Edhe drejtori besoj se nuk e pat të qartë pyetjen sepse këtu ka të bëjë vetëm me shërbime, investime kapitale nuk ka.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Unë kam një lutje për kolegët, kur të diskutojmë, të dëgjojmë njëri-tjetrin, posaçërisht atë që ka mikrofonin, për shkak të transmetimit, interesimit të qytetarëve dhe respektit kolegjial. Nuk po them këtë për të marrë anë apo në mbrojtje të drejtorit, por e dëgjova me kujdes dhe, aq sa arrita të dëgjoj, nuk përdori asnjë shprehje jo parlamentare apo fyese që do të justifikonte një reagim të tillë. E përsëris edhe një herë: unë i respektoj ata që bëjnë opozitë, por të flasësh për orientimet dhe bindjet ideologjike të partisë që përfaqëson është krejt normale dhe korrekte, dhe nuk duhet të ketë reagime që pengojnë dëgjimin e pjesës tjetër të diskutimit. Sa i përket projekteve, krejt ato që përmendni janë të mira. Edhe unë do të doja të kishim 10.000.000 € për të bërë punë më të mira, por kemi pasur vetëm 1.200.000 €, dhe në përputhje me obligimet kemi qenë të detyruar t’i ndajmë. Drejtoria më e pakënaqur është ajo e Shërbimeve Publike, sepse ka pasur më së shumti obligime financiare. Nga 1.900.000 €, kemi ndarë rreth 800.000–900.000€, dhe kjo ka qenë e domosdoshme. Unë nuk jam prej atyre që mendoj se duhet të flasim shumë për obligimet e mbetura, sepse çdo qeverisje, kur përfundon mandatin, lë pas kontrata dhe projekte në proces. Por, meqenëse u përmend vlera e borxheve të trashëguara, dua të jem korrekt: në procesin e pranimit-dorëzimit, ish-Kryetari Hamza ka dorëzuar një raport, të cilin edhe vetë e ka kontestuar. Ne kemi marrë një obligim prej rreth gjysmë milioni €, por analiza jonë tregon se obligimi aktual i komunës është 9.100.000 €. Ministria e Financave madje ka thënë se janë 13.000.000 € obligime të papaguara, kjo lidhet edhe me kontratat kornizë të vitit 2025, vit zgjedhor, ku janë nënshkruar shumë kontrata afatgjata dhe është shpenzuar deri në 90% e mjeteve. Për shembull, në raport thuhet se në qershor 2025 janë paguar 485.000 € për raste emergjente, por qytetarët nuk kanë dijeni për ndonjë fatkeqësi natyrore që do të justifikonte një shpenzim të tillë. Unë ju kam dëgjuar me respekt maksimal. Projektet që sillni janë të gjitha të rëndësishme, sepse vijnë nga kërkesat e qytetarëve. Sfida është si t’i shpërndajmë mjetet në

mënyrë të balancuar, duke trajtuar nevojat më urgjente. Për momentin, problemi më i madh për qytetarët e Mitrovicës është çështja e qenve endacakë, që paraqesin rrezik të përditshëm. Po ashtu, kemi çështjen e pompave të ujit të pijshëm në disa fshatra të Shalës, ku vlera minimale për funksionalizimin e ujësjellësit është rreth 1.200.000 €. Kjo do të merret parasysh në hartimin e buxhetit të ardhshëm. Në vitin e parë të qeverisjes, gjithmonë trashëgohet një gjendje nga qeverisja paraprake, dhe nuk ka asgjë të keqe ta konstatosh atë. Detyra jonë është të prioritojmë Brenda mundësive. Sa i përket sportit, vitin e kaluar komuniteti sportiv nuk ka marrë subvencionet e parapara prej 200.000 €. Në bartjen buxhetore, kemi ndarë rreth 100.000 € për Drejtorinë e Sportit dhe Kulturës, të cilat shumë shpejt do të shpërndahen përmes thirrjes publike për klubet dhe organizatat kulturore. Çdo temë dhe çdo prioritet do të trajtohet me rishikimin e buxhetit, por pjesa më meritorë do të jetë kur të hartojmë buxhetin e vitit të ardhshëm. Kam përshtypjen se pritshmërit tuaja për mua janë më të mëdha sesa pritshmërit e mia për veten, por kjo më pëlqen, sepse tregon që jeni ambiciozë dhe kërkon më shumë punë e rezultate.

Artan Berisha: Kryetar, do të kërkoja nga ju që raportin e borxhit ta sillni në seancën e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit: E hedh në votim Propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake, në vitin 2026.

Rezultati i votimit: 30 anëtarë të pranishëm, 16 për, 0 kundër dhe 8 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua me shumicë votash Vendimi Për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake, në vitin 2026.

Pika 4

Kryesuesi i Kuvendit: Meqenëse jam propozues i këtij vendimi, po e shoh si obligim të jap disa pika të shkurtra rreth kësaj çështjeje. Ne e dimë se, pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Pagat, janë shfuqizuar të gjitha udhëzimet dhe rregulloret për kompensimin e punës së anëtarëve të këtyre komisioneve. Po ashtu, kemi marrë parasysh edhe praktikën e disa komunave të tjera. Bashkë me sekretarinë kemi përgatitur një propozim-vendim për kompensimin e anëtarëve të Kuvendit të angazhuar në komisione dhe komitete, jo vetëm për anëtarët e Kuvendit, por edhe për anëtarë të tjerë të propozuar në komitete dhe komisione të ndryshme. Në këtë propozim është përfshirë edhe kompensimi i Kryetarëve të lagjeve dhe fshatrave. Është dhënë një raport me shumën që duhet të kompensohet për punën e këtyre komisioneve. Para se ta finalizojmë këtë çështje, e kam konsultuar ekzekutivin, në këtë rast Kryetarin e komunës, dhe kam kërkuar që, për shkak të mungesës së mjeteve në kuadër të zyrës së Kuvendit, një pjesë e shumës të sigurohet nga bartja e të hyrave. Në bazë të vendimit për bartjen e të hyrave, 20.000 € janë alokuar pikërisht për punën e këtyre komisioneve. Ne e dimë se, përveç dy komiteteve të përhershme (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete), asnjë anëtar tjetër i Kuvendit i përfshirë në komitete dhe komisione të tjera nuk ka kompensim. Prandaj, duke pasur parasysh punën e këtyre trupave të Kuvendit, besoj se ky vendim është një stimul që i bën komitetet dhe komisionet më funksionale. Ka pasur sugjerime edhe për shumën e kompensimeve të Kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve, por planifikimi i buxhetit për këtë vit nuk e bën të mundur mbulimin e të gjitha kërkesave. Një llogaritje e bërë për vitin 2022 tregonte se, nëse shkohej me atë formë kompensimi, Kuvendit do t'i duheshin afër gjysmë milioni €. Motivi kryesor i këtij propozimi ka qenë kompensimi i anëtarëve të Kuvendit, por meqenëse edhe Kryetarët e fshatrave dhe lagjeve janë pjesë e vendimmarrjes së Kuvendit, i kam përfshirë edhe ata. Prandaj, e shpall të hapur diskutimin për këtë vendim.

Kushtrim Zeneli: Së pari, ky është një vendim shumë i mirë, sepse ndihmon që trupat komunal të funksionalizohen, mirëpo, shqetësimi im është se si do ta formulojmë tekstin përfundimtar. Për shembull, ky propozim që na ka ardhur për Kryetarët e këshillave lokale dhe komitetet konsultative duhet të harmonizohet me udhëzimin administrativ, nenin 12, i cili thotë se për Kryetarët e këshillave të fshatrave kompensimi bëhet ekuivalent me anëtarët e komiteteve obligative, pra pagesa bëhet vetëm për gjashtë takime brenda vitit kalendarik. Në propozim-vendim përmenden Kryetarët e këshillave lokale, por fokusi kryesor është tek anëtarët e komiteteve konsultative dhe komiteteve të tjera. Kjo krijon një paqartësi në trajtimin konkret të kompensimit për Kryetarët e këshillave lokale. Ka edhe komuna të tjera që kanë kërkuar këtë modalitet, sepse e shohin si shumë produktiv për funksionalizimin e trupave komunalë. Megjithatë, paqartësia juridike mbetet, edhe pse akti në fuqi njih të drejtën e kompensimit për Kryetarët e këshillave lokale, sipas nenit që përmenda. Unë kam dëgjuar edhe ankesa nga Kryetarët e fshatrave, sepse nuk u janë ndarë mjetet më herët, edhe pse kanë mbajtur mbledhje si Kryetarë të fshatrave. Prandaj, kjo çështje duhet të formulohet qartë dhe juridikisht e saktë, në mënyrë që të mos krijohen dilema në zbatim.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, unë besoj se në raport me këtë çështje më i thirrur është Nazmiu, për ta formuluar juridikisht shpjegimin. Në bazë të informatave që kam, me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi Pagat janë shfuqizuar të gjitha udhëzimet administrative dhe rregulloret që lidhen me kompensimin dhe pagat. Kjo ka ndaluar plotësisht kompensimin e Kryetarëve të fshatrave, por edhe të anëtarëve të tjerë të komisioneve dhe komiteteve. Megjithatë,

ekziston një analizë e bërë, të cilën për momentin nuk e kam me vete, por e kam lënë në zyrë. Në atë analizë, edhe auditori i jashtëm ka konstatuar se nuk ka problem nëse kuvendet bëjnë kompensimin e Kryetarëve të fshatrave. E njëjta gjë vlen edhe për anëtarët e komisioneve dhe komiteteve të tjera jo të përhershme të Kuvendit. Pra, nëse ata mbështeten me të njëjtën shumë, ekziston e njëjta bazë për kompensim. Megjithatë, kjo është vetëm një analizë, jo dokument zyrtar apo udhëzim administrativ që i jep të drejtë ligjore kësaj çështjeje. Prandaj, duke pasur parasysh mjetet financiare që kemi për momentin, është e arsyeshme të vazhdohet me këtë formë kompensimi, ndërkohë që kërkojmë interpretimin ligjor. Jemi të detyruar të shohim se cili do të jetë interpretimi ligjor nga ministritë përkatëse. Në këtë rast, besoj se Ministria e Financave do të merret me shumë me këtë çështje, pasi ka implikime financiare. Nëse ata konstatojnë se është në rregull, atëherë në planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, në shtator, mund ta përfshijmë këtë çështje. Kështu, në dhjetor ose janar mund të marrim vendimin e radhës për kompensimin e këtyre trupave për vitin paraprak. Ky vendim, pra, është vetëm për vitin 2026 dhe mbulon gjashtë muajt e fundit të këtij viti.

Kushtrim Zeneli: Jo, kryesues, nuk ka problem, sido që të mendoni. Unë e mbështes këtë propozim, vetëm se kemi një Udhëzim Administrativ që lejon Kryetarët e këshillave të fshatrave të paguhen. Nazmiu e potencoi Ligjin e Pagave, dhe kur ai hyri në fuqi, u bënë edhe ndryshime në udhëzimin administrativ. Pikërisht neni 12 thotë se Kryetarët e këshillave të fshatrave paguhen. Ky udhëzim administrativ, megjithatë, përjashton anëtarët e komiteteve konsultative, si nga Ligji i Pagave ashtu edhe nga vetë udhëzimi administrativ. Këtë e specifikon neni 12, pika 2, i udhëzimit administrativ të vitit 2022/23 (numrin e saktë nuk e kam tani, por mund të gjendet lehtësisht). Ky Udhëzim Administrativ ka peshë më të madhe sesa rregulloret komunale, dhe kryesuesi duhet ta dijë këtë. Propozimi im është i thjeshtë: ju vendosni, sepse ju e keni barrën dhe përgjegjësinë. Edhe nëse vendimi kthehet mbrapsht, ai është vendim i Kuvendit, jo i imi personal. Mund të bëhet ndryshimi i tekstit, ose mund të nxirret një vendim vetëm për Kryetarët e këshillave lokale. Por, nëse ju mendoni që duhet të vazhdojmë kështu siç është propozuar, atëherë është në rregull dhe ne si grup e mbështesim.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë besoj se është mirë që ky propozim të vazhdojë siç është propozuar. Nëse më vonë gjejmë bazë ligjore më të fortë, atëherë duhet ta rrisim jo vetëm për Kryetarët e fshatrave, por edhe për anëtarët e Kuvendit. Për shembull, aktualisht anëtari i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i komiteteve të përhershme merr 30% të pagës, ndërsa anëtarët e tjerë nuk përfitojnë. Nëse na lejohet ligjërisht, këtë çështje mund ta rregullojmë me vendim, në mënyrë që të ketë trajtim të barabartë. Megjithatë, në këtë fazë besoj se nuk kemi buxhet të mjaftueshëm për të shkuar në shuma më të mëdha. Është bërë një analizë e përbashkët, e cila është prezantuar te Kryetari dhe Nënkryetari, dhe ata e kanë mbështetur si të tillë. Me bartjen e mjeteve, kemi alokuar 20.000 € për këtë vit. Për vitin tjetër, buxhetin e kemi në dorë, sepse do të kalojë nëpër Kuvend në shtator, dhe atëherë mund ta rregullojmë më mirë. A ka dikush tjetër diçka për të shtuar?

Valon Brahimi: Udhëzimin e Kushtrimit nuk e gjeta. Po flas tash nga prizmi i vlerësimit tim për këtë rregullore: në aspektin funksional mendoj se është një punë e mirë, sepse e bën Kuvendin më aktiv. Në fund të ditës, si në kompani ashtu edhe në institucione shtetërore, motivi kryesor i angazhimit është çështja e të ardhurave, kur ka kompensim, edhe puna merr dinamiken e vet më të mirë. Sa i përket pagesës së Kryetarëve të këshillave të fshatrave, e kuptoj kufizimin buxhetor, por mendoj se shuma e propozuar nuk është adekuate për t'i aktivizuar ata më shumë në komunitet. Është një shumë e vogël. Ndoshta duhej ndjekur praktika e rregullores që ka qenë në fuqi para hyrjes së Ligjit për Pagat, ku ishte paraparë rreth 180 € për Kryetarët e fshatrave. Në fund, dua të them se kam dilemat e mia ligjore, por nëse marrim opinion pozitiv nga Ministria, atëherë pajtohem me ju që vitin e ardhshëm mund të bëjmë plotësim-ndryshimin e rregullores. Kjo do të mundësonte rritjen e vlerës jo vetëm për anëtarët e Kuvendit, por edhe për Kryetarët e këshillave të fshatrave.

Kryesuesi i Kuvendit: Domethënë, edhe njëherë po e theksoj: ky vendim është vetëm për vitin 2026. Nuk vlen për vitin e ardhshëm. Nëse marrim konfirmimin ligjor dhe unë shpresoj e lutem që të kthehet si i tillë atëherë do të kemi bazë më të fortë për të vazhduar. Ne kemi tentuar të marrim për bazë edhe praktikën e komunave të tjera, të cilat e bëjnë kompensimin e këtyre trupave përmes kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, sepse nuk lejohet nga kategoritë e tjera. Besoj se kjo do të jetë një bazë e mirë që në planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm ti trajtojmë më mirë jo vetëm Kryetarët e fshatrave, por edhe anëtarët e tjerë të komiteteve dhe komisioneve. Pra para se të hynte në fuqi Ligji mbi Pagat, Kryetarët e fshatrave dhe anëtarët e komisioneve janë paguar me të njëjtën shumë, pra 50 €. Në momentin që ligji hyri në fuqi, këto pagesa u ndalën dhe nuk kanë vazhduar më tutje. Ne kemi parë se disa komuna kanë bërë lëvizje në këtë drejtim dhe tash po e testojmë edhe ne, për të parë se cila është forma më e përshtatshme. Unë besoj se kjo praktikë do të vazhdojë, sepse është një mundësi e mirë. Në fund të fundit, qëllimi kryesor ka qenë funksionalizimi i trupave të Kuvendit. Ndërsa përfshirja e Kryetarëve të fshatrave në këtë vendim ka qenë një shtesë e mirëseardhur, që e bën vendimin më gjithëpërfshirës.

Shkëlqim Ibrahim: Është mirë që kjo çështje të mbikëqyret me kujdes, uroj që të miratohet dhe të aprovohet, por njëkohësisht të monitorohet, sepse ka pasur raste kur ish-drejtorë që kanë qenë edhe asambleistë kanë përfituar paga të paarsyeshme. Për shembull, mua më ka dalë rroga 225 €, ndërsa ka pasur raste kur dikujt i ka dalë deri në 1.300 €, për shkak të keqpërdorimit të mbledhjeve. Prandaj kjo pjesë është e domosdoshme të monitorohet, sepse qëllimi është efikasiteti dhe funksionaliteti i trupave, jo keqpërdorimi i mjeteve.

Kryesuesi i Kuvendit: Është e detajuar në vendim e theksova edhe fillimisht dhe është shumë mirë e precizuar se sa takime mund të mbahen gjatë vitit, por edhe brenda muajit.

Atëherë e hedh në votim Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, Kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026.

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar vendimi për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, komiteteve tjera, Kryetarëve të këshillave lokale dhe komisioneve ad hoc të formuara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2026.

Pika 5

Ramadan Beshiri: Përgjatë periudhës sa kemi përgatitur propozim-vendimin dhe e kemi miratuar, një nga fëmijët ka mbushur 18 vjeç. Prandaj numri i përfituesve është 51 fëmijë, jo 52, sepse kriteri është mosha nga 0 deri në 18 vjeç. Vendimit i bashkëngjitet edhe lista përkatëse nga Drejtoria. Sa i përket materialeve, ato nuk janë shpërndarë për arsye konfidencialiteti të fëmijëve dhe prindërve. Për asamblistët që dëshirojnë të dinë kush përfiton, lista me emra dhe të gjitha të dhënat gjendet në sekretari.

Sazan Ramaxhiku : I nderuar Kryetar, Nënkryetar, Kryesues, ekzekutiv, asamblistë, media dhe të gjithë të pranishëm, fillimisht dua ta përshëndes vendimin e Kryetarit për subvencionimin e fëmijëve me autizëm, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit për Autizmin. Edhe pse shuma prej 50 € mund të duket simbolike krahasuar me shpenzimet e mëdha që kanë këto familje, ky është një hap i rëndësishëm dhe një sinjal se komuna po e trajton me seriozitet këtë çështje. Gjithashtu dua të falënderoj Kryetarin dhe Nënkryetarin për mbështetjen në organizimin e tryezës informuese për autizmin, e cila ka qenë një hap i madh, ku janë evidentuar nevojat konkrete dhe të dhëna të rëndësishme. Këto janë hapa që duhen vlerësuar. Megjithatë, kam një shqetësim në lidhje me numrin e përfituesve. Në vendim përmendet shifra 52, tash 51 sipas Drejtorisë, por në praktikë ka indikacione që numri real është më i madh. Prandaj propozoj që të mos mbetemi të fiksuar te një shifër e caktuar, por mbështetja të vlejë për të gjithë fëmijët që regjistrohen dhe verifikohen përmes mekanizmave të mirëqenies sociale. E kuptoj që duhet të merren parasysh mundësitë buxhetore aktuale, por do të ishte e dobishme të shqyrtohen opsione për rritjen e mbështetjes. Kjo do të ndihmonte në krijimin e një databaze të saktë, do të inkurajonte familjet që ende nuk i kanë regjistruar fëmijët dhe do të rriste ndërgjegjësimin në shoqëri. Mbi të gjitha, do të sigurohej që asnjë fëmijë në nevojë të mos mbetet jashtë mbështetjes institucionale. Qëllimi ynë si Lëvizje Vetëvendosje dhe besoj që është qëllimi i të gjithëve këtu është të kemi më shumë mbështetje, më shumë drejtësi dhe të mos mbetet asnjë fëmijë jashtë kujdesit institucional. Mbi të gjitha, kjo është një obligim moral.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Fillimisht nuk kisha menduar të marr fjalën, por meqenëse u ngritën disa tema, po e rimarr përsëri. Janë disa çështje dhe kategori për të cilat mund të flasim, kam përshtypjen se ndoshta do të preferoja të abstenoj pa hyrë shumë në diskutim, por meqenëse u fol edhe për problemet që i shoqërojnë këto tema, dua të theksoj se shuma e përcaktuar është në radhë të parë, një demonstrim i vullnetit pozitiv. Vlerat e përkrahjes në vitet e ardhshme do të rriten, jo vetëm si mbështetje direkte, por edhe përmes mekanizmave që lehtësojnë jetën dhe funksionimin e kësaj kategorie. Jemi të vetëdijshëm për sfidat që hasen në procesin e arsimimit, për nevojën e angazhimit të asistentëve, si dhe për masat sensibilizuese kundër stigmatizimit. Unë personalisht kam ndërmend që, në raste të caktuara, të jem pranë këtyre nxënësve edhe në bankat e tyre, si një përkrahje morale. Po ashtu, duhet të verifikojmë në të ardhmen nëse ka fëmijë me autizëm që nuk janë paraqitur tek institucionet, sepse është e rëndësishme të kemi një pasqyrë të plotë. Shoqëria përcakton normat morale, dhe problemet shëndetësore nuk duhet të shihen si pengesë apo turp, por si pjesë e natyrshme e jetës. Prandaj, mora fjalën vetëm për të thënë se, edhe pse nuk preferova të flas në fillim, përkrahja do të rritet. Ky vendim është më shumë shprehje e vullnetit pozitiv, ndërsa fokusin do ta kemi vitin e ardhshëm, posaçërisht kur të hartojmë buxhetin dhe planifikimin për adresimin e nevojave të kësaj kategorie në sistemin arsimor. Dhe, siç e tha me të drejtë Valoni, duhet të verifikohet edhe njëherë rasti i fëmijës që ka mbushur 18 vjeç, sepse efekti retroaktiv, kur është në favor të palës, duhet të respektohet.

Xhyljeta Imeri: Duke marrë parasysh sfidat dhe koston financiare që kanë familjet për trajtimin e fëmijëve me autizëm, kjo shumë është simbolike, por njëkohësisht shumë e rëndësishme dhe e qëlluar. Për këtë ju përgëzoj.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, domethënë, nuk po ndryshojmë asgjë nga propozimi që ka ardhur tek ju. A ka diskutime të tjera?

Atëherë e hedh në votim Propozim vendimin për subvencionimin e fëmijëve me autizëm.

Rezultati i votimit: të pranishëm 29 anëtarë, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar vendimi për subvencionimin e fëmijëve me autizëm. Në sall janë të pranishëm 29 anëtarë.

Pika 6

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin.

Ramdan Beshiri: Është një çështje normale, dhe si vendimi paraprak ashtu edhe ky nuk ka ndonjë implikim politik, thjesht duhet të diskutohet për çështje ligjore dhe procedurale që lidhen me të. Në këtë propozim, vendimin po dëshiroj ta ndryshoj. Bëhet fjalë vetëm për inicimin dhe destinimin e parcelës për vendosjen e pllakës. Çështjet e tjera janë ende në procedurë.

Valon Brahim: Drejtor, përmasat e pllakës i kam parë që janë 45 me 65, por vlerësoj që është një pllakë shumë e vogël. Kjo do të thotë se nuk është mirë të bëhet një ceremoni e madhe, pasi pllaka është e vogël.

Ramadan Beshiri: Ideja është që pllaka momentale të vendoset në Lagjen Ilirida, aty ku ka vepruar heroji Driton Veliu. Përndryshe, në ceremoninë e 27-vjetorit të tij Kryetari ka shprehur gatishmërinë që të vendoset edhe një pllakë tjetër, më simbolike dhe më dinjitoze, në vendin e rënies, te Ura e Gjakut, ku ka rënë heroji Driton Veliu. Në fakt, aty është vendosur edhe një gur shumë i bukur, dhe pllaka është vendosur mbi të, duke treguar simbolikën e angazhimit të Driton Velikut në Lagjen Ilirida si njësi i parë gueril në qytet, i përbërë nga Driton Veliu dhe Artim Jashari. Ideja dhe qëllimi kanë qenë të mira. E kuptoj qëllimin tënd fisnik dhe të mirë, mirëpo momentalisht jemi këtu ku jemi.

Kryesuesi i Kuvendit: Domethënë, miratojmë vetëm vendin, hapësirën ku do të vendoset, sepse në të vërtetë ato punë pothuajse janë të përfunduara. Mirëpo, ne duhet ta formalizojmë hapësirën e vendosjes së kësaj pllake.

Atëherë e hedh në votim Propozim Vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e Pllakës Përkujtimore për Heroin Driton Veliu.

Rezultati i votimit: të pranishëm 29 anëtarë, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi që me votë unanime është miratuar Vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e Pllakës Përkujtimore për Heroin Driton Veliu.

Pika 7

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin.

Gazmend Asllani: Kërkoj që të ndryshohet emërtimi i këtij propozim vendimi, në mënyrë që të reflektojë më drejt përmbajtjen dhe qëllimin e tij. Pas një analize më të detajuar dhe konsultimeve shtesë me sekretarinë e Kuvendit, kemi ardhur në përfundim se është e nevojshme të bëhen disa përmirësime, në mënyrë që vendimi të jetë më i saktë, më funksional dhe në përputhje me interesin publik. Ky ndryshim nuk e prek thelbin e propozimit, por ndihmon që vendimi të jetë më i qartë dhe më i zbatueshëm në praktikë. Tani po e lexoj propozim-vendimin, i cili bazohet në nenet 12, 14 dhe 58 pika H të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale; nenin 21 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; nenin 26 të Rregullores së ÇRK-së nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; si dhe nenet 13, 15 dhe 17 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Jugut nr. 02/060-01005607/204 të datës 24.09.2020. Bazuar në këto dispozita ligjore dhe në propozim-vendimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i propozohet Kuvendit të Komunës ky propozim-vendim për destinimin dhe dhënien në shfrytëzim të objektit dhe parcelës për Muzeun e Qytetit të Mitrovicës.

Prona e paluajtshme komunale e propozuar është objekti dhe parcela e ish-shtëpisë së armatës, parcela kadastrale P-Z 71208072.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë besoj që pjesët e tjera i kemi të përfunduara. Domethënë, ideja është e formuluar tek çështja e objektit ekzistues dhe parcelave përreth, sepse kjo ka qenë edhe një analizë e inspektoratit të trashëgimisë kulturore, ku ata kanë thënë se nuk ka mundësi të investohet përderisa prona nuk i destinohet muzeut të qytetit, kur dihet që edhe objekti në fjalë është në kuadër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Prandaj, çdo investim atje duhet të jetë, si të them, në harmoni dhe në konsultim me Zyrën për Trashëgimi Kulturore. A ka të tjerë për diskutim rreth kësaj çështjeje?

Atëherë e hedh në votim Propozim vendim për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës me ndryshimet që i dha drejtori.

Rezultati i votimit: të pranishëm 29 anëtarë, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar Vendimi për caktimin e selisë së përhershme të Muzeut të qytetit të Mitrovicës me ndryshime.

Pika 8

Kryesuesi i Kuvendit: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit për Ankesa për bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike lokale, Ministria e Zhvillimit ka konstatuar që vendimi i komunës është në kundërshtim me ligjin, sepse nuk ka mundësi që kompetencat e komisionit të aksionarëve të barten në një komision tjetër. Prandaj është thënë që ky vendim duhet të shfuqizohet, dhe çdo ankesë eventuale kalon në gjykatë. Nuk ka komision i cili merret me shqyrtimin e ankesave në raport me përzgjedhjen e drejtorëve të ndërmarrjeve publike lokale.

Atëherë e hedh në votim Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005630-18/26, të dt. 10.02.2026 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.

Rezultati i votimit: të pranishëm 29 anëtarë, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar vendimi për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005630-18/26, dt. 10.02.2026 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.

Pika 9

Kryesuesi i Kuvendit: Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010, në raport me shujtat. Unë besoj që rreth kësaj çështjeje kryetari, në fillim të seancës, i dha vërejtjet e veta. Po ashtu, e ndjej për obligim të theksoj se ka ardhur edhe një peticion nga administrata komunale. Meqenëse këtu shihet qartë se cili është vendimi i Gjykatës Kushtetuese, si dhe kundërshtia e këtij vendimi me tre ligje të tjera në fuqi, ne, si Kuvend, në një farë forme jemi të detyruar ta shfuqizojmë vendimin, i cili realisht është vendim i Kuvendit.

Shkëlqim Ibrahim: Unë desha vetëm të jap disa komente, pa e politizuar këtë pjesë, duke parë edhe komentet që na kanë ardhur me email. Ky nuk është thjesht një dokument teknik, realisht është një dokument i nxjerrë me procedurë, nuk është vendim i rastësishëm dhe nuk ka kaluar pa procedurë, ka kaluar nëpër instanca gjyqësore, ku njerëzit i kanë fituar rastet me të drejtë. Ne si grup i PDK-së e kundërshtojmë fuqishëm këtë pjesë, sepse Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në tre nene, e kundërshton. Kam një dilemë: nëse ne e shfuqizojmë këtë vendim, çfarë ndodh me borxhet ose me të drejtat e fituara paraprakisht? Ligji thotë se shfuqizimi vlen për të ardhmen, ndërsa anulimi ka efekt retroaktiv. Për shembull, neni 57 thotë se ekziston vullneti për të shfuqizuar një vendim vetëm në rastet kur ka dëmtim serioz të pronës publike. Nuk po shoh cili është dëmtimi serioz i pronës publike në këtë rast. Gjithashtu, neni 58 thotë se mbi pesë vite, kur një udhëzim administrativ është në fuqi, nuk kemi të drejtë ta shfuqizojmë përmes Kuvendit, pra, ligji e mbyll këtë mundësi. Andaj mendoj që ne si Kuvend nuk kemi të drejtë të përdorim instrumentin e shfuqizimit për vendime që nuk janë në kuadër të kompetencës sonë, vetëm pse pushteti ose ministria ka ndryshuar ligje dhe nuk i përshtatet financiarisht. Ne gjithmonë kemi folur për dinjitetin e punëtorëve dhe drejtësinë sociale, sot, me këtë vendim, goditet pikërisht drejtësia sociale, prandaj kërkoj nga secili asambleist që t'i konsultojë këto tre ligje, sidomos pjesën e afatit pesëvjeçar, sepse ligji e mbyll këtë mundësi dhe njerëzit kanë fituar të drejta me bazë juridike, qoftë në Gjykatën Themelore, qoftë në Gjykatën e Apelit. Kjo çështje nuk është e re, por ka 15 vite. Besoj që e gjithë Asambleja, pa dallim pozitë apo opozitë, duhet të ketë kujdes se çfarë po voton sot. Është çështje e marrëdhënies së komunës me punëtorët e saj. Ju lutem shumë, pa dallim partie, mos e votoni këtë vendim, sepse nuk është çështje politike, por çështje ligjore dhe sociale. Sot duhet të jemi në anën e ligjit dhe të sigurisë juridike të punëtorëve. Ne si grup parlamentar i PDK-së e kundërshtojmë fuqishëm dhe nuk e përkrahim. Propozoj që të respektohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të konsultohen këto tre ligje, sidomos pjesa e pesëvjeçarit.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Ka raste kur disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, me "common senses" në shqip, do të thotë "me mendje të shëndoshë" ose "me logjikë të shëndoshë", pra, ka një përkthim të përafërt. Unë kam menduar shpesh se disa vendime nuk janë gjithmonë të drejta në interpretim, por kjo mbetet një vlerësim i brendshëm. Nuk duhet harruar që kur institucionet e drejtësisë marrin vendim, mund të ketë diskutime, por ekziston edhe një ligj që përcakton se akterët me pozicion të rëndësishëm institucional nuk kanë të drejtë t'i kundërshtojnë me votë ose fuqishëm vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Madje, nuk lejohet as diskutimi për to, sepse Gjykata Kushtetuese është shkalla e fundit në hierarkinë e interpretimeve. Në momentin kur Gjykata gjykon një çështje, vendimi mund të duket i gabuar ose paradoksal, por megjithatë është përfundimtar. Diskutimi yt mund të ketë bazë juridike, por ekziston hierarkia e akteve juridike: në krye është Kushtetuta, pastaj marrëveshjet ndërkombëtare, e më

pas ligjet dhe udhëzimet administrative. Në këtë kuadër, opsioni i vetëm është respektimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Shpeshherë vendimet nuk na pëlqejnë, shpeshherë duken paradoksale, por titullarët e institucioneve nuk kanë të drejtë t'i kontestojnë. Në disa raste kjo është e sanksionuar edhe me ligj. Pra, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk diskutohen, vetëm zbatohen. Ky është realiteti, pavarësisht interpretimeve personale.

Valon Brahimi: Dhe unë i bashkëngjitëm diskutimit të kolegut z. Ibrahim, desha të theksoj vetëm dy aspekte ligjore këtu. Po e citoj shkresën që na është përcjellë si material, ku thuhet se çdo vendim administrativ i nxjerrë nga organizatat buxhetore lidhur me paga, shtesa apo kompensime (përfshirë shujtat) është për nevoja administrative. Ata të Thesarit, kur e kanë dërguar shkresën, kanë çekur shujtat, por vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk i përmend shujtat. Vendimi thotë se shfuqizohen vetëm pagesat nëpër komisione dhe kompensimet. Ky vendim nuk është buxhetuar dhe aprovuar paraprakisht në ligjin e vjetër të buxhetit. Mua më intereson të di: cila komunë deri sot e ka shfuqizuar një vendim të ngjashëm? Kryesues, kryetar, nënkryetar a keni informacion? Sepse nuk është vetëm komuna jonë që ka këtë vendim. Nuk e di nëse ka qenë marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi midis ish-qeverisë dhe sindikatës. Pse duhet të jemi ne të parët që e shfuqizojmë këtë vendim, duke prekur xhepin e punëtorit, kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk i përmend shujtat? Problemi tjetër është se vendimi i Gjykatës nuk na është përcjellë si material. Po ashtu, nuk kemi as opinionin ligjor të Ministrisë së Financave si pjesë të materialit përcjellës. Për të qenë bindës, duhej të na përcilleshin të dy dokumentet vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin ligjor i Ministrisë së Financave. Nuk mund të mbështetemi vetëm në përshkrime telegrafike. Për më tepër, ne kemi dy vendime gjyqësore që u kanë njohur palëve të drejtën për realizimin e shujtave. Vendimi i Gjykatës Themelore dhe ai i Gjykatës së Apelit kanë fuqi më të madhe se rekomandimi i Gjykatës Kushtetuese, e cila nuk trajton problemet juridike civile, por vetëm shkeljet e Kushtetutës. Vendimi i Gjykatës së Apelit, madje, ka konstatuar padëgjueshmërinë e komunës dhe ka urdhëruar që punëtorëve t'u jepen mjetet. Dokumentet ekzistojnë dhe mund të merren nga avokati i komunës. Nuk është e drejtë që ne të bëjmë obstruksione dhe devijime nga natyra e problemit, kur 30 komuna të tjera ende nuk e kanë shfuqizuar këtë vendim. Pse duhet të jemi ne të parët që prekim xhepin e punëtorit, kur ata tashmë kanë paga të papërfillshme? Është më mirë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër, të analizohet më hollësisht, të merret parasysh edhe peticioni i sindikatës, sepse marrëveshja nuk ka qenë mes komunës dhe sindikatës, por midis ish-qeverisë dhe sindikatës në nivel qendror. Prandaj, duhet kujdes para se të marrim vendim. Vota ime është kundër.

Kushtrim Zeneli: Së pari, e kuptojmë që kjo pikë nuk po sillet këtu për të qenë kundër administratës dhe as kundër punëtorëve, por si detyrim për harmonizim me legjislacionin në fuqi. Vendimi i vitit 2010 është marrë në rrethana të tjera kohore dhe juridike, ndërsa sot ka rregulla të tjera ligjore për menaxhimin e financave publike, pagesat në sektorin publik dhe shpenzimet e mjeteve buxhetore. Për këtë arsye, nëse një vendim i tillë nuk është në përputhje me ligjin, shfuqizimi i tij në një farë mënyre është i domosdoshëm. Qëndrimi ynë pra duhet të jetë i balancuar. Nuk jemi kundër administratës, por jemi për vendime të ligjshme, të zbatueshme dhe të qëndrueshme financiarisht. Megjithatë, për të mos krijuar pakënaqësi tek administrata komunale, kërkojmë që paralelisht me shfuqizimin e këtij vendimi, ekzekutivi komunal të angazhohet dhe të shqyrtojë forma të tjera ligjore të mbështetjes dhe motivimit për punëtorët, në përputhje me ligjet dhe mundësitë buxhetore. Pra, këtë pikë ne e votojmë jo si heqje e një të drejte ndaj punëtorëve, por si vendosje e rendit ligjor dhe si hap për të gjetur zgjidhje të reja, të drejta dhe të ligjshme për administratën.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci tha se Sa i përket faktit nëse komuna është ndër komunat e para që ka vepruar në këtë drejtim, ai tha se kjo mbetet çështje për verifikim. Megjithatë, bazuar në komunikimet që kishte pasur së fundmi, rezulton se edhe Komuna e Vushtrrisë e ka shfuqizuar këtë vendim. Ai shtoi se Vushtrria është komunë fqinje dhe se është ndër komunat e para që ka ndërmarrë këtë hap. Gjithashtu, theksoi se e njëjta praktikë e shfuqizimit të këtij vendimi po vazhdon edhe në komuna të tjera.

Visar Sylja: Ai shtoi si koment se, edhe pse u përmend nga z. Zeneli, drejtoratet duhet ta planifikojnë punën në atë mënyrë që pagesat shtesë të parashihen në kuadër të buxhetit kur bëhet planifikimi për vitin e ardhshëm.

Kryesuesi i Kuvendit theksoi siq e tha z. Beka me të drejtë, qysh në fillim gjatë diskutimit për rendin e ditës, e ngriti këtë paralele. Sipas tij, u shtrua pyetja nëse çështja e kompensimit të anëtarëve të Kuvendit mund të jetë në kundërshtim me këtë çështje. Ai theksoi se, nëse kjo do të lejohej, atëherë në planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm do të mund të merrej edhe një vendim i veçantë për kompensimin e punëtorëve të administratës komunale. Megjithatë, ai sqaroi se si Gjykata Kushtetuese, ashtu edhe tri ligjet përkatëse, vlerësojnë se kjo çështje nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi. Për këtë arsye, ai konsideroi se është mirë që të mos mbahet në fuqi një vendim që bie në kundërshtim me këto akte. Në përfundim, ai theksoi se gjithsesi duhet të shqyrtohen dhe të hulumtohen forma të tjera më të përshtatshme për kompensimin shtesë të punëtorëve të administratës komunale.

Atëherë e hedh në votim Propozim vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010.

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 16 për, 11 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi të miratuar Vendimin Për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-4136/10 dt. 02.08.2010.

Pika 10

Kryesuesi propozoi që pikat 10, 11, 12 dhe 13 të rendit të ditës të trajtohen së bashku në diskutim, me arsyetimin se të gjitha kanë të bëjnë me mbështetje financiare. Ai sqaroi se diskutimi do të zhvillohet për të gjitha pikat njëkohësisht, ndërsa miratimi do të bëhet veç e veç për secilën pikë. Më pas, ai pyeti të pranishmit nëse kishte dikush që dëshironte të diskutonte lidhur me këto pika.

Xhyljeta Imeri theksoi se shoqatat e dala nga lufta kanë një rëndësi të veçantë dhe se, në përgjithësi, kanë nevojë për mbështetje financiare për mbulimin e kostove të veprimtarisë së tyre. Sipas saj, duhet të gjendet një formë e përshtatshme që për këto organizata të planifikohet dhe të buxhetohet mbështetja financiare, në mënyrë që ato të mos kenë nevojë të paraqesin kërkesa për mbështetje çdo vit.

Kryesuesi i Kuvendit dha një informatë sqaruese, duke theksuar se këto kërkesa kanë ardhur në Zyrën e Kuvendit, pas diskutimit të kësaj çështjeje me Kryetarin dhe Nënkryetarin, ai i ka përfshirë ato në rend dite në Komitetin për Politikë dhe Financa, prej nga procedura ka vazhduar më tej. Ai sqaroi se, sipas Udhëzimit Administrativ për mbështetjen, përkatësisht subvencionimin e organizatave joqeveritare, pa thirrje publike nuk lejohet të jepen më shumë se 500 €. Sipas tij, kërkesat e paraqitura kanë qenë në përputhje me rregulloren për mbështetje financiare dhe subvencionim. Ai shtoi se këto propozime janë shqyrtuar në komitet, ku kanë marrë mbështetje unanime, dhe për këtë arsye janë sjellë për shqyrtim dhe vendimmarrje në Kuvend. Gjithashtu, ai theksoi se vendimi i Kuvendit bartet për ekzekutim te Drejtoria për Mirëqenie Sociale, pasi kjo drejtori merret kryesisht me trajtimin e këtyre kërkesave dhe sqaroi se është e nevojshme të përcaktohet edhe burimi i financimit për këto vendime. Në përfundim, duke konstatuar se nuk kishte diskutime të tjera, ai propozoi që çështja të hidhej në votim, duke filluar me kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: 22 anëtarë të pranishëm, 22- për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar Vendimi Për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së

Pika 11

Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim Kërkesën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: 24 anëtarë të pranishëm, 24 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së

Pika 12

Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim Kërkesën e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: 27 anëtarë të pranishëm, 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së

Pika 13

Sa i përket Kërkesës së Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare Kryesuesi i Kuvendit sqaroi se kërkesa fillestare ka qenë për një shumë më të madhe mirëpo Komiteti për Politikë dhe Financa ka rekomanduar ndarjen e 500 €, pasi kjo shumë është në përputhje me Udhëzimin Administrativ për mbështetjen, përkatësisht subvencionimin e organizatave joqeveritare. Atëherë e hedh në votim Kërkesën e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës Dega në Mitrovicë, për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi që me votë unanime është miratuar Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të lidhjes së invalidëve dhe viktimave civile të luftës

Pika 14

Shkëlqim Ibrahim theksoi se Sa i përket raportit financiar për periudhën janar–mars, raporti është sjellë me kohë, por shprehu shqetësimin për nivelin e ulët të realizimit të të hyrave. Sipas tij, realizimi i të hyrave është vetëm 12%, ndërsa krahasuar me vitin e kaluar paraqet rënie të ndjeshme. Ai vlerësoi se kjo shumë përfaqëson vetëm një pjesë të vogël të të hyrave të planifikuara për inkasim dhe se në kategorinë e investimeve kapitale nuk ka pasur realizim. Ai paralajmëroi se, nëse vazhdohet me këtë ritëm, plani për inkasimin e të hyrave vetanake nuk do të realizohet, gjë që do të ketë pasoja zinxhirore edhe në realizimin e investimeve kapitale dhe subvencioneve, duke pasur parasysh se një pjesë e tyre planifikohen të financohen nga të hyrat vetanake. Po ashtu, ai bëri krahasim mes drejtorive komunale, duke theksuar se, megjithëse Drejtoria e Shërbimeve Publike ka buxhet dukshëm më të madh, niveli i shpenzimeve të saj është më i ulët krahasuar me Zyrën e Kryetarit. Në këtë drejtim, ai kërkoi sqarime nëse vonesat lidhen me procedurat e prokurimit, mungesën e projekteve apo mungesën e kontratave aktive, duke vlerësuar se institucioni po reflekton më shumë karakter administrativ sesa zhvillimor. Më tej, ai ngriti çështjen e angazhimit të konsulentëve të jashtëm nga disa drejtori komunale. Ai kërkoi sqarim lidhur me bazën ligjore të angazhimit dhe pagesës së tyre, si dhe në cilat kategori buxhetore janë reflektuar këto shpenzime në raportin financiar. Ai theksoi se nuk është kundër angazhimit të konsulentëve të jashtëm, por kërkon transparencë lidhur me bazën ligjore dhe pasqyrimin financiar të këtyre angazhimeve. Gjithashtu, ai ngriti çështjen e subvencionimit të KRU “Uniteti”, duke theksuar se më 30 janar kryetari kishte deklaruar publikisht se kjo ndërmarrje ishte subvencionuar. Sipas tij, në raportin financiar nuk figuron asnjë subvencion i tillë në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për entitetet publike. Për këtë arsye, ai kërkoi sqarim nëse subvencionimi është realizuar dhe, nëse po, cila ka qenë baza ligjore për këtë veprim, duke shtuar se nuk është në dijeni që një ndërmarrje publike mund të subvencionohet pa miratimin e Kuvendit Komunal. Ai ngriti edhe një vërejtje teknike lidhur me paraqitjen grafike në raportin financiar, duke theksuar se disa pjesë të grafikëve nuk lexoheshin qartë për shkak të mbivendosjes së elementeve grafike.

Në përgjigje, drejtori sqaroi se niveli i ulët i të hyrave të paraqitura në raport nuk pasqyron gjendjen reale, pasi pagesat e realizuara më 31 mars reflektohen në sistem me vonesë, sipas procedurave të Bankës Qendrore. Ai theksoi se vetëm më 31 mars janë realizuar pagesa në vlerë prej 186.000 €, të cilat nuk janë reflektuar në raportin përkatës.

Më tej, gjatë diskutimit u ngrit edhe çështja e obligimeve të papaguara kontraktuale të paraqitura në raportin financiar. Njëri nga anëtarët pyeti nëse këto duhet të konsiderohen borxhe apo përgjegjësi që burojnë nga kontinuiteti institucional. Në këtë drejtim, u theksua se duhet bërë dallimi ndërmjet borxheve të lëna dhe obligimeve kontraktuale që barten nga një mandat në tjetrin.

U përmend se edhe në mandatet e kaluara komuna ka trashëguar obligime financiare, duke përfshirë pagesa të konsiderueshme për kontratën kolektive, të cilat janë përmbushur si detyrime institucionale. Për këtë arsye, u kërkua që obligimet kontraktuale të mos trajtohen automatikisht si borxhe të krijuara nga qeverisja paraprake, por si pjesë e përgjegjësiave buxhetore dhe institucionale që vazhdojnë nga një periudhë në tjetrën.

Drejtori Gazmend Gjoshaj shtoi se shumica e obligimeve të papaguara është paraqitur 490.000 €, mirëpo sipas tij kjo nuk është e saktë, pasi në kuadër të fondit të eficiencës ekzistojnë obligime mbi 500,000 € që kanë ardhur si fatura të reja. Ai theksoi se këto obligime nuk janë përfshirë as në borxhin e vitit të kaluar, duke ngritur shqetësim për pasqyrimin e saktë të detyrimeve financiare.

Shkëlqim Ibrahim kërkoi që të mos përdoret formulimi “nuk është e saktë”, duke theksuar se bëhet fjalë për një raport zyrtar. Ai sqaroi se si anëtar i Kuvendit, nuk ka qasje në informacione jashtë dokumentacionit të paraqitur dhe se bazohet vetëm në atë që është përfshirë në materialet zyrtare. Ai theksoi se duhet të respektohet dokumentacioni zyrtar mbi të cilin zhvillohet shqyrtimi.

Xhyljeta Imeri fillimisht shprehu falënderim për përgatitjen e raportit financiar. Më pas u ndal shkurt në përmbajtjen e tij, duke theksuar se sipas tabelave të paraqitura, realizimi i projekteve në përgjithësi është shumë i ulët krahasuar me vitin e kaluar. Ajo shprehu shpresën që në muajt në vijim realizimi të rritet dhe të shkojë sipas planifikimeve, duke theksuar se aktualisht realizimi është rreth 19%, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka qenë rreth 27%.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani iu drejtua anëtarëve të Kuvendit dhe ekzekutivit, duke sqaruar fillimisht se sa i përket raportit financiar, obligimi ndaj Fondit të Eficiencës në vlerë prej 455,145.90 € nuk ka qenë i paraparë në buxhet dhe nuk është dorëzuar si obligim nga drejtoria përkatëse, çështje të cilën e kishte ngritur edhe më herët tek drejtoria e financave. Lidhur me angazhimin e ekspertëve dhe këshilltarëve të jashtëm, ai theksoi se gjatë mandatit nuk ka pasur të angazhuar ekspertë apo këshilltarë të jashtëm me pagesë. Sipas tij, angazhime të tilla kanë qenë kryesisht në fushën e shëndetësisë dhe kanë qenë pa pagesë, duke shtuar se nuk ekziston bazë ligjore dhe as barrë financiare për komunën në këtë aspekt. Ai më tej sqaroi se ndodhen në fillim të tremujorit të parë dhe se pagesat kanë qenë të pezulluara deri rreth datës 22 mars, kur janë miratuar nga Ministria e Financave, gjë që ka ndikuar në

realizimin e shpenzimeve dhe të hyrave. Sa i përket të hyrave vetanake, ai pranoi se në krahasim me vitin e kaluar situata është më e dobët dhe kjo është shqetësuese, por theksoi se janë ndërmarrë hapa konkretë duke u dërguar shkresa operatorëve që nuk kanë kryer pagesat. Ai shprehu besimin se të hyrat vetanake për këtë vit do t'i tejkalojnë pritshmëritë. Sipas tij, vetëm nga dy operatorë ekzistojnë rreth 1.000.000 € të hyra të papaguara, të cilat ende nuk janë pasqyruar në raportin e tremujorit të parë. Ai shtoi se në raportin e ardhshëm, për muajin qershor, pritet të shihet përmirësim dhe madje tejkalim i të hyrave të planifikuara.

Shkëlqim Ibrahim i parashtrori dy pyetje për Nënkrjetarin. Së pari, kërkoi sqarim nëse për angazhimin e konsulentëve ekziston bazë ligjore dhe nëse për këtë angazhim ka vendim përkatës. Së dyti, ai kërkoi sqarim lidhur me subvencionimin e KRU "Uniteti", duke pyetur nëse një subvencion i tillë ekziston apo jo.

Nënkrjetari i Komunës z. Enis Osmani sqaroi se nuk ka pasur subvencionim të KRU "Uniteti". Sipas tij, janë realizuar kontraktime për punë shtesë dhe orar shtesë të punëtorëve, të cilat janë paguar përmes Drejtorisë së Infrastrukturës, ai theksoi se faturat që vijnë nga KRU "Uniteti" paguhet në mënyrë të rregullt dhe se nuk bëhet fjalë për subvencionim dhe shtoi se deklaratimet publike në rrjete sociale kanë qenë gabim teknik dhe nuk përfaqësojnë realitetin, duke theksuar se ato nuk janë përgatitur drejtpërdrejt nga Kryetari. Në fund, ai përsëriti se nuk ka pasur asnjë subvencionim të ndërmarrjes dhe se nuk ka pasur as këshilltarë apo ekspertë të angazhuar me pagesë në kuadër të qeverisjes komunale.

Shkëlqim Ibrahim i kërkoi informatë nëse gjatë kësaj qeverisjeje tre mujore ka pasur ekzekutim të vendimeve gjyqësore dhe ju referua edhe një kodi/tabele në raport, duke kërkuar sqarim se në cilën tabelë pasqyrohen këto të dhëna. Gjithashtu, ai theksoi se në një pjesë të dokumentit, te konstatimet, figuron se nuk ka pasur çështje përmbartimore gjatë këtij tremujori, duke kërkuar sqarim dhe verifikim të kësaj pjese.

Nënkrjetari i Komunës z. Enis Osmani u përgjigj se çështje përmbartimore ka, duke theksuar se ekzistojnë raste në vlerë rreth 300,000 € që janë tërhequr nga përmbartuesi prej komunës. Megjithatë, ai sqaroi se nuk është i sigurt nëse këto të dhëna hyjnë në raportin e tremujorit të parë apo të dytë, dhe se do ta verifikojë saktësisht dhe do të japë informacion më të detajuar më vonë.

Gëzim Stavileci iu drejtua Kryesuesit dhe drejtorit të shërbimeve publike, duke kërkuar informacion se sa kontrata aktive ekzistojnë në kuadër të investimeve kapitale në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës. Ai ngriti shqetësimin se si është e mundur që gjatë kuartalit të parë të qeverisjes të mos ketë as 0.1% realizim të shpenzimeve në investime kapitale, duke e vlerësuar këtë si të dëmshme për zhvillimin e qytetit. Ai i bëri thirrje nënkryetarit që të fokusohet më shumë në projektet dhe investimet kapitale, duke theksuar se çështjet e mirëmbajtjes si larja dhe pastrimi i rrugëve nuk duhet të jenë prioritet i nivelit ekzekutiv, pasi ato kryhen nga ndërmarrjet përkatëse. Gjithashtu, ai vlerësoi bashkëpunimin me ndërmarrjen komunale, por kërkoi që të mos përzihet kjo pjesë me politikën zhvillimore. Në fund, ai theksoi se nëse realizohen të paktën 50% të projekteve të qeverisjes së kaluar, kjo do të konsiderohej pozitive, ndërsa kërkoi që të mos mbeten kuartalet pa investime kapitale, duke e cilësuar këtë si një çështje thelbësore për zhvillimin e qytetit dhe mirëqenien e qytetarëve.

Nënkrjetari i Komunës z. Enis Osmani u përgjigj duke sqaruar se në pjesën e parë të periudhës kanë pasur edhe disa ndërhyrje në rrugë, mirëpo sipas tij faturat për këto punë ende nuk janë dorëzuar në Drejtorinë e Financave nga kompania e kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve. Ai theksoi se, sipas informatave që ka, bëhet fjalë për një kompani të mirëmbajtjes së rrugëve, por nuk ishte i sigurt nëse janë një apo dy kompani të tilla dhe se këtë mund ta sqarojë në mbledhjen e radhës. Sa i përket pjesës së debatit politik, ai tha se mënyra si janë lënë kontratat më herët është çështje e njohur dhe se nëse synohet debat politik, kjo është një temë tjetër. Ai kërkoi që të mos hyhet në debat politik për këtë çështje, duke theksuar se kjo vetëm po e vonon diskutimin. Ai shtoi se, në aspektin e menaxhimit të investimeve kapitale, situata nuk është e favorshme, duke përmendur se ka pasur bartje të të hyrave prej rreth 1.200.000 € vetëm në Drejtorinë e infrastrukturës. Sipas tij për këtë vit janë planifikuar rreth 700,000 €, ndërsa gjithsej janë paraparë 1.9 milion € për investime kapitale.

Gëzim Stavileci: sqaroi se nuk ka qenë i interesuar për debat politik, por ka dashur të fokusohet në një lutje konkrete, duke marrë parasysh profesionin e nënkryetarit si ekonomist dhe faktin që është nga qyteti i Mitrovicës dhe e do qytetin. Ai konkretizoi se në pjesën e shërbimeve janë gjetur kontrata aktive, si në sektorin e gjelbërimit ashtu edhe në larjen dhe fshirjen e rrugëve, të cilat sipas tij kanë qenë të nënshkruara edhe para përfundimit të mandatit të ish-kryetarit Bedri Hamza, me qëllim që qyteti të mos mbetet pa shërbime të pastrimit. Ai shtoi se edhe kontrata e gjelbërimit është aktualisht aktive. Në fund, ai i bëri thirrje Nënkrjetarit që të fokusohet më shumë në investimet kapitale, duke theksuar rëndësinë e tyre dhe duke kërkuar që të angazhohet në realizimin e premtimeve, pasi sipas tij kjo është në të mirë të përbashkët të qytetit.

Nënkrjetari i Komunës z. Enis Osmani reagoi duke theksuar se, në momentin kur pala tjetër ka humbur pushtetin, qyteti është përballur me probleme me mbeturinat, për shkak të mos nënshkrimit të kontratës me KRU "Uniteti". Ai

tha se kontrata e nënshkruar nga ish-kryetari Bedri Hamza ka qenë vetëm njëmujore dhe se gjatë periudhës tranzitore qyteti ka qenë i mbuluar nga mbeturinat për disa javë, gjë të cilën e konsideroi pasojë të atij vendimi. Ai shtoi se nuk dëshiron të kthehet në të kaluarën, por është i fokusuar në të ardhmen dhe në realizimin e investimeve kapitale. Në këtë kontekst, ai u shpreh se premtimet do të realizohen brenda mandatit, duke kundërshtuar qasjen e premtimeve pa zbatim. Sa i përket çështjes së KRU "Uniteti", ai theksoi se kontrata e parë me ndërmarrjen është bërë nga ana e tyre dhe se ajo ka qenë njëmujore, ndërsa pas marrjes së mandatit është vazhduar kontrata dhe shërbimet janë siguruar. Ai sqaroi se kontrata aktuale është valide deri më 30 prill. Ai shtoi se në momentin e marrjes së detyrës, kontrata e mëparshme kishte skaduar dhe se menjëherë është vepruar për vazhdimin e shërbimeve. Gjithashtu, ai theksoi se disa vendime të marra në periudhën para tranzicionit nuk do t'i komentojë në atë moment, por ato mund të trajtohen më vonë në aspektin ligjor. Në fund, ai përsëriti se shërbimet nuk kanë qenë subvencionim, por vazhdim i kontratave ekzistuese dhe sigurim i funksionimit të shërbimeve publike.

Kryesuesi i kuvendit e hedh në votim Raportin financiar për periudhën janar-mars 2026.

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi e konstatoi të miratuar Raportin financiar për periudhën janar-mars 2026.

Pika 15

Kryesuesi i kuvendit hapi diskutimin.

Valon Brahimi u ndal te çështja e vlerësimit të dëmeve, duke theksuar se i ishte referuar edhe më herët kësaj çështjeje para seancës. Ai vlerësoi se Nënkryetari ka vepruar mirë që e ka tërhequr si pikë nga rendi i ditës dhe gjithashtu se Kryetari ka vepruar drejt që ka urdhëruar komisionin për rivlerësim. Megjithatë, ai theksoi se rivlerësimi nuk është bërë në mënyrë të plotë dhe se ende ekzistojnë të dhëna të pasakta. Ai kërkoi sqarime nga nënkryetari dhe drejtoresha, duke e konsideruar raportin të pakompletuar dhe të mangët, sipas tij, raporti përmban shumë statistika dhe përshkrime, por nuk jep qartësi nëse dëmet e paraqitura realisht kanë ekzistuar, janë të sakta apo janë dëmtime të reja të konstatuara. Ai theksoi se raporti nuk përmban asnjë fotografi mbështetëse që vërteton konstatimet e komisionit, gjë që sipas tij nuk përmbush as kriterin minimal për shqyrtim dhe diskutim. Ai shtoi se, ndonëse e kupton angazhimin e drejtoreshës dhe përpjekjen për punë të mirë, raporti i komisionit është jashtë logjikës dhe duhet të tërhiqet ose të plotësohet përpara se të vijë sërish në seancë. Sipas tij, nëse miratohet një raport i tillë, kjo do të përbënte një gabim të madh institucional. Ai theksoi se nuk ka asnjë dëshmi fotografike që mbështet konstatimet dhe se kjo situatë krijon edhe pabarazi krahasuar me sektorët e tjerë si ekonomitë familjare dhe bujqësia, për të cilat, sipas tij, raportet janë të shoqëruara me foto. Në fund, ai kërkoi që raporti të rikthehet në seancën e ardhshme të kompletuar dhe me dokumentacion të plotë, përfshirë fotografi dhe dëshmi përkatëse. Ai shtoi se, nëse komisioni nuk ka vepruar në përputhje me ligjin dhe udhëzimet e Kryetarit, duhet të merren masa dhe përfundoi duke kërkuar tërheqjen e pikës nga rendi i ditës derisa të plotësohet me dokumentacion të plotë mbështetës.

Drejtoresha Fitore Behrami pasi përshëndeti të pranishmit u ndal te raporti i vlerësimit të dëmeve, duke theksuar se në seancën e kaluar raporti u ishte dërguar edhe me email në formë të detajuar, i shoqëruar me fotografi, pasi ishte kërkuar rivlerësimi i dëmeve të shkaktuara në biznese nga vërshimet. Ajo sqaroi se komisioni i ka specifikuar të gjitha gjetjet dhe vlerësimet e tij në bazë të asaj që ka konstatuar në terren dhe se as ajo si drejtoreshë, as Kryetari dhe as Nënkryetari nuk mund të ndërhyjnë në përmbajtjen e raportit të komisionit. Në fund, ajo theksoi se raporti është punë e komisionit dhe se nuk është në kompetencë të ekzekutivit të ndryshojë apo të ndërhyjë në gjetjet e tij.

Valon Brahimi theksoi se në mbledhjen e kaluar, për ekonomitë familjare dhe bujqësinë, ka pasur dokumentim me fotografi, ndërsa sipas tij për bizneset nuk ka pasur të njëjtin nivel të dëshmive. Ai kërkoi ndjesë nëse ka gabuar, por u shpreh i bindur se raporti nuk përmban fotografi mbështetëse. Sipas tij, një raport pa fotografi dhe pa dëshmi mbështetëse nuk mund të pranohet në asnjë institucion. Ai theksoi se raporti nuk duhet të jetë vetëm një dokument me shifra, por duhet të pasqyrojë gjendjen reale në terren, në mënyrë që të verifikohet saktë dëmi i shkaktuar. Në këtë kontekst, ai dha shembull duke thënë se, në rastet kur raportohet për dëmtime në bagëti, duhet të ketë dëshmi konkrete në terren dhe jo vetëm deklarime, duke theksuar se vendimmarrja nuk mund të bëhet në mënyrë të pakontrolluar apo pa verifikim real. Në fund, ai përsëriti qëndrimin se një raport i tillë nuk duhet të votohet pa prova dhe dokumentacion të plotë mbështetës. Ai iu drejtua drejtoreshës dhe nënkryetarit duke kërkuar me mirësjellje që raporti të sillet i kompletuar, veçanërisht me përfshirjen e fotografive mbështetëse. Ai theksoi se nuk mund të pajtohet me miratimin e raportit në këtë formë, pa dokumentacion të plotë dhe pa dëshmi vizuale. Sipas tij, raporti aktual nuk është i kompletuar dhe paraqet vështirësi për votim. Ai shtoi se kërkesa e tyre nuk nënkupton mosvlerësim të punës së bërë, por vetëm nevojën për plotësim të raportit me të gjitha elementet e domosdoshme. Në fund, ai theksoi se nuk duhet të krijohet situatë ku votimi interpretohet si kundërshtim ndaj bizneseve, por të sillet raporti i plotë dhe më pas të procedohet në mënyrë të përbashkët dhe korrekte.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka fotografi Raporti i kaluar apo jo?

Fitore Behrami: Po ka, në email e keni.

Erseka Barani u ndërlidh duke sqaruar se, nëse anëtarët e Kuvendit i kanë të disponueshme emailat e tyre, mund të verifikojnë se përveç ekonomive familjare ku ka fotografi dhe dëshmi, ekzistojnë gjithashtu dëshmi të dokumentuara me fotografi edhe për dëmet e shkaktuara nga vërshimet në bujqësi. Ajo theksoi se ekzistojnë gjithashtu dëshmi edhe për vërshimet në biznese dhe se këto materiale përbëjnë një plotësim të raportit që është kërkuar më herët nga Kuvendi Komunal. Në fund, ajo shtoi se ky material është i përfshirë në dokumentacionin e mbledhjes së shtatë të Kuvendit Komunal dhe mund të gjendet aty nga anëtarët.

Kryesuesi i kuvendit theksoi se po diskutohet për një dokument zyrtar që është aktualisht në shqyrtim dhe se nuk është relevante çfarë ka përmbajtur raportin e mëparshëm. Ai sqaroi se fokusi duhet të jetë vetëm te raporti konkret që ndodhet para anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë, duke theksuar se sipas tij në këtë dokument nuk ka fotografi mbështetëse. Ai theksoi se vendimmarrja duhet të bazohet në këtë dokument dhe kërkoi sqarim nëse mungesa e fotografive në raportin aktual përbën arsye për mosmiratimin e tij në momentin e votimit.

Shkëlqim Ibrahim: Kryesuesi dha një sqarim lidhur me raportin e vlerësimit të dëmeve, duke theksuar se edhe në procesverbalin e mëparshëm ekziston një konstatim i përbashkët me nënkryetarin se raporti duhet të ndryshohet. Ai sqaroi se nënkryetari ka cekur se ka pasur edhe ballafaqim direkt me komisionin, i cili nuk është pajtuar për çështjet e vlerësimit, dhe se për këtë arsye ishte kërkuar tërheqja e raportit dhe sjellja e një raporti të ri. Sipas tij, edhe raporti i sjellë sot është i njëjti dhe nuk përmban ndryshimet e kërkuara, ai theksoi se grupet janë pajtuar që raporti të tërhiqet dhe të silllet i plotësuar dhe shtoi se përveç fotografive, është e nevojshme të përfshihet edhe metodologjia dhe çmimorja referuese nga Agjencia e Statistikave, si dhe një listë e çmimeve të përdorura për vlerësim, në mënyrë që të ketë bazë të qartë për llogaritjen e dëmeve. Ai theksoi se sipas rregullores duhet të ekzistojë një vlerë referente për çdo objekt të dëmtuar, në mënyrë që vlerësimi të jetë i saktë dhe i verifikueshëm. Në fund, ai u shpreh se qëndrimi është për shtyrjen e pikës dhe kthimin e raportit për plotësim me fotografi dhe dokumentacion shtesë, duke e konsideruar këtë si mënyrën e duhur për ta përfunduar çështjen në mënyrë korrekte dhe të verifikueshme.

Gjergj Beka u pajtua me kolegun Valon dhe kërkoi që pika në fjalë të shtyhet për një seancë tjetër, me arsyetimin se duhet të kompletohet me dokumentacionin e nevojshëm. Ai theksoi se, sipas tij, raporti i sjellë nuk ka ndryshime në krahasim me raportin e parë, duke e cilësuar si kopje të tij. Ai u shpreh se kërkesa për një vlerësim më të detajuar nuk është përmbushur dhe kërkoi që raporti të rishikohet dhe të plotësohet përpara se të silllet sërish në seancë. Në fund, ai kërkoi që pika të shtyhet dhe të kompletohet siç është kërkuar, duke u shprehur se raporti aktual nuk i përmbush kërkesat e Kuvendit.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Ai theksoi se shqetësimi për këtë çështje nuk është vetëm individual, por është i përbashkët. Ai sqaroi se e ka kontaktuar drejtoreshën dhe i ka bërë me dije se raporti është i njëjtë me atë të mëparshmin. Ai shtoi se ka pasur takime me anëtarët e komisionit, të cilët kanë deklaruar se nuk mund të hartojnë një raport tjetër jashtë atij që kanë përgatitur më parë. Sipas tij, raporti në përgjithësi është i saktë dhe është i nënshkruar, me fotografi të bashkangjitura, brenda kompetencave që ka komisioni. Ai theksoi se rivlerësimi është bërë në masën që ka qenë e mundur dhe se komisioni ka marrë përgjegjësinë për gjendjen e konstatuar në terren. Sipas tij, edhe pse ekzistojnë mospajtime rreth përmbajtjes, ky është raporti i komisionit dhe jo i ekzekutivit. Në fund, ai theksoi se pavarësisht mendimeve të ndryshme, raporti duhet të trajtohet si dokument i komisionit përkatës, i cili mban përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

Kryesuesi i Kuvendit: Ai theksoi se ky është raporti i komisionit, i cili është themeluar me një vendim dhe ka dalë në terren për të bërë vlerësimin përkatës. Sipas tij, komisioni ka kryer detyrën e vet dhe normalisht është dashur të sjellë një raport profesional, të bazuar në vlerësim të saktë dhe në përputhje me mandatin e dhënë. A ka dikush tjetër.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Ai theksoi se, për hir të bashkëpunimit, pika në fjalë po tërhiqet dhe shtyhet për mbledhjen e radhës. Ai sqaroi se bashkërisht me drejtoreshën dhe komisionin do të shqyrtohet mundësia për një rivlerësim dhe plotësim-ndryshim të raportit, në mënyrë që ai të silllet në formë të plotë në seancën e ardhshme, megjithëse nuk pajtohet me komisionin, megjithatë do të kërkohet një zgjidhje e përbashkët për të siguruar korrektësi në proces. Në fund, ai e konsideroi shtyrjen e pikës si kërkesë të përbashkët si nga pozita ashtu edhe nga opozita, duke theksuar se vendimi merret për të ruajtur bashkëpunimin dhe korrektësinë institucionale.

Kryesuesi i Kuvendit faleminderon Nënkryetarin dhe thekson se kalojmë në pikën e radhës.

Pika 16

Kryesuesi i Kuvendit sa i përket plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të komunës Nr. 02-060/01-0014451-11/26 dt. 27.03.2026 Për Formim të Komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomike-sociale të familjeve

përfituese të banesave apo shtëpive të cilat janë në pronësi apo në menaxhim të Komunës, sqaroi se bëhet fjalë për plotësimin e preambulës dhe të kompetencave të komisionit, respektivisht ndryshime teknike në vendimin ekzistues, në përputhje me sugjerimet e ardhura nga Ministria. Ai theksoi se këto sugjerime janë inkorporuar në vendimin ekzistues dhe nuk bëhet fjalë për ndryshime substanciale. Më pas, propozim-vendimi u hodh në votim.

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi e konstatoi të miratuar Vendimin Për plotësim dhe ndryshimin e vendimit Nr. 02-060/01-0014451-11/26 dt. 27.03.2026 Për Formim të Komisionit për rivlerësimin e gjendjes ekonomike-sociale të familjeve përfituese të banesave apo shtëpive të cilat janë në pronësi apo në menaxhim të Komunës.

Pika 17

Kryesuesi kaloi në pikën e radhës të rendit të ditës, përkatësisht raportin teknik mbi rrëshqitjet e dheut në Lagjen “Bair” në Mitrovicë për periudhën 2023–2026, që përfshin vlerësimin e dëmeve, analizën e shkaqeve dhe rreziqeve për banorët. Ai pyeti nëse dikush dëshironte të diskutonte lidhur me këtë çështje. Më pas theksoi se raporti është një dokument mjaft voluminoz dhe, sipas tij, i punuar në mënyrë profesionale nga komisioni përkatës, duke vlerësuar se bëhet fjalë për një trup profesional që ka kryer vlerësimin. Ai shtoi se, edhe pse është i fushës, nuk ka arritur ta lexojë tërësisht dokumentin dhe i ftoi anëtarët e Kuvendit që ta shqyrtojnë me kujdes.

Ferdi Kadriu përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se ka pasur mundësi ta shohë materialin, duke qenë se raporti është voluminoz dhe teknik, i karakterit profesional dhe vështirë i kuptueshëm për profile të tjera profesionale. Ai vlerësoi se çështja është me interes të veçantë për banorët e lagjes “Bair”, duke qenë një zonë e ndjeshme dhe problematike. Ai ngriti shqetësimin lidhur me situatën e familjeve të prekura, duke pyetur nëse është paraparë ndonjë mbështetje për qira, pasi një numër i konsiderueshëm familjesh janë ende të zhvendosura nga shtëpitë e tyre dhe po përballen me shpenzime të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes. Ai theksoi se, në raportet dhe rastet e vërshimeve të vitit 2023, nuk janë realizuar kompensime të plota nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), përveç disa mbështetjeve të kufizuara nga kapacitetet komunale të asaj kohe. Gjithashtu, ai kërkoi që të gjendet mundësia e ndërmarrjes së veprimeve konkrete, duke theksuar se në terren situata është e vështirë dhe nuk mund të jetohej lehtë në atë zonë. Ai pranoi se zgjidhja e menjëhershme mund të tejkalojë kapacitetet financiare aktuale të komunës dhe se mund të kërkohet mbështetje nga niveli qendror, por theksoi nevojën për përcaktimin e hapave konkretë për familjet e prekura, të cilat po vazhdojnë të përballen me kosto dhe vështirësi të përditshme.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Po, sa i përket raportit të Bairit, nuk jam i inkurajuar me u kthyer te e kaluara. Mirëpo, sa i përket kësaj, ju e keni bërë raportin vetëm për katër shtëpi të Bairit. I keni subvencionuar, dhe është mirë që i keni subvencionuar. Ne momentalisht kemi tetë familje që janë me qira, edhe para tri ditësh, kur i kemi takuar, e kemi lypur numrin e banorëve të saktë që janë duke qëndruar me qira. Tash shohim që duhet me ua mbuluar shpenzimet e qirasë atyre tetë familjeve. Mirëpo, ky raport sa i përket Bairit ka mundur me shku edhe më herët, sepse janë bërë tre vjet dhe po bie në një Kuvend Komunal për aprovim, kjo ka dashur me qenë shumë më herët, besoj. Kjo është punë që ka dashur me qenë më efikase prej qeverisjes së kaluar. Nuk po them asnjë term për me ju fajësuar juve, mirëpo nuk e keni bërë. Tjetra është sa i përket këtyre tetë familjeve, besoj shumë që keni me subvencionu qiranë për këtë vit, ndërsa për vitin e ardhshëm të shohim. Sa i përket AME-së, është niveli qendror ai që i bën pagesat. Ne si komunë e dimë se vlera totale e krejt asaj është rreth 10.000.000 €. Vlerësimi komplet i asaj pjesë duhet me u bërë, kështu që kushton 10.000.000 €, e dini ju vetë, sepse keni qenë ekzekutiv dhe e dini që nuk kemi mbulesë për këtë pjesë. Mirëpo, sa i përket ekonomive familjare, vlera e shpronësimit sipas raportit është diku rreth 3.000.000 €, nëse nuk gaboju. Kjo është një gjë që duhet me çu për raport, pastaj çështja e pagesave shkon më tej. Ne e shohim çfarë mundemi me bë, mirëpo sa na përket neve, është subvencionimi për këto tetë familje.

Ferdi Kadriu: Nënkryetar, unë u mundova me bë një përmbledhje. Megjithatë, të njoftoj që janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme. Po ai zotëria që ke qenë bashkë me të në vizitë prej ministrisë, atje janë bërë vlerësimet tutje. Po mendoj që krejt këto çështje procedurale kanë qenë, edhe kohë pas kohe mandej na kanë qenë këtu dhe është rritur numri i familjeve. Po megjithatë, reagimi ka qenë në kohë, brenda mundësive tona. Kështu që unë as nuk po mendoj, as nuk e hapa diskursin politik, thjesht kërkova çka mundemi me vepru, jo diçka tjetër. Pak është mirë me u zhvesh prej këtij kompleksit të qeverisjes së kaluar, sinqerisht po ju them, e din, kjo vlen për krejt ekzekutivin dhe të këqyrim veç tash e tutje çfarë mundemi me bë.

Gëzim Stavileci: Dua të ndërlihem me temën e banorëve të Bairit. Kisha propozuar, Nënkryetar, pasi qeveria po premton që ka me i bë banesat sociale, edhe ne sot si pikë të rendit të ditës e kemi komisionin që kemi me i ndryshua banesat sociale, që qeveria me i përfshi të paktën në banimin social banorët e Bairit, nuk është numër shumë i madh. Nëse hyni në kompensim të pronave, është komuna e Mitrovicës. Ne e dimë që ka shumë pak prona publike, kështu që si propozim merre, duke e përfshirë kompensimin e pronave që i kanë në Lagjen Bair, me u kompensua

me nga një banesë, e cila besoj që është e mirëseardhur. Ju e propozoni te banorët; nëse pranojnë banorët, është në rregull dhe ka kosto shumë të vogël.

Gjergj Beka: Sa i përket kësaj pike, është e mirëseardhur dhe uroj që të zbatohet sa më shpejt dhe t'u ndihmohet këtyre familjeve. Gjithashtu, kam një kërkesë për drejtoreshën e Emergjencave, por edhe për nënkryetarin, që t'u jepet prioritet kompensimit sa më të shpejtë të familjeve të prekura nga rastet e zjarreve në fshatrat Kçiq i Madh, Kçiq i Vogël dhe Shufkofc. Sa kam informacion deri më sot, nuk është se po merret fort kush me këtë punë, edhe dua të di, sepse dëmet kanë qenë goxha të mëdha.

Kryesuesi i Kuvendit: Po, Nënkryetar, domethënë atij që e bën raportin duhet me i bërë presion e ai që s'e ka prurë raportin, prandaj edhe unë i bashkëngjitëm kërkesës së Gjergjit që realisht të sillte raportin dhe dëmet të zjarrit në Kçiq, sikur raportet e tjera në Kuvend, edhe që ta aprovojme si të tillë.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Më vjen keq që raporti i Bairit dhe i fshatrave Kçiq i Madh dhe Kçiq i Vogël nuk ka ardhur. Është dashur me ardhë në Kuvendin e kaluar. Tash është çështje ditësh ajo që ka qenë nuk mundet me marrë. Unë e kuptoj komplet atë pjesë. Mirëpo, komisioni ka mundur me pas raport. Ne nuk kemi as raport të detajuar. Ju është dashur me themel komisionin për çështjen e zjarrit. Ai komision, nuk e di a e keni themeluar apo pse s'e keni themeluar? Për hir të korrektësisë, nuk është se keni raport. Nuk është asnjë dokumentacion. Nuk e kemi pranuar asnjë dokumentacion për çështjen e zjarrit në Kçiq të Madh e as në Kçiq të Vogël. I kemi dy asamblistë, apo tre prej Kçiqit. Tre, nuk e di a ka më shumë, katër me Gjergjin. Nuk ka komision që e ka bërë vlerësimin e zjarreve në Kçiq. Ne jemi shqetësuar. Në njërin prej mbledhjeve të ardhshme ka me ardhë edhe raporti i zjarrit. Tash nuk e di sa ka me mujt komisioni me bërë një raport efikas, sepse ajo ka dashur me ndodh në atë kohë. Unë e di që Komuna e Mitrovicës, atëherë kur kemi qenë në nivel qendror, i ka marrë të gjithë hapat dhe i ka ndihmuar, mirëpo raport nuk keni bërë. Ai komision nuk e ka bërë raportin për vlerësimet e zjarrit në fshatin Kçiq. Ky është realiteti.

Fitore Behrami: Po desha veç me ndërlidh që te krahasimi i zjarreve këtu, ka ndodhur domethënë në vitin 2023-2024, ndërsa në Kçiq ka ndodhur në vitin 2025 edhe pse nuk i kanë sjellë në periudhën tuaj, po i kërkon tash, edhe pse këto janë fatkeqësi të cilat edhe ne si komunë po na prekin. Por është dashur të sillen edhe më herët.

Gjergj Beka: Unë, sa kam informacion zyrtar, domethënë që pothuajse ndoshta të njëjtit emra që i kanë bërë këto vlerësimet e dëmeve, është i njëjti komision që ka dalë në terren edhe në fshatin Kçiq. Kështu që është mirë me i pyet ata. Po besoj që e kanë një raport; ndoshta nuk ka interesim, në fund të fundit, me u marrë me atë punë, por mundesh me kërku. Po besoj që raporti është aty. Pse s'u kërku më herët e pse po kërkohet tash, realisht po besoj që ndoshta nuk është mirë me u lëshu në detaje. Po sot, nëse mundemi me ndihmu me bërë punë të mira, është mirë.

Kryesuesi i Kuvendit: Rëndësi ka që raporti në Kuvend s'ka ardhur, e ne po e kërkojmë një raport. Mundësisht, drejtoreshë, me na e përgatit, nëse ka dëshmi për atë raport, me ia sjellë Kuvendit që Kuvendi me e miratua si të tillë dhe me këqyr se cila është mundësia financiare për ato familje.

Valon Brahimi: Drejtoreshë, Po i merr gjërat personale, por këto janë gjëra institucionale. Kur them jo, nuk të referohem si ti, por si institucion. Mirë, ka përtej kësaj. A e di pse mua nuk po më befason shumë kjo çështje, se si ne merremi me këtë problematikë? Mua më ka befasuar më shumë çështja që është djegur Kçiqi dhe nuk ka pasur vizitë hiç në atë kohë nga kryetari Faton Peci, kjo është më e keqja. Domethënë, është i vetmi zyrtar që nuk e ka vizituar. Atje jam qenë, në ngjarje, unë e di që nuk e ka vizituar as nuk është marrë me atë punë. Po faleminderit. Tash çka dua me thënë është që Kçiqi ka ndodhur mesi i gushtit, edhe Kuvendi ka qenë pothuajse jofunksional, ne s'kemi pasur të drejtë me marrë vendime si Kuvend, se kishim prurë normal. A zyrtarët komunalë kanë qenë në terren dhe u është kërkuar zyrtarëve raporti që e kanë, nëse s'e kanë, thuaj ku e keni lënë, se ata e kanë raportin.

Flamur Vojvoda: Është mbledhja e dytë që ne jemi duke diskutuar për një raport të madh dhe po pajtohemi të gjithë. Unë kisha propozuar që t'i jepet një afat kohor komisionit për plotësim, sepse nuk mundemi në çdo seancë me ardhë edhe me thënë plotësohet dhe plotësohet. I caktoni kriteret të cilat duhet me i pasur raporti i plotë, sepse në anën tjetër ne jemi duke thënë veç po tutemi me votu se mos po i ndihmojmë dikujt, a jeni duke llogarit që edhe jeni duke dëmtuar dikë? Sepse dikush është duke folur për vërshime, për fatkeqësi që kanë ndodhur, ka kohë që kanë ndodhur, dhe ata kanë nevojë për me ju ndihmuar. Kështu që kisha propozuar: caktoni kriteret qysh duhet me qenë i plotë raporti dhe besoj që ai kalon. Përndryshe, kështu jemi veç duke humbur kohë për një pikë të cilën s'jemi duke e çuar përpara.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Z. Brahimi, është e pasaktë dhe është e pavërtetë ajo që the, që nuk ka qenë ministri në atë kohë në vizitë. Personalisht kemi qenë në vizitë unë së bashku me ministrin dhe ka qenë me neve edhe deputetja znj. Fejza. Ne kemi qenë dhe e kemi vizituar. Është mirë me e tërheq fjalën, me kërku falje. Nuk është kurrëgjë. Personalisht ta dëshmoj përmes fotografive tash unë. Ndërsa tjetra është sa i përket raportit. Raporti i Bairit

është i detajuar me ato që ka bërë komisioni. Sa i përket fshatit Kçiq, ai vjen në një seancë tjetër. Mirëpo, raporti i Bairit, gjithçka është në rregull.

Valon Brahimi: Nëse nuk kam të drejtë unë kërkoj falje menjëherë. Nuk ka problem, s'kam problem me kërku falje. Veç dëshmoje. Po nëse kjo foto e dëshmon, do të kërkoj falje.

Kushtrim Zeneli: E përshëndes që është një raport shumë voluminoz dhe është një raport shumë i mirëpritur, që kemi pasur njëherë një raport që na ka ardhur të kaluarën kaq i detajuar. Kështu që uroj që të merren sa më shpejt hapat, krejt bashkëpunim edhe me qeverinë edhe me ministrinë, që të bëhet zgjidhja e këtij problemi.

Sa i përket, për hir të korrektësisë, banimit social të përballueshëm, është mirë me e shqyrtuar atë mundësi, mirëpo është mirë me ditë edhe qytetarët pse sot është ky projekt kaq i vonuar. Pikërisht është për shkak që komuna e atëhershme, drejtoria, nuk e ka ndalë përcjelljen për banim social të përballueshëm. Edhe sot ne tash detyrohemi me u vonuar me një projekt që i prek qytetarët e Mitrovicës, për shkak të neglizhencës të ekzekutivit të atëhershëm komunal. E dyta, jam shumë i interesuar me pa një raport për Kçiqin. Uroj, drejtoreshë, që ta gjesh, sepse është shumë problem tash me dalë edhe me i bërë fotografitë. Ndoshta ne si Kuvend Komunal nuk kemi mundur me marrë vendim atëherë për ndihmë. Çka ka ndodhur, cilat ngjarje, cilat janë dëmet që i kanë bërë zjarret në atë kohë dhe tash në prill, domethënë gati mbas një viti, të hyjë në raport. Uroj, drejtoreshë, me pru një raport, edhe bash jam i interesuar.

Kryesuesi i Kuvendit: meqenëse nuk ka të lajmëruar të tjerë e hedh në votim Raportin teknik mbi rrëshqitjen e dheut në Lagjen Bair, Mitrovicë (2023-2026).

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi e konstatoi miratuar vendimin për miratimin e Raportit teknik mbi rrëshqitjen e dheut në Lagjen Bair, Mitrovicë (2023-2026)

Pika 18

Kryesuesi i Kuvendit: Sekretaria e Kuvendit, bashkë me sekretarin, e ka hartuar Planin e punës së Kuvendit. Ne kemi tentuar me u përcjellë. Është njëfarë orientimi i pikave të rendit të ditës edhe për ekzekutivin, që paraprakisht me u përgatit, me e ditë se cila seancë, cila pikë e pret. Ne kemi me marrë disa sugjerime prej ekzekutivit. Ato do të futen ose do të inkorporohen në planin e punës. A ka ndonjë vërejtje ose sugjerim nga anëtarët e Kuvendit në raport me planin e punës së Kuvendit? Besoj që në takimin me shefat e grupeve e diskutuam këtë çështje. Sido që të jetë, besoj që ata të cilët kanë qenë pjesë e këtij komisioni për hartimin e planit të punës e kanë pasur për obligim me qenë, kanë qenë me pagesë dhe ndonjëherë janë mbledhur pak më shpesh.

Kryesuesi i Kuvendit meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim e hedh në votim Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2026.

Rezultati i votimit: 29 anëtarë të pranishëm, 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi e konstatoi të miratuar vendimin për miratimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2026.

Pika 19

Propozim Vendimi për obligimin e komisionit të komunës që të bëjë zhvlerësimin e laptopëve të legjislaturës së kaluar, në përputhje me rregulloret në fuqi (nuk është shqyrtua).

Pika 20

Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet e mbledhjes së 8-të të rregullt të Kuvendit të Komunës në ora 13:30 min.

**Mitrovicë
29.04.2026**

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit
KOPJE :	Arkivit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Faton PEÇI - Kryetari i Komunës së Mitrovicës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Mitrovicës 2027-2029

E nderuar,

Organizata buxhetore (642) – Komuna e Mitrovicës, në zbatim të Ligjit Nr. 03/ L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi dhe plotësim ndryshimeve të tij si dhe Qarkorës Buxhetore nr. 2027/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e ka përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Përmes kësaj shkrese kërkojmë nga KPF/Kuvendi Komunal aprovimin e këtij dokumenti që paraqet kërkesën e Komunës së Mitrovicës për caktimin e kufijëve në kategori ekonomike.

Në shtojcë :

Kornizen Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Me respekt !



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of South Mitrovica



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2027 - 2029

Qershor 2026

<https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/>

PËRMBAJTJA

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2027 – 2029.....	3
Pjesëmarrja e Granteve në totalin e Buxhetit Komunal sipas viteve 2027 – 2029	9
Planifikimi i të hyrave vetanake komunale 2027 - 2029	9
Vlerësimet e herëshme të shpenzimeve të kategorive ekonomike 2027-2029	12
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELI	13
ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	13
DREJTORIA E BUJQËSISË.....	14
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM, TURIZËM DHE INTEGRIME EVROPIANE.....	15
DREJTORIA PËR SHERBIME SOCIALE	15
DREJTORIA E SHËNDETËSISË	16
KULTURË, RINI DHE SPORT	17

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2027 – 2029

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale e Mitrovicës, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal që do të pasqyroj caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2027/2029, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) përmes Qarkorës Buxhetore 2027/01 për Komunitet të lëshuar me datën 15.05.2026.

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) komunale paraqet një dokument të procesit për zhvillimin e buxhetit duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burrave, që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Çdo program buxhetor është trajtuar me kujdes për plotësimin e nevojave dhe kërkesave me komponentë të ndjeshme gjinore. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetet e tanishme dhe afatmesme të Komunës së Mitrovicës së Jugut si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2027 – 2029 gjithnjë duke u bazuar në:

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal dhe
- Ligji i buxhetit

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2027 – 2029 planifikohet në bazë të kufijve Buxhetit, i cili bazohet në buxhetin e programeve dhe është i bazuar në objektivat dhe në deklaratat e misionëve të programeve. KAB-i komunal 2027–2029 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkorës Buxhetore nr. 2027/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në secilën fazë të planifikimit të buxhetit 2027-2029 do të mirren parasysh kërkesat e qytetarëve, grupeve të interesit, ku do të përfshihen problemet e burrave dhe grave me qëllim të përmbushjes së kërkesave të tyre dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

MISIONI:

Rritja e mirëqenies qytetare duke iu ofruar shërbime sa më të shpejta dhe cilësore duke u bazuar në zgjidhjen e problemeve të tyre me të cilat ballafaqohen qytetarët (gratë dhe burrat).

Objektivat e Komunës së Mitrovicës së Jugut :

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit me rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatrat e komunës tonë, zgjerimin e rrjetit të ndriqimit publik me mundësi të barabarta në rritjen e sigurisë së grave.
- Zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimi i planeve rregullative në zonat urbane si dhe hartat zonale.
- Parandalimi (preventiva), edukimi shëndetësor, promovimi i shëndetit dhe këshillimi shëndetësor, imunizimi dhe vaksinimi, shërbimi shëndetësor urgjent 24 orë, shërbimet e shëndetit oral, kujdesi për shëndetin mendor bazuar në bashkësi, kujdesi shëndetësor riprodhues dhe metoda e planifikimit familjar, vizitat shtëpiake për shtatzëna, nëna të reja dhe fëmijë si dhe për kujdesi shëndetësor paliativ.
- Përfshirja e vajzave dhe djemve në arsim parashkollor, fillor dhe të mesëm si dhe ngritja e nivelit të arsimit.
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive për djemtë dhe vajzat me funksionalizimin e sallave sportive, zhvillimin e kulturës përmes shfaqjeve me premiera dhe reprizave si dhe përmes subvencionimit të projekteve përmes OJQ-ve për vitet 2026-2028 ku 50% do të shfrytëzojnë burrat/djemtë dhe 50% gratë/vajzat.
- Përkrahja e të rinjve përmes START-UP biznese ku do të shfrytëzohen 60% për vajza/gra dhe 40% djem/burra.

Objektivat dhe përfitimet e procesit të KASH-it për komunat

Inkorporimi i qasjes së KASH në proceset e buxhetit komunal është i motivuar nga qëllimet e mëposhtme:

- Të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse dhe reale për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme;
- Të rrisë parashikimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit të buxhetit përmes futjes së parashikimit më të besueshëm të të hyrave vetanake komunale dhe shpenzimeve në perspektivë tre vjeçare;
- Të përmirësojë lidhjen në mes procesit të alokimit të burimeve dhe prioriteteve të politikave komunale;
- Të fuqizohen drejtoritë komunale në shpërndarjen e burimeve, menaxhim dhe shfrytëzim;
- Të bëhet planifikimi sa më objektiv dhe real nëpër kategori ekonomike përmes sistemit – BDMS;
- Të pregaditet Plani i rrjedhës së parasë së gatshme për vitin fiskal;
- Të bëhet planifikimi i mjeteve buxhetore për vitet e ardhshme sipas kategorive ekonomike;
- Menaxhimi më efikas i kontratave kornizë – tri vjeçare;
- Planifikimi i Investimeve Kapitale përmes sistemit të PIP-it;
- Përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat si një implementim i nevojshëm për të garantuar parimin e barazisë gjinore.

Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;
- Planifikimi i buxhetit në kode dhe nënkode ekonomike të shpenzimeve;
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
- Respektimi dhe Shpenzimi i buxhetit sipas CASH FLOW;
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim;
- Respektimi i afatit kohorë të pagesave dhe menjanimi i pagesave direkte nga Thesari.

Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Implementimi i rekomandimeve të auditorëve të ZKA dhe NJAB;
- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore komunale;
- Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;
- Profesionalizimi i shërbimeve komunale.

Të sigurohet disiplina financiare

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe me udhëzimet administrative,
- Ekzistenca e kontrolleve interne – Auditori i Brendshëm dhe implementimi i rekomandimeve,
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik,
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve,
- Planifikimi dhe ekzekutimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh Planit),
- Planifikimi dhe realizimi Investimeve Kapitale sipas programit të PIP (Programi Investime Publike),
- Respektimi i Ligjit të Buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

Ekonomia

- Zhvillimi i Strategjisë Komunale për promovim ekonomik,
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm,
- Strategjia për zhvillimin rural dhe turizëm,
- Strategjia për Biodiversitet.

Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparencë

- Respektimi i procedurave të prokurimit,
- Evidenca e duhur financiare dhe procedurat e kontabilitetit,
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës,
- Koordinimet në mes drejtorive – programeve buxhetore,
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat,
- Menaxhimi i bazës së të dhënave,
- Informimi publik.

Përmirësimi i bazës së të hyrave vetanake komunale

- Rritja e performancës së inkasimit të tarifave dhe taksave komunale,
- Regjistrimi i tatimpaguesve të rinj për tatimin në pronë,
- Tarifa (ngarkesa) të reja për shërbime të reja,
- Tarifa (taksa) ekonomikisht të arsyetuara,
- Ngarkesa të reduktuara (periodike),
- Rritja e efikasitetit në inkasim të të hyrave vetanake dhe të arkëtueshmeve.

Ristrukturimi organizativ

- Shqyrtimi i strukturës organizative - Organogrami i ri,
- Plotsim ndryshim i Rregullores për Organizimin e kompetencave të drejtorive komunale.

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:

- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve tjera
- Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje
- Zbatimi dhe respektimi i rregulloreve komunale
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës për vitin 2027
- Përgatitja e Qarkoreve Interne Komunale
- Mbajtja e Dëgjimeve Buxhetore me qytetarë

- Përgatitja e planeve rregullative dhe detaje
- Përmirësimi i mbledhjes bazike të të dhënave dhe analiza e tyre
- Shqyrtimi i përgjegjësisë dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi.

Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë i kemi kushtuar politikave fiskale, politikës së të ardhurave si nga Granti i Qeverisë, të Hyrave Vetanake komunale, shpenzimeve, ku janë marrë për bazë nevojat e grave dhe burrave gjatë planifikimit, duke filluar nga aspekti i punësimit, përfituesve të bursave, participimin në vendim marrje për projektet e ndryshme, kultura, subvencione, pjesëmarrja në dëgjimet publike etj.

Me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2027 - 2029 e cila është aprovuar nga Qeveria e Kosovës, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe Kornizës Makro – Fiskale për 2027 -2029, Qeveria është përkushtuar që duke e ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë edhe kërkesat e Organizatave Buxhetore duke paraparë ndërmarrjen e një varg masash, që nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve operative – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së¹ e deri te marrja e masave konkrete në realizimin e të Hyrave në nivel Qendror dhe Lokal si :

Kontroll më efikas dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifat e mbledhura në nivel lokal.

Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës.


¹ Fondi Monetar Ndërkombëtar

Pjesëmarrja e Granteve në totalin e Buxhetit Komunal

Grantet Qeveritare dhe të Hyrat Vetanake Komunale 2027 - 2029				
Nr.	Përshkrimi	2027	2028	2029
1	Granti i Përgjithshëm	14,529,076.00	15,186,826.00	16,383,779.00
2	Granti specifik për Arsim	11,682,190.00	12,032,656.00	12,393,636.00
3	Granti specifik për shëndetsi	3,243,374.00	3,340,675.00	3,440,895.00
4	Financimi për Teatro	295,346.00	311,590.00	328,728.00
5	Financimi për Shërbime Rezidenciale	382,500.00	415,000.00	415,000.00
	Gjithësej Granti	30,132,486.00	31,286,747.00	32,962,038.00
6	Të Hyrat Vetanake	3,912,644.00	4,052,266.00	4,282,816.00
	Totali i Buxhetit	34,045,130.00	35,339,013.00	37,244,854.00

Tabela 1

Grafiku : Pjesëmarrja e Fondeve të Financimit në Buxhetin Komunal 2027 sipas Qarkores Buxhetore 2027/01



Planifikimi i të hyrave vetanake komunale 2027 - 2029

Të hyrat komunale të komunës së Mitrovicës realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullorës mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullorës mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave

tjera ligjore, të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale, me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra tjera komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë dhe tokë dhe të hyrat nga Lejet e ndërtimit, të cilat të hyra duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera, gjë që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës publike komunale.

Të Hyrat Vetanake të Komunës për vitet 2027 – 2029 parashikohen të inkasohen kryesisht nga :

- Tatimi në pronë
- Tatimi në tokë
- Taksa për mbeturina (borxhet e mbetura)
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa administrative komunale
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste
- Taksat për lejen për shërbime profesionale
- Taksa për automjete motorike
- Taksa për çertifikata
- Qiraja nga objektet
- Pëlqimeve për armë mbajtje
- Participim në Arsim
- Participim në Shëndetësi
- Qiraja e tokës
- Të hyra tjera^{2♦}

Përveç, të hyrave nga tatimi në pronë dhe tatimi në tokë edhe taksa për leje ndërtimi është një kategori e rëndësishme e të hyrave vetanake komunale. Ndërsa, gjatë planifikimit të taksës për ushtrimin e

^{2♦} Dhëniet nga Donatoret dhe Participimi i qytetareve


veprimtarisë afariste kemi pas parasysh që një numër i konsiderueshëm i bizneseve komunale që nuk janë duke afaruar.

Planifikimi i të hyrave vetanake komunale

Nr.	Përshkrimi	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029
1	Tatimi në pronë	1,089,704.00	1,100,601.00	1,106,104.00
2	Tatimi në tokë	264,665.00	265,988.00	267,318.00
	Totali i të hyrave tatimore	1,354,369.00	1,366,589.00	1,373,422.00
	Totali i të hyrave jo tatimore	2,558,275.00	2,685,677.00	2,909,394.00
Total		3,912,644.00	4,052,266.00	4,282,816.00

Tabela 2

Paraqitja grafike e të hyrave vetanake në KAB- Komunal sipas viteve 2027 - 2029



Vlerësimet e herëshme të shpenzimeve të kategorive ekonomike 2027-2029

Në vlerësimet e herëshme të shpenzimeve buxhetore përfshihen, kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor, duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pasur për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2026 dhe shpenzimet gjatë viteve të fundit.

Kjo kornizë paraqet parashikimin tre vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit, si dhe të granteve të qeverisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit, të cilat do të përcaktohen në vijim të procesit të Buxhetit.

Ne vijim është një përmbledhje e ndarjeve buxhetore të kategorive ekonomike për vitin 2027 - 2029 në shpenzimet e përgjithshme.

<i>KOMUNA E MITROVICËS - TOTAL</i>				
<i>Nr</i>	<i>Kategoritë Ekonomike</i>	<i>2027</i>	<i>2028</i>	<i>2029</i>
<i>1</i>	<i>Paga dhe Meditje</i>	18,950,980.00	19,350,980.00	20,181,176.00
<i>2</i>	<i>Mallra dhe Shërbime</i>	5,100,000.00	5,640,475.00	5,716,120.00
<i>3</i>	<i>Shpenzime Komunale</i>	700,000.00	700,000.00	700,000.00
<i>4</i>	<i>Subvencione dhe Transfere</i>	1,294,150.00	1,394,150.00	1,394,150.00
<i>5</i>	<i>Investime Kapitale</i>	8,000,000.00	8,253,408.00	9,253,408.00
	<i>TOTALI</i>	<i>34,045,130.00</i>	<i>35,339,013.00</i>	<i>37,244,854.00</i>
<i>Stafi</i>		<i>1965</i>	<i>1965</i>	<i>1965</i>

Tabela 3

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELI

Drejtör: z. Alban FEJZULLAHU

Deklarata e misionit:

- Përkrahja e studenteve Djem dhe Vajza me bursa për përfundim të studimeve .

Objektivi i përgjithshëm:

- Rritja e numrit të përfituesve Djem dhe Vajza me qëllim zhvillimin arsimor të tyre ;

Objektivi specifik:

- Sigurimi që Bursat Studentore të jenë gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për Djem dhe vajzat, dhe se ato promovojnë barazinë dhe diversitetin gjinor.

Indikatorët:

- Të rritet numri dhe përqindja e grave që janë përfituese nga viti në vit.

Deklarata e Vizionit:

- Qasje e drejtë në përfitim të bursave studentore në krijimin e një shoqërie të barabartë moderne me vlera të qëndrueshme,

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Shefe e zyrës: znj. Snezhana Nestoreviç

Deklarata e misionit:

- Përkrahja me pako ushqimore dhe hixhenike për komunitete në Komunën e Mitrovicës;

Objektivat strategjik:

- Identifikimi i rasteve sociale në Komunitet për përkrahje me pako ushqimore dhe hixhenike .

Objektivi i përgjithshëm:

- Rritja e pjesëmarrjes të grave dhe burrave në përfitimin e përkrahjes me pako ushqimore dhe hixhenike;

Indikatorët:

- Të rritet numri dhe përqindja e grave që janë përfituese nga viti në vit.

Deklarata e Vizionit:

- Qasje e drejtë dhe e barabartë në ofrimin e shërbimeve dhe përkrahjes financiare dhe formave tjera të përkrahjes.

DREJTORIA E BUJQËSISË

Drejtör: z. Remzije TUPELLA

Deklarata e misionit:

- Zhvillimi i Bujqësisë dhe Blektorisë në përkrahje të Fermerëve Gra dhe Burra .

Objektivat strategjik:

- Promovimi i bujqësisë së qëndrueshmë dhe agroturizmit gjithëpërfshirës, me përfaqesim të barabartë gjinor.
- Rritja e prodhimit dhe produktiviteti bujqësor për gratë dhe burrat fermerë në nivel Komunal

Objektivi i përgjithshëm:

- Fuqizimi i grave në bujqësi përmes qasjes së barabartë në subvencione dhe programe zhvillimore;

Deklarata e Vizionit:

- Qasje e drejtë dhe e barabartë në shpërndarje të granteve për zhvillim të Bujqësisë.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM, TURIZËM DHE INTEGRIME EVROPIANE

Drejtore: z. Gani RRUSTEMI

Deklarata e Misionit:

- Hartimi i politikës dhe programeve, të cilat mundësojnë pjesëmarrjen e grave/vajzave në zhvillimin e bizneseve vendore duke shfrytëzuar burimet ekonomike lokale.

Objektivat strategjik:

- Përgatit projekte për zhvillim ekonomik lokal dhe hulumton/identifikon fonde nga burime të ndryshme për realizimin e tyre.

Objektivi i përgjithshëm:

- Rritja e numrit të grave dhe vajzave përfituese të Grandeve për zhvillim të biznesit;

Deklarata e vizionit:

- DEZHTIE do të jetë shtyllë e zhvillimit ekonomik lokal duke ofruar kushte të favorshme të bërit biznes, duke nxitur bashkëpunimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të huaja për të ofruar një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mirëqenie për qytetarët e Mitrovicës.

DREJTORIA PËR SHËRBIME SOCIALE

Drejtore : znj. Ramadan BESHIRI

Deklarata e misionit:

- Identifikimin dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Komunën e Mitrovicës sipas standardeve të përcaktuara nga MPMS;

Objektivat strategjik:

- Përmirësimi i kushteve të jetesës për familjet dhe individët në nevojë pa dallim gjinie, moshe apo përkatësie etnike.

- Përmirësimi i bashkpunimit ndër institucional dhe me organizatat që promovojnë barazi gjinore dhe përfshirje sociale

Objektivi i përgjithshëm:

- Rritja e mbështetjes me ndihma materiale dhe financiare për persona në rrezik social me fokus te gratë kryefamiljare;

Indikatorët:

- Numri i marrëveshjeve të bashkpunimit me organizatat që mbrojnë të drejtat e grave si dhe rritja e numrit të aktiviteteve të përbashkëta që promovojnë barazi gjinore.

Deklarata e Vizionit:

Qasje e drejtë dhe e barabartë në ofrimin e shërbimeve dhe perkrahjes financiare dhe formave tjera të perkrahjes.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

Drejtör: z. Albina KASTRATI RAMA

Deklarata e misionit:

- Përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetsore cilësore për gratë dhe burrat në të gjitha zonat e komunat

Objektivat strategjik:

- Identifikimi i nevojave shëndetsore përmes kontrollit sistematik nga njësit shëndetsore mobile.

Sqarim: Kjo do të ndihmojë për të identifikuar çdo hapsirë ose pabarazi gjinore në aksesin në burime, mundësi dhe shërbime.

Objektivi i përgjithshëm:

- Rritja e numrit të fushatave parandaluese dhe ndërgjegjësuere me pjesëmarrje të barabartë gjinore;

Objektivi specifike:

- Sigurimi që perkrahja financiare mbulon shpenzimet për gratë dhe vajzat, dhe se promovonë barazinë në shpërndarje.

Indikatorët:

- Numri i rasteve të trajtuara me qasje gjithëpërfshirëse e të ndjeshme ndaj barazisë gjinore.

Deklarata e Vizionit:

- Qasje e drejtë dhe e barabartë në ofrimin e shërbimeve dhe përkrahjes financiare.

KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtorë : z. Gazmend ASLLANI

Deklarata e misionit:

- Avancimi i përgjithshëm i vlerave kulturore kombëtare dhe sportive në Komunën e Mitrovicës .

Objektivat strategjik:

- Analiza e nevojave, prioriteteve dhe përvojave të grave dhe vajzave në sektorin e kulturës, sportit dhe rinisë.

Sqarim: Kjo do të ndihmojë për të identifikuar çdo hapsirë ose pabarazi gjinore në aksesin në burime, mundësi dhe shërbime.

Objektivi i përgjithshëm:

- Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe vajzave në aktivitete dhe programe kulturore, rinore dhe sportive;

Objektivi specifik:

- Sigurimi që ngjarjet, festivalet dhe aktivitetet kulturore të jenë gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për gratë dhe vajzat, dhe se ato promovojnë barazinë dhe diversitetin gjinor në programet e tyre.

Indikatorët:

- Të rritet numri dhe përqindja e grave që marrin pjesë në aktivitetet e Shtëpisë së Kulturës prej 42% për 1% çdo vit, deri sa të bëhet 50%.

Deklarata e Vizionit:

- Qasje e drejtë ndaj kulturës dhe sportit si segmente shumë të rëndësishme në krijimin e një shoqërie të barabartë moderne me vlera të qëndrueshme,



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	17.06.2026
REFERENC-Ë:	<i>02-463/06-0034889/26</i>
PËR/ZA/TO:	Znj. Safet Kamberi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
CC:	Anëtarëve të Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Drejtor Gazmend Asllani
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Kryetari i Komunës z. Faton Peci
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim - Vendim

Bazuar në nenet 12, 14 dhe 58, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 21 paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të Rregullores së (QRK) nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 13, 15, 77, paragrafi 1.10, të Statutit të Komunës Mitrovica Jugore Nr.02-060/01-0056607/20-4, datë 24.09.2020, si dhe në propozim vendimin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i Propozon Kuvendit të Komunës këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe fushave të padelit

1. I Propozohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim të Propozim-Vendim për caktimin e parcelës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe fushave të padelit
2. Qëllimi i propozimit për ndajen e parceles është sepse sipas marveshjes ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Ministrisë së Sportit dhe Rinisë do të ndërtohen fusha të tenisit dhe fusha të padelit.
3. Lokacioni i caktuar sipas pikes 1 të vendimit, ~~certifikates~~ 10.000 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 58065m² të parceles kadastrale nr,P-71208032-0039-4, e cila gjendet në vendin e quajtur Puzhina –Lumi Ibër-Parcela Kumonale, Komuna e Mitrovicës së Jugut.
- 4.Shfrytëzimi i pronës do të jetë në kohëzgjatje të përhershme.



5. Ndarja e parcelës të Komunës nga pika 2, do të evidentohet në regjistrin e të drejtave pronësore.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport .

8. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Shtojcë:

- Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës
- Kopja e Planit;
- Marveshja e lidhur në mes të Komunës dhe Ministrisë



Republika e Kosovës
Rublica Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I

LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË SPORTIT DHE RINISË

DHE

KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT:

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (MB) është mbështetja financiare dhe bashkëpunimi institucional për realizimin e projekteve infrastrukturore dhe sportive në Komunën e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht:

- Renovimi i Qendrës Multifunkionale – Omni Sporti;
- Ndërtimi i fushave të padelit;
- Ndërtimi i fushave të tenisit;
- Ndërtimi i terreneve sportive;
- Ndërtimi i poligonit të qitjes në Mazhiq.

2. AUTORITETET

Qëllimi i Memorandumi do të përmbushet nga:

- 2.1. Ministria e Sportit dhe Rinisë;
- 2.2. Komuna e Mitrovicës së Jugut.

(në tekstin e mëtejshëm: Palët)

3. OBLIGIMET E PALËVE

3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË SPORTIT DHE RINISË (MSR)

Ministria merr përsipër këto obligime:

3.1.1. Merre përsipër mbështetje financiare për realizimin e projekteve të dakorduar ndërmjet palëve, në përputhje me këtë Memorandum;

3.1.2. Në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës së Jugut, kujdeset për zbatimin e projekteve të parapara në këtë Memorandum;

3.1.3. Procedurat e prokurimit, do të përcaktohen dhe detajohen përmes një aneks memorandumi të veçantë për secilin projekt, i cili do të jetë si aneks i këtij Memorandumi.

3.2. OBLIGIMET E KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komuna merr përsipër këto obligime:

3.2.1. Siguron mbështetje financiare për realizimin e projekteve të dakorduar ndërmjet palëve;

3.2.2. Merr përsipër të siguron pronësinë, kompletimin e dokumentacionit si dhe sigurimin e lokacioneve për realizimin e projekteve;

3.2.3. Në bashkëpunim me Ministrin e Sportit dhe Rinisë (MSR), kujdeset për implementimin e projekteve të parapara në këtë Memorandum;

3.2.4. Procedurat e prokurimit, si dhe planifikimi i lokacioneve përkatëse, do të përcaktohen përmes një aneksi të veçantë për secilin projekt, i cili do të jetë pjesë e këtij Memorandumi.

4. ZBATIMI

Ministria e Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Komunën Mitrovicë së Jugut e përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve në mbarëvajtjen e realizimit të qëllimit.

5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPARESHIKUARA

5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

5.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të fuqisë mbinatyrore – Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

6. AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimit të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda viteve 2026-2030.

7. AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.

9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

10. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Blerim GASHANI



Ministër i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë

Faton PEÇI



Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut

Nënshkruar më 27.04.2026

Prishtinë



Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71208032-00399-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	15-42-0033856
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	11.06.2026 - 13:11
Komuna / Opština / Municipality:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Zhabar I Epërm / Gomje Zhabare / Zhabari I Epërm
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICE

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA							
Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71208032-00399-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shogëitore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	58065	0003-84 KERKESA NR. REF. 15-463/02-0016518/26 DT. 30.03.2026 DGJKP Sektori i Pronës		31.03.2026

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar me datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
PËRRZHINA-LUMI IBËR	0			31.03.2026

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcela Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcela Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljište/Otherland	Jo Pjellorë/Neplodno/Unproductive		58065

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseëdim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Mitrovicës Jugore	600535126	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICE /		BEDRI GJINAJ	1/1	0003-84	





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MITROVICË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Zhabar I Epërm

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71208032-00399-5	Parcelë / Parcela / Parcel	



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2222

Punoi/Obradio/Created: Ruzhdi Ujkani

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note: Vrejtje parçela 399-4 gjendet në kuader ta parcel 399-5 duhet te banet azhurimi

Data/ Data/Date: 11.06.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:14:19









REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

02-400/01-0034001/26
11.06.26
Mitrovica – Mitrovica

DATË/A:	01.06.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit
KOPJE :	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Faton PEÇI – Kryetar i Komunës së Mitrovicës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rregullimi dhe harmonizimi i numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore

I nderuar,

Bazuar në kërkesën e arsyetuar të Drejtorisë së Arsimit lidhur me mungesën e stafit arsimor në institucionet e Arsimit Fillor dhe të Mesëm, lejohet që nevojat aktuale të mbulohen përmes bartjes së stafit nga drejtoritë përkatëse të Komunës, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mundësitë organizative në fuqi.

Njëkohësisht, gjatë procesit të planifikimit buxhetor për periudhën 2027–2029, në kuadër të ndarjeve buxhetore të përcaktuara me Ligjin e Buxhetit dhe mundësive që ofrohen përmes qarkoreve buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave, do të bëhen përpjekje për planifikimin e numrit të nevojshëm të stafit. Kjo do të synojë minimizimin e ndikimit negativ të drejtoritë nga të cilat do të bëhet bartja e personelit dhe sigurimin e funksionimit efikas të të gjitha shërbimeve komunale.

Me respekt!


Mitrovica	642	Stafi 2026 - Komuna e Mitrovices			
		Kodet	Programet/ nën programet	Stafi I Aprovuar	Numri për bartje në DKA
Drejtorite		16022	Zyra e Kryetarit	24	
		16102	Auditimi	3	1
		16922	Zyra e Kuvendit Komunal	33	
		16322	Administrata e Pergjithshme	53	
		16522	Qeshtje Gjinore	2	
		16562	Integrimet Evropiane	8	
		16643	Inspekcioni	19	
		17522	Buxhet dhe financa	27	3
		18320	Zjarrefiksat	41	6
		18466	Menaxhimi I katastrofave Natyrore	5	
		47022	Zyra komunale për komunitete dhe kthim	6	1
		47102	Bujqesia	8	
		47102	Pyltaria dhe Inspekcioni	6	
		48022	Zhvillim Ekonomik	9	2
		65110	Kadaster, gjeodezi dhe pronë	15	
		66115	Planifikimi Urban dhe mjedisi	14	1
		73031	Administrata - Shëndetësis	4	
		74300	Shërbimet e shëndetësis primare	294	2
		75606	Sherbimet Sociale	24	1
		75607	Sherbimet Rezidenciale	66	
		85022	Kulture, Rini dhe Sport	44	2
		85193	Teatri I Qytetit	20	
		92110	Administrata - Arsimit	9	
		92630	Arsimi parashkollor dhe qerdhet	59	
		93630	Arsimi fillor	874	
		94830	Arsimi I Mesem	298	
TOTALI				1,965	19



Faton PEÇI - Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE

RAPORT

MBI GJENDJEN SOCIALE NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT

Maj 2026

Drejt看 i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale
z. RAMADAN BESHIRI



Drejtuar:

Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, **z. Faton Peci**

Kryesuesit të Kuvendit Komunal, **z. Safet Kamberi**

Sekretarit të Kuvendit Komunal, **z. Nazmi Jashari**

Anëtarëve të Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut

BURIMET E TË DHËNAVE DHE BAZA REFERUESE E RAPORTIT

Ky raport është hartuar mbi bazën e statistikave, evidencave administrative dhe të dhënave zyrtare të siguruara nga institucionet në vijim:

- Qendra për Punë Sociale
- Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Agjencioni i Punësimit
- Drejtoria e Mirëqenies Sociale
- Zyra Rajonale e Pensioneve
- Zyra për Kategoritë e Dala nga Lufta
- Administrata Tatimore e Kosovës
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare

Raporti është përgatitur përmes:

Analizës statistikore;

Interpretimit sociologjik dhe vlerësimit institucional të treguesve socialë dhe ekonomikë në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Pasqyra demografike e komunës
3. Gjendja sociale dhe analiza e varfërisë
4. Familjet në asistencë sociale
5. Tregu i punës dhe papunësia
6. Struktura e përfituesve të skemës sociale
7. Prindërit vetushqyes
8. Fëmijët me nevoja të veçanta dhe autizmi
9. Dhuna në familje
10. Mbrotjtja e fëmijëve pa përkujdesje prindërore
11. Pensionet dhe skemat sociale
12. Kategoritë e dala nga lufta
13. Banimi social
14. Personat me aftësi të kufizuara
15. Shëndeti publik dhe shërbimet psikosociale
16. Infrastruktura sociale dhe mungesat institucionale
17. Mekanizmat dhe dokumentet strategjike
18. Sfidat kryesore sociale
19. Prioritetet strategjike të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale
20. Përfundime dhe rekomandime

1. HYRJE

Bazuar në Planin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026, Drejtoria e Mirëqenies Sociale paraqet raportin mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut për periudhën janar – prill 2026.

Raporti synon:

- paraqitjen e gjendjes aktuale sociale;
- identifikimin e sfidave sociale dhe ekonomike;
- analizimin e kategorive më të cënueshme;

Gjendja sociale në komunë vazhdon të karakterizohet nga:

- varfëria dhe cënueshmëria sociale;
- papunësia;
- keqpërdorimi i skemave sociale
- varësia nga skemat sociale;
- mungesa e disa shërbimeve të specializuara;
- dhe nevoja për zgjerim të kapaciteteve institucionale dhe sociale.

2. PASQYRA DEMOGRAFIKE E KOMUNËS

Sipas të dhënave të Agjencia e Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i popullsisë 2024, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka gjithsej 64,742 banorë.

Struktura sipas gjinisë

Kategoria	Numri
Meshkuj	32,641
Femra	32,101
Totali	64,742

Struktura sipas grupmoshave

Grupmosha	Numri
0–17 vjeç	17,734
18–64 vjeç	39,621
Mbi 65 vjeç	7,387

Kjo strukturë demografike tregon nevojë të vazhdueshme për:

- shërbime sociale;
- mbështetje për familjet;
- politika aktive të punësimit dhe kujdes për moshën e tretë.

3. GJENDJA SOCIALE DHE ANALIZA E VARFËRISË

Sipas evidencave të QPS dhe ASK, në muajin prill 2026 në skemën sociale kanë qenë të përfshirë 5,491 anëtarë të familjeve përfituese.

Përqindja e qytetarëve në skemë sociale

Rreth 8.5% e popullsisë së Mitrovicës së Jugut jeton në familje që përfitojnë asistencë sociale.

Megjithatë, niveli real i cenueshmërisë sociale konsiderohet më i lartë për shkak të:

- papunësisë afatgjate
- mungesë e vetproduktivitetit
- ekonomisë joformale;
- të ardhurave të ulëta dhe varësisë nga skemat sociale dhe pensionale.

4. FAMILJET NË ASISTENCË SOCIALE

Pasqyra mujore e vitit 2026

Muaji	Familje	Anëtarë
Janar	1,521	5,793
Shkurt	1,507	5,720
Mars	1,487	5,629
Prill	1,457	5,491

Trendet gjatë vitit 2025

Muaji	Familje	Anëtarë
Janar	1,759	6,856
Shkurt	1,759	6,852
Mars	1,745	6,818
Prill	1,712	6,657
Maj	1,699	6,584
Qershor	1,671	6,525
Korrik	1,647	6,366
Gusht	1,643	6,335
Shtator	1,621	6,243
Tetor	1,592	6,114
Nëntor	1,563	5,986
Dhjetor	1,532	5,843

Pavarësisht rënies graduale të numrit të përfituesve, asistenca sociale vazhdon të mbetet mekanizëm jetik për mijëra qytetarë.

5. TREGU I PUNËS DHE PAPUNËSIA

Të papunët e rinj gjatë vitit 2025

Kategoria

Numri

Femra

147

Meshkuj

83

Totali

230

Mbi 63% e punëkërkesve të rinj janë gra.

Grupmoshat më të prekura janë: 30–39 vjeç dhe 40–54 vjeç

Struktura sipas arsimit

Niveli arsimor	Numri
Të pashkolluar	110
Arsim profesional	68
Gjimnaz	26
Bachelor	18
Master	1

Profilizimi i punëkërkesve

Rrezikshmëria për papunësi afatgjate

Kategoria	Numri
Rrezikshmëri e lartë	216
Rrezikshmëri e mesme	14
Rrezikshmëri e ulët	0

Këshillimet e ofruara gjatë vitit 2025

LLOJI I KËSHILLIMIT	NUMRI
PUNËSIM	1,586
KARRIERË	1,551
AFTËSIM PROFESIONAL	137
TOTALI	3,274

Të dhënat tregojnë sfida serioze në tregun e punës, sidomos në raport me: papunësinë afatgjate dhe integrimin e grave dhe përfshirjen ekonomike të kategorive vulnerabël.

6. STRUKTURA E PËRFITUESVE TË SKEMËS SOCIALE

Në muajin prill 2026 janë evidentuar gjithsej 1,457 familje përfituese të skemës sociale.

KATEGORIA	NUMRI
MESHKUJ	959
FEMRA	498
TOTALI	1,457

7. PRINDËRIT VETUSHQYES

Kategoria	Numri
Meshkuj	23
Femra	66
Totali	89

Numri më i lartë i grave vetushqyese reflekton cenueshmëri ekonomike dhe sociale të grave.

8. FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA DHE AUTIZMI

Evidencat sipas QPS dhe MPMS

KATEGORIA

NUMRI

MESHKUJ

143

FEMRA

103

TOTALI

246

Sipas evidencave të muajit prill 2026:

Kategoria

Numri

Meshkuj

144

Femra

105

Totali

249

Komuna e Mitrovicës së Jugut aktualisht nuk posedon Qendër për Personat Autikë.

9. DHUNA NË FAMILJE

Rastet Janar – Prill 2026

Kategoria	Numri
Viktima meshkuj	2
Viktima femra	14
Totali	16

Në përfundim e sipër është funksionalizimi i Shtëpia e Sigurtë për gratë dhe fëmijët viktima të dhunës.

10. MBROJTJA E FËMIJËVE PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE

Fëmijë të strehuar brenda farefisit

Kategoria	Numri
Meshkuj	13
Femra	16
Totali	29

Fëmijë të strehuar jashtë farefisit

<i>Kategoria</i>	<i>Numri</i>
<i>Meshkuj</i>	1
<i>Femra</i>	0
<i>Totali</i>	1

Fëmijë në institucione rezidenciale

<i>Kategoria</i>	<i>Numri</i>
<i>Meshkuj</i>	3
<i>Femra</i>	3
<i>Totali</i>	6

Aktualisht 4 fëmijë nga Mitrovica jetojnë në SOS Fshatrat e Fëmijëve.

11. PENSIONET DHE SKEMAT SOCIALE

KATEGORIA	NUMRI
PENSIONE BAZIKE TË MOSHËS	8,384
PENSIONE KONTRIBUTPAGUESE	3,305
PENSIONE PARCIALE	1,562
PENSIONE PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA	1,487
PENSIONE PARAPLEGJIKE/TETRAPLEGJIKE	180
PENSIONE FAMILJARE	297
PENSIONE INVALIDORE TË PUNËS	1

12. KATEGORITË E DALË NGA LUFTA

Kategoria	Numri
Kompensime për arsimin 1990/91–1998/99	765
Pensione për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve	521
Veteranë të luftës	584
Pensione TMK	85
Pensione FSK	62
Pensione të minatorëve të Trepçës	452

104 persona nga Mitrovica vazhdojnë ende të figurojnë të pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë.

13. BANIMI SOCIAL

Objektet e banimit social

Objekti	Lokacioni
Shtëpiat e lagjës Katari dhe Halil Kastratit	Frashër
Kampi i Luajve	Shipol
Banesat Sociale	Te Desi
Objekti social	Stan Tërg

Nga janari 2026 janë evidentuar 30 kërkesa për banim social në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale. Pa përfshire kërkesat për banim social në Drejtorinë e Urbanizmit.

Komuna e Mitrovicës ka siguruar rreth 2 milionë euro financim për investime dhe renovim të banimit social nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

14. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

KATEGORIA

NUMRI

PUNONJËS NË ADMINISTRATË

308

PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

7

Komuna ka arritur standardin ligjor “50+1”, megjithatë mbetet nevoja për: hapësira adekuate pune dhe përfshirje më të madhe institucionale.

15. SHËNDETI PUBLIK DHE SHËRBIMET PSIKOSOCIALE

Qendra e Shëndetit Publik funksionon si institucion rajonal i shëndetit publik.

Shtëpia Integruese funksionon si institucion i tipit të hapur për persona me çrregullime mendore kronike në fazë remisioni dhe riintegrimi social.

Spitali Rajonal i Mitrovicës nuk posedon repart psikiatrik.

16. INFRASTRUKTURA SOCIALE DHE MUNGESAT INSTITUCIONALE

Komuna aktualisht nuk posedon:

- Shtëpi për moshën e tretë;
- Qendër për Personat Autikë;
- Qendër për mbrojtjen e fëmijëve;
- Repart psikiatrik rajonal.

Këto mungesa ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin institucional për mbrojtje sociale dhe trajtim të kategorive vulnerabël

17. MEKANIZMAT DHE DOKUMENTET STRATEGJIKE

Rekomandohet:

- Mekanizmi për viktimat e dhunës;
- Fondi emergjent për viktimat e dhunës;
- Ekipi për të drejtat e fëmijëve;
- Tryeza multidisiplinare;
- Plani lokal kundër dhunës;
- Strategjia komunale për mirëqenie sociale;
- Plani Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuara 2025–2027;
- Plani 3-vjeçar i banimit social.

18. SFIDAT KRYESORE SOCIALE

Nga analiza evidentohen këto sfida:

- varfëria;
- papunësia afatgjate;
- cenueshmëria sociale;
- dhuna në familje;
- mungesa e shërbimeve të specializuara;
- shëndeti mendor;
- mbrojtja e fëmijëve;
- dhe nevoja për banim social.

Mitrovica vazhdon të bartë edhe pasoja sociale të karakterit post-konflikt.

19. PRIORITETET STRATEGJIKE TË DREJTORISË SË MIRËQENIES SOCIALE

Prioritetet kryesore mbeten:

- funksionalizimi i Shtëpisë së Sigurtë;
- krijimi i Qendrës për Personat Autikë;
- zgjerimi i banimit social;
- zhvillimi i shërbimeve për moshën e tretë;
- fuqizimi i shëndetit mendor;
- mbështetja për personat me aftësi të kufizuara dhe integrimi social dhe ekonomik i kategorive vulnerabël.

20. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjendja sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut vazhdon të karakterizohet nga sfida të shumta sociale, ekonomike dhe institucionale.

Arsyet kryesore që kanë ndikuar në largimin e rreth mbi 60 familjeve/personave nga skema sociale lidhen me procesin e rivlerësimit dhe verifikimit të përfituesve, gjatë të cilit është konstatuar se një numër i tyre nuk i plotësonin më kriteret ligjore për të qenë pjesë e skemës sociale. Ky proces po realizohet në bashkëpunim me mekanizmat përkatës institucionalë, përfshirë Sistemin e Asistencës Sociale (SAS) dhe menaxherët e rasteve në Qendrën për Punë Sociale në Mitrovicë. Aktualisht ulja e numrit të përfituesve nuk lidhet drejtpërdrejt me hapjen e vendeve të reja të punës nga komuna, por kryesisht me procesin e filtrimit dhe rivlerësimit të përfituesve ekzistues. Megjithatë, Drejtoria për Mirëqenie Sociale duke punuar në hartimin e programeve që synojnë integrimin e familjeve nga asistenca sociale në tregun e punës, përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Punësimit, Qendrën e Aftësimit Profesional, organizata ndërkombëtare dhe organizata të shoqërisë civile.

Të dhënat statistikore tregojnë:

- nivel të konsiderueshëm të varfërisë dhe cënueshmërisë sociale;
- varësi nga skemat sociale dhe pensionale;
- papunësi afatgjate;
- nevojë për mbështetje të shëndetit mendor dhe mungesë të disa shërbimeve esenciale sociale.

Megjithatë, institucionet komunale vazhdojnë përpjekjet për:

- zhvillimin e mekanizmave mbrojtës;
- zgjerimin e përfshirjes sociale;
- dhe forcimin e politikave të mirëqenies sociale.

Në periudhën e ardhshme mbetet e domosdoshme:

- rritja e investimeve në infrastrukturë sociale;
- fuqizimi i politikave aktive të punësimit;
- zgjerimi i shërbimeve sociale dhe koordinimi më i madh ndërinstitutional për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të qytetarëve të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Me respekt

RAMADN BESHIRI

Drejtor i Mirëqenies Sociale

Data: 08.05.2026



RAPORTI PËR GJENDJEN SOCIAL NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT

Maj 2026

Drejtoria e Mirëqenies Sociale

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT

02-052/01-00 27326/26

Mr. i Gj. / Z. /

Ditë / Mënyrë /

12.05.2026

Setor /

Mitrovica - Mitrovica



Drejtor: **Ramadan Beshiri**

Përgatitur për: **Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Jugut**



Hyrje

DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE

Ky raport analitik institucional është hartuar nga **Drejtoria e Mirëqenies Sociale** e Komunës së Mitrovicës së Jugut, në përputhje me Planin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026, pikën e rendit të ditës: *"Raporti për Gjendjen Sociale në Komunë."*

Raporti i drejtohet Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, nën kryesimin e **z. Safet Kamberi**, Kryesues i Kuvendit Komunal, dhe u paraqitet anëtarëve të nderuar të Kuvendit. Gjithashtu, raporti reflekton punën institucionale nën drejtimin e **z. Faton Peci**, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut, dhe është koordinuar nga **z. Nazmi Jashari**, Sekretar i Kuvendit Komunal.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është ofrimi i një pasqyre të plotë, analitike dhe statistikore të gjendjes sociale të komunës, duke identifikuar sfidat strukturore, trendet demografike dhe nevojat e menjëhershme për ndërhyrje institucionale. Raporti shërben si bazë për vendimmarrje të informuar, planifikim të politikave sociale afatgjata dhe alokimin e burimeve buxhetore sipas prioriteteve sociale.

Kryetar Komune

Z. Faton Peci

Kryesues Kuvendi

Z. Safet Kamberi

Sekretar Kuvendi

Z. Nazmi Jashari

Metodologjia e Raportit

📄 QASJA SHKENCORE

Raporti është ndërtuar mbi bazën e një metodologjie të kombinuar, duke integruar metodën sociologjike, metodën statistikore dhe metodën krahasimore. Kjo qasje multidimensionale siguron objektivitet shkencor, saktësi empirike dhe interpretime institucionale të bazuara në evidencë. Metodologjia ndjek standardet evropiane të raportimit social dhe analizës së politikave publike.



Metoda Statistikore

Analiza sasiore e të dhënave nga ASK, QPS dhe Agjencia e Punësimit. Llogaritja e përqindjeve, trendeve dhe indikatorëve socialë. Vizualizimi me grafikë moderne statistikore.



Metoda Krahasimore

Krahasimi i indikatorëve ndër-vjetor dhe ndër-periudhë. Vlerësimi i trendeve dhe ndryshimeve strukturore në shërbimet sociale dhe ekonominë lokale.

Burimet primare të të dhënave përfshijnë: evidencat administrative të QPS-së, raportet mujore të Agjencisë së Punësimit, të dhënat demografike të ASK-së, si dhe dokumentacionin e brendshëm të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Të gjitha të dhënat janë verifikuar, klasifikuar dhe interpretuar sipas metodologjisë standarde të analizës sociale institucionale.



Metoda Sociologjike

Interpretimi i fenomeneve sociale brenda kontekstit strukturor të komunës. Analizë e cënueshmërisë sociale, varfërisë strukturore dhe përjashtimit social.



Analiza Institucionale


Vlerësimi i kapaciteteve institucionale komunale, boshllëqeve në shërbime sociale dhe propozimeve për reformë politike sipas standardeve evropiane.

Pasqyra Demografike e Komunës

🏠 TË DHËNA DEMOGRAFIKE 2026


Komuna e Mitrovicës së Jugut ka një popullsi totale prej **64,742 banorësh**, duke e pozicionuar atë ndër komunat me peshë demografike të konsiderueshme në Kosovë. Struktura gjinore dhe grupmoshave ofron informacion thelbësor për planifikimin e politikave sociale, arsimore dhe shëndetësore.

Struktura Gjinore



Shpërndarja gjinore është gati e barabartë: meshkujt përbëjnë **50.42%** dhe femrat **49.58%** të popullsisë totale.

Struktura sipas Grupmoshave



Grupmoshat aktive të punës (18-64 vjeç) përbëjnë **61.2%** të popullsisë, ndërsa të moshuarit mbi 65 vjeç arrijnë **11.4%** – trendi i plakjes graduale kërkon vëmendje institucionale.

Analiza e Varfërisë dhe Cenueshmërisë Sociale

INDIKATORËT E VARFËRISË

Të dhënat statistikore tregojnë se **5,720 anëtarë** janë të regjistruar në skemën e asistencës sociale, nga një popullsi totale prej 64,742 banorësh. Llogaritja e saktë statistikore jep:

$$P_{varfëri} = \frac{5720}{64742} \times 100 \approx 8.8\%$$

Kjo përqindje prej **8.8%** paraqet vetëm përfituesit zyrtarë të asistencës sociale – persona dhe familje të regjistruar zyrtarisht në sistemin e skemave sociale. Nga perspektiva sociologjike, kjo shifër nënvlerëson realitetin social, pasi shumë familje vuajnë nga varfëria funksionale, papunësia afatgjatë dhe cenueshmëria ekonomike pa qenë të regjistruar zyrtarisht në sistemin e mbështetjes sociale.

Varfëria strukturore në komunë karakterizohet nga: ekonomia joformale e gjerë, varësia nga skemat sociale si burim i vetëm i të ardhurave, papunësia afatgjatë dhe mungesa e mundësive për rikualifikim profesional. Ndikimi i akumuluar i këtyre faktorëve krijon cikle të varfërisë ndërgeneracionale që kërkojnë politika sociale gjithëpërfshirëse.

8.8%

Përfitues Zyrtarë

Pjesa e popullsisë në asistencë sociale

5,720

Anëtarë Aktivë

Persona në skemë sociale

64,742

Popullsia Totale


Banorë të komunës

Të Dhënat e Skemës Sociale

Trendi Vjetor

ANALIZA MUJORE 2025-2026

Të dhënat mujore të skemës sociale paraqesin një trend të qëndrueshëm zbritës gjatë vitit 2025 dhe fillimit të vitit 2026. Nga **1,759 familje** (6,856 anëtarë) në janar 2025, numri u ul në **1,532 familje** (5,843 anëtarë) në dhjetor 2025, dhe arriti në **1,457 familje** (5,491 anëtarë) në prill 2026.




Analiza e Papunësisë dhe Tregut të Punës


AGJENCIA E PUNËSIMIT – 2026

Të dhënat e Agjencisë së Punësimit ofrojnë një pasqyrë të detajuar të strukturës së papunësisë në komunë. Në total, **230 persona të rinj** janë të regjistruar si të papunë aktualë, nga të cilët 147 femra (63.9%) dhe 83 meshkuj (36.1%). Predominimi i femrave në papunësi reflekton pabarazi gjinore strukturore në tregun e punës lokal.

Struktura Gjinore e Papunësisë



Struktura Arsimore e të Papunëve



Struktura arsimore tregon se **47.8%** e të papunëve të regjistruar nuk kanë arsim formal, ndërsa personat me arsim profesional përbëjnë 29.6%. Ky profil arsimor i papunësisë tregon nevojën urgjente për programe rikualifikimi dhe trajnimi profesional. Nga perspektiva e rrezikshmërisë: **216 persona (93.9%)** klasifikohen me rrezikshmëri të lartë, 14 me rrezikshmëri të mesme dhe asnjë me rrezikshmëri të ulët.

Riaktivizimi

463 persona (261 femra / 202 meshkuj) u riaktivizuan në tregun e punës

Youth Guarantee

67 të rinj (42 femra / 25 meshkuj) përfituan nga programi

Këshillime 2025

1,586 për punësim · 1,551 për karrierë · 137 për aftësim profesional

Gjendja 2000–2025

10,984 total: 2,411 aktivë / 8,573 pasivë – papunësi afatgjatë dominuese

Personat me Aftësi të Kufizuara – Integrimi Institucional

 MBROJTJA DHE INTEGRIMI SOCIAL

11

Të Punësuar

Persona me aftësi të kufizuara në sektorin privat

7

Administrata

Persona me aftësi të kufizuara në administratën komunale

308

Total Punonjës

Punonjës të administratës komunale

Analiza e Kuotës Ligjore dhe Integritit Institucional

Nga 11 persona me aftësi të kufizuara të punësuar gjithsej, 10 janë burra dhe 1 grua – gjë që tregon një pabarazi gjinore serioze edhe brenda kësaj kategorie të cënueshme.

Administratën komunale e përbëjnë 308 punonjës, nga të cilët 7 janë persona me aftësi të kufizuara, duke përfaqësuar **2.27%** të totalit.


Sipas legjislacionit në fuqi të Kosovës, punëdhënësit publik janë të detyruar të respektojnë kuotën ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Analiza tregon se ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të punësimit të kësaj kategorie, veçanërisht me theks te integrimi i femrave me aftësi të kufizuara.

Infrastruktura komunale ka nevojë për vlerësim sistematik të aksesueshmërisë fizike të ndërtesave publike, shkollave dhe qendrave sociale. Mungesa e qasjes infrastrukturore mbetet pengesë strukturore për integrimin e plotë social dhe profesional të personave me aftësi të kufizuara.

Fëmijët me Nevoja të Veçanta dhe Dhuna në Familje


MBROJTJA E KATEGORIVE TË CENJESHME

Fëmijët me Nevoja të Veçanta



Gjithsej **246 fëmijë** me nevoja të veçanta marrin mbështetje sociale. Meshkujt (58.1%) tejkalojnë femrat (41.9%). Ky grup kërkon shërbime profesionale multidisiplinare, arsim gjithëpërfshirës dhe koordinim të ngushtë ndërinstitutional.

Dhuna në Familje – Raportimet 2025



Janë raportuar **16 raste** të dhunës në familje, me 14 femra viktima (87.5%) dhe 2 meshkuj viktima (12.5%). Nënraportimi i dhunës në familje mbetet problem serioz – numri real i rasteve pritet të jetë ndjeshëm më i lartë për shkak të stigmës sociale dhe frikës nga reperkusionet.

Roli i Shtëpisë së Sigurtë dhe mekanizmave institucionalë të mbrojtjes është thelbësor. Nevojitet forcim i koordinimit mes QPS-së, Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatës për ndërhyrje të menjëhershme dhe efektive. Programet e edukimit komunitar për parandalimin e dhunës në familje duhet të intensifikohen, me fokus të veçantë te komunitetet rurale dhe periferike të komunës.

Shërbimet Sociale dhe Infrastruktura Institucionale

BOSHLLËQET INFRASTRUKTURE

Analiza institucionale e infrastrukturës sociale të Komunës së Mitrovicës së Jugut zbulon boshllëqe të rëndësishme në ofertën e shërbimeve sociale të specializuara. Mungesa e disa shërbimeve kritike ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së kategorive të cënueshme dhe kufizon kapacitetin institucional të komunës për të adresuar nevojat sociale komplekse.

Qendra për Autizëm – MUNGON

Mungesa e qendrës specializuar për autizëm detyron familjet të kërkojnë shërbime jashtë komunës, duke shkaktuar barrë financiare dhe sociale shtesë. Kërkohet investim urgjent institucional.

Shtëpia për të Moshuar – MUNGON

Me trendin e plakjes demografike (11.4% mbi 65 vjeç), mungesa e një institucioni rezidencial për të moshuar paraqet boshllëk kritik. Kapaciteti i familjes bërthamë si kujdestare primare po dobësohet.

Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve – MUNGON

Mungesa e qendrës specifike për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve në rrezik kufizon shtrirjen dhe intensitetin e ndërhyrjeve institucionale mbrojtëse.

Reparte Psikiatrike – MUNGON

Spitali Rajonal i Mitrovicës nuk disponon repart psikiatrik. Kjo shkakton pengesa serioze në trajtimin e urgjencave psikiatrike dhe shërbimeve të shëndetit mendor komunitar.

Boshllëqet infrastrukturore të identifikuar kërkojnë qasje strategjike afatgjatë të investimeve sociale komunale, me mbështetjen e Qeverisë Qendrore dhe partnerëve ndërkombëtarë. Planifikimi i infrastrukturës sociale duhet të jetë pjesë integrale e Planit Zhvillimor Komunal 2026–2030.

Shëndeti Mendor, Banimi Social dhe Personat e Pagjetur

♡ PRIORITETET SOCIALE URGJENTE

Shëndeti Mendor dhe Mbështetja Psikosociale

Shtëpia Integruese funksionon si pikë mbështetëse kryesore për personat me çrregullime mendore, mirëpo kapacitetet e saj mbeten të pamjaftueshme. Mungesa e sigurimit shëndetësor për shërbime psikiatrike dhe mungesa e repartit psikiatrik në Spitalin Rajonal krijojnë vakum institucional serioz.

Rastet psikosociale shënojnë rritje graduale, të ndikuar nga varfëria kronike, papunësia afatgjatë, izolimi social dhe pasojat e padrejtësisë tranzicionale. Kërkohen shërbime komunitare të shëndetit mendor me qasje multidisiplinare dhe koordinim ndërinstitutional.

Banimi Social – Gjendja dhe Nevojat

Komuna disponon tre njësi banese sociale: **Kampi i Luajve – Shipol, Banesat Sociale – Te Desi dhe Stan Tërg – Trepçë**. Nga janari 2026, janë paraqitur **30 kërkesa** të reja për banim social – trendi tregon rritje të presionit mbi kapacitetet ekzistuese.

Është planifikuar investim prej **2 milionë euro** për banim social dhe renovime. Ky investim mbetet i pamjaftueshëm krahasuar me nevojën e identifikuar. Zgjerimi i kapaciteteve dhe diversifikimi i formave të strehimit social (strehim i asistuar, banim komunal me qira të subvencionuar) janë prioritet strategjike.

Personat e Pagjetur nga Lufta – Dimensioni Humanitar

Aktualisht, **104 persona** nga Komuna e Mitrovicës së Jugut mbeten ende të pagjetur nga Lufta e Kosovës 1998–1999. Kjo situatë ka ndikim të thellë humanitar dhe psikosocial: familjet e personave të pagjetur vuajnë nga trauma e zgjatur sociale, pasiguria juridike mbi statusin e trashëgimisë dhe mungesa e mbylljes emocionale. Drejtësia tranzicionale dhe mbështetja psikologjike e vazhdueshme e familjeve janë obligim moral dhe institucional i komunës dhe shtetit.

104

Persona të Pagjetur

Ende pa gjurmë nga Lufta 1998–99

30

Kërkesa Banimi

Kërkesa të reja për banim social
(janar 2026)

2M€

Investim i Planifikuar

Për banim social dhe renovime

Mbrojtja e Fëmijëve dhe Autizmi – Shërbimet e Specializuara

 VULNERABILITETI I FËMIJËVE

Fëmijët në Kujdes Alternativ

Aktualisht, **4 fëmijë** nga Mitrovica ndodhen në SOS Fshatrat e Fëmijëve – formë e kujdesit alternativ rezidencial. Ky numër, edhe pse i vogël, sinjalizon nevojën për zhvillim të sistemit të familjes kujdestare (vendosja familjare) si alternativë me kosto më të ulët dhe benefite sociale dhe psikologjike më të mëdha për fëmijën.

Investimi në programet e familjes kujdestare, trajnimin e kujdestarëve dhe mbështetjen financiare të familjeve pritëse do të mundësonte integrimin e fëmijëve në mjedis familjar natyral. Koordinimi ndërinstitutional mes QPS-së, gjykatës dhe shërbimeve sociale është parakusht për funksionimin e sistemit të mbrojtjes.

Autizmi – Boshllëku Kritik i Shërbimeve

Mungesa e qendrës specializuar për autizëm paraqet sfidën më urgjente në shërbimet sociale të specializuara. Fëmijët me spektër autizmi dhe familjet e tyre detyrohen të udhëtojnë deri në Prishtinë ose qendra tjera për marrjen e shërbimeve bazike terapeutike – gjë që shkakton barrë financiare, lodhje fizike dhe pengesë në vazhdimësinë e trajtimit.

Trajtimi multidisciplinar i autizmit kërkon bashkëpunim të terapistëve të gjuhës, ergoterapistëve, psikologëve dhe pedagogëve të specializuar. Arsimi gjithëpërfshirës dhe mbështetja e familjes janë elemente thelbësore. Rekomandohet themelimi i qendrës komunale për autizëm si prioritet absolut i investimeve sociale 2026–2027.

Infografika Sociale – Pasqyra e Indikatorëve Kryesorë

 VËSHTRIM I INTEGRUAR

Pasqyra e integruar e indikatorëve socialë kryesorë të Komunës së Mitrovicës së Jugut ofron bazën analitike për priorizimin e politikave sociale dhe alokimin strategjik të burimeve buxhetore komunale.



**Përfitues të
Skemës Sociale –
5,720 anëtarë
(8.8% e popullsisë)**



**Fëmijë me Nevoja
të Veçanta –
246 fëmijë**



**Persona të Papunë
të Regjistruar –
230 aktualë,
10,984 historikisht**



**Persona me Aftësi
të Kufizuara – 11
të punësuar**



**Persona me Aftësi
të Kufizuara –
11 të punësuar**



**Raste Dhune
në Familje –
16 raste**



**Persona të
Pagjetur –
104 persona**



**Kërkesa Banimi
Social – 30
kërkesa aktive**

Indikatorët e mësipërm tregojnë se sfida sociale të komunës janë multidimensionale dhe të ndërlydhura. Varfëria, papunësia, mungesa e infrastrukturës sociale dhe cenueshmëria e grupeve specifike kërkojnë qasje integrale dhe strategjike – jo ndërhyrje të izoluara dhe sektoriale.

Vlerësimi i Përgjithshëm dhe Rekomandimet Institucionale

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Raporti analitik për gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitin 2026 zbulon një tablozë komplekse sfidash sociale, ekonomike dhe institucionale. Varfëria strukturore, papunësia e lartë (veçanërisht afatgjatë dhe me profil arsimor të ulët), cenueshmëria sociale e grupeve specifike dhe boshllëqet kritike infrastrukturore të shërbimeve sociale janë indikatorë që kërkojnë vëmendje institucionale prioritare.

Punësimi dhe Zhvillimi Ekonomik



Intensifikimi i programeve aktive të punësimit, zgjerimi i Youth Guarantee, nxitja e ndërmarrjeve sociale dhe bashkëpunimi me sektorin privat për krijimin e vendeve të punës lokale.

Qendra për Autizëm



Themelimi urgjent i qendrës specializuar komunale për autizëm me ekip multidisciplinar, si prioritet absolut i investimeve sociale 2026–2027 me mbështetjen e Qeverisë dhe donatorëve.

Banimit Social



Zgjerimi i kapaciteteve të banimit social, diversifikimi i formave të strehimit dhe investimi në rehabilitimin e njësive ekzistuese. Analizë e kërkesës aktuale dhe planifikim i kapaciteteve afatmesme.

Shëndeti Mendor



Forcimi i Shtëpisë Integruese, themelimi i repartit psikiatrik në Spitalin Rajonal dhe zhvillimi i shërbimeve komunitare të shëndetit mendor me qasje mobile dhe të decentralizuara.

Mbrojtja e Fëmijëve



Bazuar në nenin 99 paragrafi 3, dhe nenin 135 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e-mail i z. Bedri Murati – zyrtar i lartë ligjor në DEZHTIE i dt. 10.06.2026, librin e Protokolit të DEZHTIE-së, lidhur me Ankesën Nr. 13/04-430/06-0026881/26, dt. 08.05.2026, parashtruar nga “Moneta” SH.P.K., me seli në Ndërtesën “Illyria”, Rr. Graçanicë - Prishtinë, lidhur me faturimin e taksës komunale, Komisioni i formuar me Vendimin Nr. 01-020/04-0010476-2/26, dt. 11.03.2026 për shqyrtimin e ankesave në Faturat e lëshuar për Taksat në Biznese për vitin 2026 në përbërje znj. Teuta Selmani Pllana – kryetare, z. Adem Fazliu – anëtar dhe znj. Tyrkan Dedinja – anëtare, sjell këtë:

V E N D I M
(për shtyrjen e afatit për shqyrtimin e ankesës)

1. **SHTYHET** afati për 30 (tridhjetë) ditë, për shqyrtimin e Ankesës Nr. 13/04-430/06-0026881/26, dt. 08.05.2026, parashtruar nga “Moneta” SH.P.K., me seli në ndërtesën “Illyria”, Rr. Graçanicë - Prishtinë, lidhur me faturimin e taksës komunale.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni i formuar me Vendimin Nr. 01-020/04-0010476-2/26, dt. 11.03.2026 për shqyrtimin e ankesave në Faturat e lëshuar për Taksat në Biznese për vitin 2026, më datë 10.06.2026 ka pranuar Ankesën Nr. 13/04-430/06-0026881/26, parashtruar nga “Moneta” SH.P.K., me seli në ndërtesën “Illyria”, Rr. Graçanicë - Prishtinë, lidhur me faturimin e taksës komunale, e cila Ankesë në Institucionin tonë është adresuar gabimisht në Sektorin e Tatimit në Pronë, pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa më datë 08.05.2026. Kjo lëndë është transferuar në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, më datë 10.06.2026, dhe po në këtë datë është transferuar te Komisioni. Për shkak të natyrës së lëndës dhe në mënyrë që lenda të trajtohet në mënyrë të drejtë, Komisioni konform dispozitave ligjore vendos për afat shtesë për trajtimin e saj.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Teuta Selmani Pllana

T'i dërgohet:

- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian
- 1x1 Arkivit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0114631-2/ dt. 06.01.2023
Mitrovicë


Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Propozim - Vendimin Nr. 01-020/04-0114631/22, dt. 30.12.2022, të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për ndryshimin e Vendimit Nr. 01-020/04-0104835/22, dt. 23.11.2022)

1. Ndryshohet neni 1 (një) i Vendimit Nr. 01-020/04-0104835/22, dt. 23.11.2022, dhe atë vetëm pjesa që i përketë anëtarëve të komisionit, si në vijim:
 - z. Bedri Bajrami i caktuar anëtar i komisionit në paragrafin 1.4, zëvendësohet me z. Jeton Bajrami – Anëtar (DBZHR).
2. Dispozitat tjera të Vendimit Nr. 01-020/04-0104835/22, dt. 23.11.2022, mbesin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës


Bedri HAMZAJ



Shtojcë:

- 1x1 Propozim -Vendimi 01-020/04-0114631/22, dt. 30.12.2022;
- 1x1 Vendimi Nr. 01-020/04-0104835/22, dt. 23.11.2022.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë
- 1x1 z. Bedri Bajrami
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Mitrovica Municipality



DREJTORIA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT 02-052/01-0035168/26
18.06.2026

Datë/A:	12.06.2026
PËR/TO:	z. Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit Komunal të Mitrovicës Jugore
Përmes/Through	z. Faton Peci – Kryetar i Komunës së Mitrovicës Jugore
Nga/From:	znj. Arjeta Beqiri - Hyseni, Drejtoresh e Drejtorisë së Mjedisit
Tema/Subject:	Raport vjetor i menaxhimit të mbeturinave Komunale për vitin 2025

Institucioni hartues	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit
I dedikohet	Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut
Periudha raportuese	01.01.2025 – 31.12.2025
Operatori i shërbimit	KRM “Uniteti” Sh.A. – Njësia Mitrovicë
Raportimi në MMPHI	17.03.2026 (formulari vjetor i raportimit)

Mitrovicë, 2026

FJALA HYRËSE E DREJTORESHËS



Arjeta Beqiri Hyseni

Drejtoreshë e Drejtorisë për Mbrojtje së Mjedisit

Komuna e Mitrovicës së Jugut

E-mail: Arjeta.Beqiri.Hyseni@rks-gov.net

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut,

Kam kënaqësinë që, në emër të Drejtorisë për Mbrojtje së Mjedisit, t’ju paraqes Raportin Vjetor të Menaxhimit të Mbeturinave Komunale për vitin 2025. Ky raport pasqyron gjendjen e shërbimit publik të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave në territorin e komunës sonë, mbështetur në të dhënat zyrtare të formularit vjetor të raportimit, në dokumentet planifikuese dhe në aktet rregullative në fuqi.

Viti 2025 ka qenë vit i konsolidimit të shërbimit. Mbulimi i ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve është ruajtur në nivel të plotë sipas formularit vjetor të raportimit, janë grumbulluar dhe deponuar 25.729 tonë mbeturina komunale, ndërsa në terren janë realizuar ndërhyrje konkrete: nga riorganizimi i shërbimit në lagjen “Adem Voca”, te rregullimi i pikave të grumbullimit në qendër të qytetit dhe furnizimi me kontejnerë në disa vendbanime.

Krahas arritjeve, raporti i trajton me transparencë edhe sfidat: deponitë ilegale të përsëritshme, nevojën për funksionalizimin e sistemit të ndarjes në burim dhe të riciklimit, si dhe domosdoshmërinë e përmirësimit të arkëtimit dhe të treguesve operativë. Për vitin 2026, Drejtoria mbetet e përkushtuar që, në bashkëpunim me KRM “Uniteti” Sh.A., me qytetarët dhe me Kuvendin e Komunës, ta ngrejë shërbimin në një nivel më të lartë cilësie dhe qëndrueshmërie mjedisore.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe për mbështetjen e vazhdueshme.

Me respekt,

Arjeta Beqiri Hyseni

Drejtoreshë e Drejtorisë për Mbrojtje së Mjedisit

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. BAZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE.....	4
3. METODOLOGJIA DHE BURIMET E TË DHËNAVE.....	5
4. OPERATORI I SHËRBIMIT	6
5. SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT	6
5.1 Mbulimi me shërbim	6
5.2 Organizimi territorial dhe frekuenca e shërbimit.....	7
5.3 Flota dhe kontejnerët.....	7
5.4 Burimet njerëzore.....	8
6. TRANSPORTIMI DHE DEPONIMI	8
6.1 Deponia sanitare rajonale në Gërmovë	8
6.2 Sasitë e mbeturinave të grumbulluara dhe të deponuara, 2025	8
6.3 Konsumi i derivateve	9
7. ASPEKTI FINANCIAR.....	9
7.1 Tarifat e shërbimit.....	9
7.2 Faturimi dhe arkëtimi	10
8. DEPONITË ILEGALE DHE PIKAT PROBLEMATIKE.....	11
9. ARRITJET KRYESORE TË VITIT 2025	11
10. SFIDAT DHE PROBLEMET	12
11. REKOMANDIMET DHE PLANI PËR VITIN 2026.....	13
12. PËRFUNDIME	14
SHTOJCA 1. DEPONITË ILEGALE TË EVIDENTUARA NË VITIN 2025	15

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut për periudhën raportuese 01.01.2025–31.12.2025. Raporti është hartuar nga Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve dhe i dedikohet Kuvendit të Komunës, në funksion të informimit dhe të ushtrimit të mbikëqyrjes mbi shërbimin publik të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Gjatë vitit 2025, shërbimi primar është ofruar nga KRM “Uniteti” Sh.A. – Njësia Mitrovicë, në bazë të marrëveshjes për shërbime primare të datës 07.02.2025. Sipas formularit vjetor të raportimit, shërbimi ka përfshirë 16.584 ekonomi familjare, 1.145 biznese dhe 65 institucione, ndërsa sasia vjetore e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe të deponuara në deponinë sanitare rajonale në Gërmovë është 25.729 tonë. Treguesit kryesorë të vitit raportues janë përmbledhur në Tabelën 1.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2025

Treguesi	Vlera 2025
Ekonomi familjare të përfshira në shërbim	16.584
Biznese të përfshira në shërbim	1.145
Institucione të përfshira në shërbim	65
Sasia vjetore e mbeturinave komunale	25.729 ton/vit (matje në deponi)
Mesatarja ditore e grumbullimit	70,49 ton/ditë
Ndryshimi i sasisë janar–qershor 2025/2024 (Mitrovicë)	+3,16%
Vendi i deponimit	Deponia sanitare rajonale në Gërmovë, fshati Koshtovë
Deponi ilegale të evidentuara	11 (1 e vogël, 6 të mesme, 4 të mëdha)
Asete të operatorit të regjistruara në formular	22 automjete
Shkalla e arkëtimit – ekonomitë familjare	81,14%

Burimi: Raportimi vjetor për mbeturinat komunale 2025 (formulari i MMPH-së); Raporti i punës janar–qershor 2025 i KRM “Uniteti” Sh.A.

2. BAZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Menaxhimi i mbeturinave komunale është kompetencë vetanake e komunës, e përcaktuar me nenin 17, paragrafi 1, nënparagrafi (f) i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Korniza ligjore sektoriale rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-071, ndërsa në nivel komunal zbatohen Rregullorja Nr. 02/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Rregullorja Nr. 04/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e saj, të miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Statusi i akteve të zbatuara në hartimin e këtij raporti është paraqitur në Tabelën 2.

Tabela 2. Korniza ligjore dhe rregullative e zbatueshme

Akti ligjor / rregullativ	Nr. / Data	Statusi
Ligji për Vetëqeverisjen Lokale	Nr. 03/L-040	Në fuqi; baza e kompetencës vetanake komunale (neni 17.1.f)
Ligji për Mbeturina	Nr. 04/L-060	Në fuqi; i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-071
Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbeturina	Nr. 08/L-071	Në fuqi
Ligji për Financat e Pushtetit Lokal	Nr. 03/L-049	Në fuqi
Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Mitrovicës së Jugut	Nr. 02/2022, dt. 10.06.2022	Në fuqi; e plotësuar-ndryshuar me Rregulloren Nr. 04/2023
Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2022	Nr. 04/2023, dt. 23.03.2023	Në fuqi
Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM)	2023–2028	I miratuar me vendim të Kuvendit të Komunës; valid
Marrëveshja për shërbime primare të menaxhimit të mbeturinave	dt. 07.02.2025	E vlefshme deri më 31.12.2025

Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (gzk.rks-gov.net); Rregullorja Nr. 04/2023, preambula; Raportimi vjetor 2025, fleta "2, Korniza ligjore".

3. METODOLOGJIA DHE BURIMET E TË DHËNAVE

Raporti është hartuar duke konsoliduar të dhënat e dokumenteve zyrtare të listuara në Tabelën 3. Si burim primar për vitin raportues 2025 është përdorur formulari vjetor i raportimit për mbeturinat komunale, i dorëzuar në MMPHI më 17.03.2026 nga zyrtari përgjegjës i sektorit. Burimet e tjera janë përdorur si kontekst strategjik, operativ dhe krahasues.

Tabela 3. Burimet kryesore të të dhënave dhe përdorimi i tyre

Dokumenti	Përdorimi në raport
Raportimi vjetor për mbeturinat komunale 2025 (formulari i MMPHI-së)	Burim primar: mbulimi, bilanci i mbeturinave, faturimi/arkëtimi, asetet, deponitë ilegale, zbatimi i planit
Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave 2023–2028	Gjendja bazë, objektivat, modeli i shërbimit, kontejnerët, stafi
Plani operativ i grumbullimit të mbeturinave	Zonat, nënzonat, frekuencat, asetet dhe organizimi i turneve
Raporti i punës janar–qershor 2025, KRM "Uniteti" Sh.A.	Arritjet operative, sasitë gjashtëmujore, derivatet, prokurimet
Marrëveshja për shërbime primare, dt. 07.02.2025	Fushëveprimi i shërbimit, standardet, frekuencat, faturimi
Raporti AMMK "Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë 2023–2024"	Krahasimi kombëtar/rajonat dhe trendi i deponimit në Gërmovë
Të dhënat e ASK-së për ekonominë familjare sipas vendbanimeve (2024)	Baza statistikore për mbulimin me shërbim (16.584 EF)

Burimi: Dosja e dokumenteve të Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve, 2025–2026.

4. OPERATORI I SHËRBIMIT

Shërbimi primar i menaxhimit të mbeturinave komunale ofrohet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.A. - Njësia Mitrovicë, shoqëri aksionare në pronësi publike, e licencuar për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale. Marrëdhënia kontraktuale rregullohet me marrëveshjen për shërbime primare të datës 07.02.2025, e vlefshme deri më 31.12.2025; rinovimi i saj për vitin 2026 duhet të përfundojë para skadimit të afatit.

Tabela 4. Profili i operatorit të licencuar

Emri i operatorit	KRM “Uniteti” Sh.A. – Njësia Mitrovicë
Forma e organizimit	Shoqëri aksionare, pronësi publike
Adresa	Rr. “Vëllezërit Dragaj” p.n., Mitrovicë
Kontakti	Tel. 028-533-983; e-mail: krmuniteti@yahoo.com
Kodi i aktivitetit	38 – Grumbullimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave
Numri i biznesit	810547911
Numri i licencës	147/20
Vlefshmëria e marrëveshjes 2025	07.02.2025 – 31.12.2025

Burimi: Raportimi vjetor 2025, fleta “8. Regjistri i operatorëve”; Marrëveshja për shërbime primare, dt. 07.02.2025.

5. SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT

5.1 Mbulimi me shërbim

Sipas formularit vjetor të raportimit, të gjitha kategoritë e klientëve të regjistruar në vendbanimin Mitrovicë janë të përfshira në shërbim, çka rezulton në mbulim administrativ 100% (Tabela 5). Si kontekst operativ, raporti gjashtëmujor i operatorit e vlerëson ofrimin faktik të shërbimit në rreth 98,5% të ekonomive familjare për periudhën janar–qershor 2025, ndërsa PKMM-ja e paraqet mbulimin territorial bazë të operatorit në 95%. Dallimet burojnë nga metodologjitë dhe periudhat e ndryshme të matjes dhe janë shpjeguar në kapitullin 3.

Tabela 5. Mbulimi me shërbim sipas kategorive të klientëve, 2025

Kategoria	Numri total	Të shërbyer	Mbulimi
Ekonomi familjare	16.584	16.584	100%
Biznese	1.145	1.145	100%
Institucione	65	65	100%

Burimi: Raportimi vjetor 2025, fletët “1. Të dhënat për komunë” dhe “9. Mbulimi me shërbim”; ASK, Ekonomitë familjare 2024.

Gjatë vitit 2025, vetëm në Mitrovicë janë regjistruar 244 ekonomi familjare dhe 34 biznese të reja në sistemin e klientëve, ndërsa 29 biznese janë vendosur në pasivitet pas verifikimit të gjendjes faktike në terren.

5.2 Organizimi territorial dhe frekuenca e shërbimit

Territori i shërbimit është i organizuar në zonën urbane (qendra dhe unaza e qytetit), zonën urbane rezidenciale dhe zonën peri-urbane/rurale, të ndara në tri zona operative me nga shtatë nënzona. Sistemi i grumbullimit është i kombinuar: kontejnerë të përbashkët në zonat urbane dhe shërbim derë më derë në zonat rezidenciale, periurbane dhe rurale. Sipas marrëveshjes 2025, mbeturinat e vëllimshme grumbullohen pa pagesë dy herë në vit: në javën e parë të majit dhe në javën e parë të nëntorit.

Tabela 6. Frekuenca e shërbimit sipas tipologjisë së zonës

Zona / tipologjia	Frekuenca e dokumentuar	Sistemi kryesor
Zona urbane – qendra	Çdo ditë, 7 ditë/javë; zbrazja e kontejnerëve kolektivë 3 herë/ditë jashtë sezonit veror dhe 4 herë/ditë gjatë sezonit veror (1 korrik – 31 gusht)	Kontejnerë të përbashkët
Zona urbane rezidenciale	Çdo ditë për pikat me kontejnerë; 1 herë/javë për pjesën derë më derë	I kombinuar
Zona periurbane dhe rurale	1 herë/javë sipas planit operativ	Derë më derë; automjete më të vogla ku kërkohet
Unaza e qytetit	Shërbim ditor dhe i natës, 7 ditë/javë (84 kontejnerë 1,1 m³ në ndërrimin e parë dhe 72 në ndërrimin e natës)	Kontejnerë 1,1 m³

Burimi: PKMM 2023–2028; Marrëveshja për shërbime primare 2025; Plan i operativ i grumbullimit të mbeturinave.

5.3 Flota dhe kontejnerët

Në formularin vjetor 2025 janë regjistruar 22 asete të Njesisë Mitrovicë, prej tyre 18 kamionë dhe automjete pune (Mercedes, Volvo, Scania, MAN, Iveco, Isuzu, Mitsubishi, Ford) dhe 4 vetura mbështetëse. E njëjta shifër konfirmohet edhe në raportin gjashtëmuor të operatorit. Sipas planit operativ, shërbimi i tri zonave kryesore realizohet me 18 asete operative, 18 shoferë, 36 punëtorë dhe 37 turne (Tabela 7).

Tabela 7. Organizimi operativ i grumbullimit sipas zonave

Zona	Nënzona	Asete	Shoferë	Punëtorë	Turne
Zona 1	7	5	5	10	12
Zona 2	7	7	7	14	14
Zona 3	7	6	6	12	11
Gjithsej	21	18	18	36	37

Burimi: Plan i operativ i grumbullimit të mbeturinave; Raportimi vjetor 2025, fleta “12. Asetet për menaxhim të mbeturinave”.

Për kontejnerët, formulari vjetor 2025 nuk përmban numër të përditësuar; si bazë e dokumentuar shërbejnë të dhënat e PKMM-së (Tabela 8). Inventarizimi i plotë i kontejnerëve sipas tipit, gjendjes dhe lokacionit është detyrim i pashtyrshëm për regjistrin e vitit 2026.

Tabela 8. Pajisjet për hedhje dhe grumbullim sipas PKMM-së

Pajisja / kontejneri	Numri i dokumentuar	Gjendja
Shporta 120 L	7.200	E mirë
Shporta 240 L	600	E mirë
Kontejnerë 1,1 m³ metalikë	250	E mirë
Kontejnerë 1,1 m³ plastikë	100	Jo e mirë
Kontejnerë 7,1 m³	7	E mirë

Burimi: PKMM 2023–2028, Tabela 20. Numri i kontejnerëve për vitin 2025 nuk është i plotësuar në formularin vjetor.

5.4 Burimet njerëzore

Struktura direkte operative e operatorit përfshin 6 kryepunëtorë, 49 shoferë dhe 101 punëtorë fizikë, ndërsa në nivel komunal funksionon udhëheqësi i sektorit për mbeturina dhe një zyrtar për inkasim; rekrutimi i dy zyrtarëve për menaxhim të mbeturinave mbetet i planifikuar. Gjatë vitit 2025, pagat e punëtorëve të sektorit operativ janë rritur për 50,00 € bruto dhe janë ekzekutuar me kohë gjatë gjithë periudhës raportuese.

6. TRANSPORTIMI DHE DEPONIMI

6.1 Deponia sanitare rajonale në Gërmovë

E gjithë sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në territorin e komunës transportohet dhe deponohet drejtpërdrejt në deponinë sanitare rajonale në Gërmovë, fshati Koshtovë, e menaxhuar nga KRM “Uniteti” Sh.A. Qendra e ndarjes (MRF) në Mitrovicë është e regjistruar si infrastrukturë në formularin vjetor, por nuk është funksionale, prandaj asnjë sasi nuk devijohet për ndarje apo riciklim. Trendi pesëvjeçar i deponimit në Gërmovë sipas raporteve të AMMK-së është paraqitur në Tabelën 9.

Tabela 9. Sasia e mbeturinave komunale të deponuara në Gërmovë, 2020–2024

Viti	Sasia e deponuar (ton/vit)
2020	47.415,38
2021	49.027,54
2022	52.857,09
2023	54.063,48
2024	42.273,33

Burimi: AMMK, “Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë 2023–2024”. Të dhënat i referohen gjithë deponisë rajonale, jo vetëm Komunës së Mitrovicës së Jugut.

6.2 Sasitë e mbeturinave të grumbulluara dhe të deponuara, 2025

Sipas formularit vjetor 2025, sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara nga Njësia Mitrovicë dhe e përcaktuar me matje në deponi është 25.729 ton/vit, që korrespondon me mesatare mujore prej 2.144,08 tonësh dhe mesatare ditore prej 70,49 tonësh (Tabela 10).

Tabela 10. Bilanci vjetor i mbeturinave komunale, 2025

Treguesi	Vlera
Sasia vjetore e grumbulluar dhe e deponuar	25.729 ton/vit
Mesatarja mujore	2.144,08 ton/muaj
Mesatarja ditore	70,49 ton/ditë
Mënyra e përcaktimit të sasisë	Matje në deponi

Burimi: Raportimi vjetor 2025, fleta "10. Bilanci i mbeturinave".

Krahasimi gjashtëmujor i operatorit tregon rritje të sasisë së grumbulluar në Mitrovicë prej 3,16% në periudhën janar–qershor 2025 kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2024, ndërsa në nivel rajoni rritja është 1,33% (Tabela 11).

Tabela 11. Sasia e grumbulluar sipas njësive, janar–qershor 2024/2025

Njësia	Janar–qershor 2024 (ton)	Janar–qershor 2025 (ton)	Ndryshimi
Mitrovicë	12.411,17	12.802,90	+3,16%
Skenderaj	3.839,36	3.663,32	-4,58%
Rajoni (gjithsej)	16.250,53	16.466,22	+1,33%

Burimi: Raporti i punës janar–qershor 2025, KRM "Uniteti" Sh.A., Tabelat 1 dhe 2.

6.3 Konsumi i derivateve

Konsumi i derivateve në nivel kompanie për gjashtëmujorin e parë 2025 ka shënuar ulje prej 1,10% kundrejt vitit paraprak, ndërsa konsumi për mirëmbajtjen e deponisë është ulur për 7,46%, paralelisht me trajtimin e 16.466,22 tonëve mbeturina në deponi gjatë kësaj periudhe (Tabela 12). Në sasinë e Njesisë Mitrovicë përfshihet edhe mirëmbajtja verore (fshirja dhe larja e rrugëve).

Tabela 12. Derivatet e shpenzuara, janar–qershor 2024/2025

Treguesi	2024 (litra)	2025 (litra)	Ndryshimi
Njësia Mitrovicë	53.497,17	53.303,81	-0,36%
Njësia Skenderaj	33.964,40	33.192,57	-2,27%
Gjithsej (kompania)	87.461,57	86.496,38	-1,10%
Mirëmbajtja e deponisë	8.450	7.820	-7,46%

7. ASPEKTI FINANCIAR

7.1 Tarifat e shërbimit

Tarifat e shërbimit janë të përcaktuara me Rregulloren Nr. 02/2022 (neni 22) dhe të ndryshuara për kategorinë e ekonomive familjare me Rregulloren Nr. 04/2023 (neni 2), e cila ka rritur tarifën mujore për amvisëritë rezidente nga 4,40 € në 5,55 € dhe tarifën vjetore për amvisëritë jorezidente nga 13,20 € në 16,65 € (Tabela 13).

Tabela 13. Tarifat e shërbimit në fuqi gjatë vitit 2025

Kategoria e konsumatorit	Tarifa	Baza rregullative
Ekonomitë familjare rezidente	(5.55 + tvsh) 5.99 €/muaj	Rregullorja Nr. 04/2023, neni 2
Ekonomitë familjare jorezidente	16,65 €/vit	Rregullorja Nr. 04/2023, neni 2
Veprimtari të vogla zejtare dhe shërbyese	6,00 €/muaj	Rregullorja Nr. 02/2022, neni 22
Subjekte të mesme–të mëdha (kosto e ulët)	10,80 €/muaj	Rregullorja Nr. 02/2022, neni 22
Subjekte të mesme–të mëdha (kosto e moderuar)	18,10 €/muaj	Rregullorja Nr. 02/2022, neni 22
Subjekte të mesme–të mëdha (kosto e lartë)	24,60 €/muaj	Rregullorja Nr. 02/2022, neni 22
Institucionet publike dhe kontratat e veçanta	12,30 € për 1,1 m³; 47,20 €/muaj për 7,1 m³	Rregullorja Nr. 02/2022, neni 22

Burimi: Rregullorja Nr. 02/2022; Rregullorja Nr. 04/2023, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut (GZK).

7.2 Faturimi dhe arkëtimi

Faturimi mujor dhe arkëtimi i tarifave kryhen nga KRM “Uniteti” Sh.A., sipas marrëveshjes për shërbime primare dhe rregullores komunale. Për kategorinë e amvisërive, formulari vjetor 2025 raporton faturim prej 981.175 € dhe arkëtim prej 796.146 €, që korrespondon me shkallë arkëtimi 81,14% (Tabela 14). Si referencë krahasuese, raporti i AMMK-së evidenton përmirësim të dukshëm shumëvjeçar të arkëtitimit nga amvisëritë në Mitrovicë: nga 61,63% në vitin 2023 në 81,14% në vitin 2024.

Tabela 14. Faturimi dhe arkëtimi sipas kategorive, 2025

Kategoria	Faturimi (€)	Arkëtimi (€)	Shkalla
Amvisëritë	981.175,00	796.146,00	81,14%
Bizneset	369.775,68	12.572,37	shih shënimin
Institucionet	1.204.671,77	18.672,41	shih shënimin
Shërbimet e kontraktuara për mbeturina	1.574.447,45	31.244,79	shih shënimin

Burimi: Raportimi vjetor 2025, fleta “11. Faturimi dhe arkëtimi”; AMMK 2023–2024.

Shënim verifikimi: vlerat e arkëtitimit për bizneset, institucionet dhe shërbimet e kontraktuara janë jashtëzakonisht të ulëta në raport me faturimin e regjistruar dhe nuk përputhen me logjikën operative të kategorive përkatëse. Para çdo përdorimi si tregues zyrtar i konsoliduar, këto vlera duhet të verifikohen me evidencat financiare të operatorit (Shtojca 2). Për këtë arsye, raporti nuk paraqet shkallë të konsoliduar arkëtimi për të gjitha kategoritë.

8. DEPONITË ILEGALE DHE PIKAT PROBLEMATIKE

Në formularin vjetor 2025 janë evidentuar 11 deponi ilegale: 1 e vogël, 6 të mesme dhe 4 të mëdha (Tabela 15; koordinatat e plota jepen në Shtojcën 1). Sipas vërejtjes zyrtare në formular, këto lokacione janë kryesisht të përsëritshme: pas pastrimit, qytetarët hedhin sërish mbeturina. Si referencë rajonale, AMMK evidenton 45 deponi ilegale në Rajonin e Mitrovicës për vitet 2023 dhe 2024.

Tabela 15. Deponitë ilegale të evidentuara në vitin 2025

Kategoria e deponisë ilegale	Numri
E vogël	1
E mesme	6
E madhe	4
Gjithsej	11

Burimi: Raportimi vjetor 2025, fleta "5. Deponitë ilegale"; AMMK 2023–2024.

Rast i veçantë – lagjja “Adem Voca”: deponia ilegale në këtë lagje është trajtuar si pikë e përsëritshme. Pas takimeve të operatorit me Drejtorinë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve dhe me përfaqësuesit e lagjes, plani operativ është riorganizuar dhe, nga muaji qershor 2025, lagjja merr shërbim derë më derë për afërsisht 288 ekonomi familjare. Ndërhyrja ka ndikuar pozitivisht në eliminimin e deponisë ilegale dhe në përmirësimin e inkasimit në këtë zonë, duke shërbyer si model i replikueshëm për pikat e tjera problematike.

9. ARRITJET KRYESORE TË VITIT 2025

Aktivitetet e planifikuara me planin komunal dhe ato operative të vitit 2025 janë realizuar në masën dërmuese. Arritjet kryesore, sipas formularit vjetor (fleta “3. Implementimi i planit komunal”) dhe raportit gjashtëmuor të operatorit, janë përmbledhur në Tabelën 16.

Tabela 16. Arritjet kryesore të vitit 2025

Fusha	Aktiviteti i realizuar	Statusi
Shtrirja e shërbimit	Zgjerimi i sistemit në Shalë të Bajgorës dhe në zonën veri-perëndimore të komunës	I përfunduar
Infrastruktura e grumbullimit	Furnizimi me kontejnerë shtëpiakë në Koshtovë, Zhabar të Ulët dhe Zhabar të Epërm	I përfunduar (faza II)
Lagjja Ilirida	Kontejnerë shtëpiakë dhe infrastrukturë për ndarje në burim	Faza I–II të përfunduara
Komunitetet RAE	Kombinimi i dy pikave të kontejnerëve kolektivë me operator publik dhe privat	I përfunduar
Tuneli i Parë	Riorganizimi i pikave grumbulluese dhe vendosja e kontejnerëve të rinj 1,1 m³	I përfunduar
Qendra e qytetit	Rregullimi i pikave të grumbullimit me vendosjen e 20 mbulojave me infrastrukturë përcjellëse	I përfunduar
Lagjja “Adem Voca”	Shërbim derë më derë për rreth 288 ekonomi familjare; eliminimi i deponisë ilegale	Nga qershori 2025

Fusha	Aktiviteti i realizuar	Statusi
Kompostimi	Monitorimi i komposterëve për ndarjen e mbeturinave organike – pilotimi në Këq	Në proces
Riciklimi	Ndërtimi i fabrikës së riciklimit në fshatin Frashër	Ndërtimi i përfunduar; funksionalizimi në proces (GIZ – komunat rajonale)
Edukimi mjedisor	Klubet e gjelbra në shkollat fillore dhe të mesme; ligjërata të vazhdueshme	Në proces
Baza e klientëve	244 ekonomi familjare dhe 34 biznese të reja të regjistruara në Mitrovicë	Realizuar
Operativa dhe prokurimi	7 procedura prokurimi të përmbyllura; ulje e konsumit të derivateve për 1,10%	Realizuar

Burimi: Raportimi vjetor 2025, fleta "3. Implementimi i planit komunal"; Raporti i punës janar-qershor 2025, KRM "Uniteti" Sh.A.

10. SFIDAT DHE PROBLEMET

Pavarësisht funksionimit të qëndrueshëm të shërbimit bazë, sistemi përballet me sfida strukturore që ndikojnë në cilësinë, matshmërinë dhe qëndrueshmërinë financiare të tij (Tabela 17).

Tabela 17. Sfidat kryesore të identifikuar

Fusha	Përshkrimi i sfidës
Deponitë ilegale	11 lokacione të evidentuara në vitin 2025, kryesisht të përsëritshme pas pastrimit; kërkohen masa parandaluese të qëndrueshme
Ndarja në burim dhe riciklimi	Qendra e ndarjes (MRF) dhe fabrika e riciklimit në Frashër nuk janë ende plotësisht operative; e gjithë sasia deponohet pa trajtim paraprak
Mbeturinat e vëllimshme	Vendosen shpesh jashtë orareve të caktuara, pranë kontejnerëve ose në lokacione të papërshtatshme
Mbeturinat nga ndërtim-demolimi	Lokacioni është i caktuar, por funksionalizimi i plotë i tij mbetet i përpunueshëm
Arkëtimi jofamiljar	Vlerat e arkëtimit për biznese dhe institucione në formular janë jorealiste të ulëta dhe kërkojnë verifikim financiar
Të dhënat operative	Mungojnë treguesit e përditësuar për kontejnerët, kilometrazhin, numrin e xhirove dhe konsumin specifik për ton
Flota dhe efikasiteti	Nevoja për zëvendësim gradual të automjeteve të vjetruara dhe për përmirësim të efikasitetit operativ të stafit
Vetëdijesimi qytetar	Niveli i pamjaftueshëm i kulturës mjedisore në lagje të caktuara; respektim i ulët i orareve dhe i pikave të grumbullimit

Burimi: PKMM 2023-2028; Raportimi vjetor 2025; Raporti i punës janar-qershor 2025; Marrëveshja për shërbime primare 2025.

11. REKOMANDIMET DHE PLANI PËR VITIN 2026

Rekomandimet e mëposhtme rrjedhin nga sfidat e evidentuara dhe nga objektivat e PKMM-së 2023–2028, sipas së cilës për vitin 2026 synohet ruajtja e mbulimit të plotë me shërbim dhe arritja e shkallës 20% të mbulimit me ndarje në burim. Masat janë renditur sipas prioritetit dhe afatit orientues të realizimit (Tabela 18).

Tabela 18. Masat prioritare për vitin 2026

Nr.	Masa e rekomanduar	Afati orientues
1	Rinovimi i marrëveshjes për shërbime primare me KRM “Uniteti” Sh.A. për vitin 2026, para skadimit të asaj aktuale	T1 2026
2	Harmonizimi i regjistrit të klientëve (ASK – Komuna – operatori) dhe njësimi i metodologjisë së raportimit të mbulimit	T1 2026
3	Verifikimi i të dhënave financiare për bizneset dhe institucionet me evidencat e operatorit	T1 2026
4	Inventarizimi i plotë i kontejnerëve sipas tipit, kapacitetit, gjendjes dhe lokacionit	T1–T2 2026
5	Standardizimi i raportimit mujor: sasia, xhirot, kilometrazhi, derivatet, ankesat dhe deponitë e pastruara	I vazhdueshëm
6	Pastrimi i deponive ilegale dhe masa parandaluese në lokacionet e përsëritshme (mbikëqyrje, sinjalistikë, gjoba sipas rregullores)	I vazhdueshëm
7	Monitorimi mujor i modelit derë më derë në lagjen “Adem Voca” dhe shtrirja e tij në pika të tjera problematike	I vazhdueshëm
8	Funksionalizimi i lokacionit për mbeturinat nga ndërtim-demolimi dhe rregullimi i procedurës së pranimit	2026
9	Studimi i fizibilitetit dhe plani operativ për aktivizimin e MRF-së dhe të fabrikës së riciklimit në Frashër	2026
10	Pilotimi i ndarjes në burim në lagje, shkolla dhe institucione, drejt objektivit 20% sipas PKMM-së	2026
11	Zgjerimi i pilotimit të kompostimit nga Kçiqi në vendbanime të tjera rurale me potencial organik	2026
12	Kalendari publik i grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme (java e parë e majit dhe e nëntorit) dhe fushata vetëdijesimi	Maj / nëntor 2026
13	Plani i zëvendësimit gradual të automjeteve të vjetruara, bazuar në të dhënat e mirëmbajtjes dhe konsumit	2026
14	Rekrutimi i zyrtarëve të planifikuar për menaxhim të mbeturinave dhe adresimi i pozitës së inspektorit mjedisor	2026

Burimi: PKMM 2023–2028; analiza e Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve mbi të dhënat e vitit 2025.

12. PËRFUNDIME

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut gjatë vitit 2025 është ofruar në mënyrë të qëndrueshme nga KRM “Uniteti” Sh.A. – Njësia Mitrovicë, mbi bazën e marrëveshjes për shërbime primare dhe të kornizës rregullative komunale në fuqi. Formulari vjetor i raportimit e paraqet shërbimin me mbulim të plotë për 16.584 ekonomi familjare, 1.145 biznese dhe 65 institucione, me sasi vjetore prej 25.729 tonësh mbeturina komunale të deponuara në deponinë sanitare rajonale në Gërmovë.

Viti 2025 shënon përparime konkrete: rritje të sasisë së grumbulluar në gjashtëmujorin e parë (+3,16% në Mitrovicë), riorganizim të suksesshëm të shërbimit në lagjen “Adem Voca”, përmirësime infrastrukturore në disa vendbanime dhe në qendër të qytetit, ulje të konsumit të derivateve dhe shkallë arkëtimi prej 81,14% për ekonomitë familjare, me trend të qartë përmirësimi shumëvjeçar.

Njëkohësisht, sistemi mbetet i ekspozuar ndaj sfidave strukturore: deponive ilegale të përsëritshme, mosfunksionalizimit të ndarjes në burim dhe të riciklimit, menaxhimit jo të plotë të mbeturinave të vëllimshme dhe atyre nga ndërtim-demolimi, si dhe mungesës së treguesve të plotë operativë e financiarë. Prioritetet për vitin 2026 janë konsolidimi i të dhënave, rinovimi me kohë i marrëveshjes së shërbimit, forcimi i kontrollit në terren dhe përgatitja praktike për ndarjen në burim, në përputhje me objektivat e PKMM-së 2023–2028. Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve do t’i raportojë Kuvendit të Komunës në mënyrë periodike mbi zbatimin e masave të rekomanduara.

SHTOJCA 1. DEPONITË ILEGALE TË EVIDENTUARA NË VITIN 2025

Tabela 19. Regjistri i deponive ilegale me koordinata

Nr.	Madhësia	Gjerësia gjeografike (Lat)	Gjatësia gjeografike (Lon)
1	E vogël	42.868940	20.819635
2	E mesme	42.881539	20.837572
3	E mesme	42.880367	20.887900
4	E mesme	42.865729	20.834605
5	E mesme	42.868559	20.821008
6	E mesme	42.868414	20.851539
7	E mesme	42.881304	20.873255
8	E madhe	42.886388	20.856935
9	E madhe	42.872340	20.807295
10	E madhe	42.894252	20.883117
11	E madhe	42.903828	20.871171

Burimi: Raportimi vjetor 2025, fletë "5. Deponitë ilegale". Lokacionet janë të regjistruara me koordinata; emërtimet zyrtare të lokacioneve nuk janë pjesë e formularit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

02-052/01-0035965/26
18.06.2026

DATE/A:	12.06.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e Kuvendit Z.Safet Kamberaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Kryetarit të Komunes z.Faton Peci
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport- z.Gazmend Asllani
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raportet në Lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Të nderuar,

Të bashkangjitur gjeni raportet në lëmin e Sportit dhe Rinisë, si dhe raportin në lëmin e Kulturës për periudhën 6 mujore të kërkuara sipas pikes 3 dhe 9 për materialin e seancës së Kuvendit.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica S



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Raport mbi lëmin e Kulturës 2026

Qershor, 2026

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjëse për detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Hartimin e planit për mbështetjen kulturore;
2. Udhëheqje me resurset lokale kulturore,
3. Udhëheqje me Teatrin, Bibliotekën e Qytetit, Muzeun e Qytetit, Qendrën e Kulturës,
4. Organizimin dhe shënimin e datave me rëndësi historike kur kërkohet;
5. Organizimin e debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës;
6. Grumbullimin e shënimeve faktike mbi të arriturat në kulturë;
7. Bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Komunës dhe raportimin për punët e drejtorisë;
8. Bashkëpunim me nivelin qendror nga fushë veprimtaria përkatëse dhe këshilltarët nga këto fusha;
9. Regjistrimin e grupeve kulturore, ansambleve etj;
10. Mbështetje të aktiviteteve kulturore,;
11. Bashkëpunim me qytete tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash si dhe me OJQ, e organizata të tjera vendore e ndërkombëtare;
12. Përkrahje dhe ndihmë asociacioneve, shoqatave kulturore në aktivitetet e tyre;
13. Të ofrojë institucionet e veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente edhe veprimtari të tjera);
14. Të nxisë investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë;
15. Të ushtrojë edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

Sektori i Kulturës

1. Aktivitetet kulturore tradicionale

- Festa e 17 shkurtit
- Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës (Homazhe ne varrezat e Deshmoreve)
- Kremtimi i festave tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shënimi i përvjetorëve të rëndësishëm, sipas kalendarit të përpiluar nga Sektori i Kulturës
- Kremtimi i festes së 28 Nëntorit

2. Projektet kapitale afatgjata

- Objekti i përhershëm i Muzeut të Qytetit(janë bërë investime të vogla ku edhe gjatë këtij viti është caktuar selia e përheshme dhe së shpejti pritet të fillojnë investimet kapitale)
- Pritet të fillojnë investimet kapitale ne Aneksin A dhe B ne Qendren e Kultures
- Renovime ne Bibiloteken e qytetit ne piken Tunel i parë
- Nderitimi i nje amfiteatri veror

Punët administrative

- Janë përpunuar 100 lëndë
- Pjesë e komisionit Raporti i Performancës komunale për vitin 2025
- Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2026
- Pjese e komisionit per Investime kapitale
- Pjese e komisionit per subvencione individuale

AKTIVITETET E SEKTORIT TË KULTURËS

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e mbarëvejtjes së punëve në institucionet vartëse.
- Jemi duke punuar për formimin e komisionit për të hartuar planin ideor mbi renomvimet e Muzeut të qytetit.
- Koncert me rastin e 17 shkurtit (Koncert ne hapesirat e Muzeut te qytetit)
- Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës
- Aktivitete kulturore të mbështetura nga Sektori i Kulturës
- Sektori i Kulturë mbas mbështetjes së akvttiviteteve kulturore ka arritë të ketë mbi 60 akvttivitete kulturore.
- Vizitat në institucionet vartës (Arsyeja e vizitave është sepse jemi duke filluar të bëjmë një evidentim të gjendjes faktike të shrytëzimit të të gjitha hapësirave të cilat shrytëzohen nga personat fizike apo juridikë, ku vizitat jane mëse të domosdoshme.
- Ditë përkujtimore kushtuar masakrës së rrugës së Kovaqëve
- Koncert me muzik klasike në Qendër të Kulturës (Organizuar nga Saranda Kutlllovci Syla) në mbështetje të Dkrs 15-Prill

- Fillimi i provave per nje shfaqje nga Teatri i qytetit
- Grupi i thurjes-aktivitet ne Muzeun e qytetit- java e fundit të muajit Prill
- Puntori me argjile dhe fije tekstili Muzeu i qytetit- java e fundit të muajit Prill
- Lexim nga grupi i grave lexuese në fund të muajit Prill në Biblioteken e Qytetit” Latif Berisha”
- Projekti për të filluar renovimin e Qendres së Kulturës Aneksin A dhe B

Muzeu i qytetit

Puna Muzeale dhe Ekspozitat

Në vitin 2026, Muzeu i Mitrovicës ka realizuar një sërë iniciativash të suksesshme për të bërë muzeun një Muze Gjithëpërfshirës për ta realizuar vizionin si Muze i të Gjithëve. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (DKRS), Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), OJQ-të dhe partnerët lokalë, muzeu ka avancuar përfshirjen dhe qasjen për vizitorët e të gjitha grupmoshave dhe grupeve të marginalizuara, duke garantuar mundësi të barabarta për pjesëmarrje në aktivitetet muzeale dhe edukative.

Ky proces ka përfshirë risitimimin e ekspozitave të përhershme, pasurimin e narrativave shpjeguese muzeale dhe afrimin e vazhdueshëm të muzeut me komunitetin. Veçanërisht, janë zhvilluar aktivitete edukative gjithëpërfshirëse, duke përfshirë:

- **Grupi i Thurjes** – një aktivitet krijues dhe edukativ për të gjitha grupmoshat, duke rikthyer artin e thurjes tradicionale dhe duke bashkuar breza të ndryshëm.
- **Punëtori vizatimi për fëmijë** – aktivitet i dedikuar për nxënësit, për të nxitur kreativitetin dhe njohuritë mbi trashëgiminë kulturore.
- **Punëtori me argjile dhe fije tekstili** – për fëmijë dhe të rritur, organizuar në bashkëpunim me shkolla lokale, për të zhvilluar aftësi artistike dhe kreativitetin.
- **Program me të rinj nga komuniteti me Sindromën Down** – një hapësirë për përfshirje aktive dhe zhvillim të aftësive artistike për grupet me nevoja të veçanta.
- **Programi edukativ “Muzeu Lëvizës”** – Muzeun dërgoi aktivitete arti tek fëmijët e fshatit Bare si dhe bashkëpunime të tjera me shkolla dhe qendra burimore lokale, duke përfshirë pjesëmarrës me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, muzeu ka realizuar përmirësime të rëndësishme në infrastrukturën muzeale, duke përfshirë rregullimin e hapësirave me lyerjen e sallave për të siguruar një prezantim më profesional të koleksioneve. Këto përpjekje kanë kontribuar në rritjen e vizibilitetit të muzeut, duke e pozicionuar Muzeun e Mitrovicës

si një institucion të qasshëm dhe gjithëpërfshirës për promovimin e trashëgimisë kulturore materiale në Kosovë, si dhe duke përmirësuar përvojën kulturore të vizitorëve

1. Ekspozita “Vegza”

- Hapur më 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve.

2. Grupi i Thurjes

3. Aktivitet krijues për të gjitha grupmoshat, duke përfshirë gra artizane dhe pjesëtare të komunitetit.
Qëllimi: Rikthimi dhe promovimi i thurjes si pjesë e trashëgimisë kulturore

Vizitorët

Gjatë vitit 2026, Muzeu i Qytetit të Mitrovicës mirëpriti një numër të konsiderueshëm vizitorësh, duke përfshirë:

- Grupa nga shkollat fillore dhe të mesme.
- Studiues dhe studentë nga universitete të ndryshme.

Vizitorë individualë dhe familjarë, vendorë, të huaj dhe bashkatdhetarë

Biblioteka e qytetit “Latif Berisha”

Spektori i perpunimit janë perpunuar gjithsej 149 ekzemplar.

Në spektorin e femijëve, ku gjatë vitit 2026 janë anëtarësuar gjithësejt 132 femijë dhe ka pasur 6104 shërbime .

Në spektorin për të rritur janë anëtarësuar 67 anëtar të rinjë dhe ka 1817 shërbime.

Në spektorin e profesional janë anëtarësuar 44 anëtar dhe ka 942 shërbime

Qendra e Kulturës “Rexhep Mitrovica

Janar:

23.01.2026 - UBT Kosova prezantuan një ekspozitë “Pop Up” me punime të studentëve të programit Art dhe Media digjitale.

Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 18:00.

Shkurt:

04.02.2026 - Ekspozitë përkujtimore për masakrën e 3 dhe 4 shkurtit në Mitrovicë, me autor Halit Barani.
Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 12:00.

11.02.2026 - Master Class me Maestro Giuseppe Devastato.
Salla e Kinemasë, në ora 9:00 - 18:00.

12.02.2026 - Ekspozitë nga Bashkësia Islame e Kosovës “Kujtesa në fotografi” për xhamitë e shkatërruara gjatë luftës në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë gjatë viteve 90’.
Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 13:00.

13.02.2026 - Koncert për fëmijë nga “Cicërimat buzë Ibrit”.
Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

17.02.2026 - Film dokumentar “Betejat e Veriut” me autor Bashkim Myftari.
Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

Mars:

11.03.2026 - Shfaqja “Fjalët lëndojnë” nga SH.M.L.M “Xheladin Deda”.
Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

24.03.2026 - Akademi përkujtimore në 27 vjetorin e rënies së veprimtarëve Latif Berisha dhe Agim Hajrizi.
Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

25.03.2026 - 26.03.2026 - Mster Class me Maestro Giuseppe Devastato.
Salla e Kinemasë, nga ora 10:00 - 17:00.

27.03.2026 - 5 vjetori i themelimit të ansamblit “Shqipet e vogla”.
Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Prill:

15.04.2026 - Mbrëmje e muzikës klasike në Mitrovicë. Koncert nga Sibora Resyli.
Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

27.04.2026 - Panairi i punës, organizuar nga organizata rinore AKTI.
Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 9:00.

29.04.2026 - Aktivitet kulturor për shënimin e Ditës Botërore të Vallëzimit. Organizuar nga Qendra e Kulturës.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00.

30.04.2026 - International Piano Balkan Academy. Organizuar nga Melisa Ibrahimî.
Salla e Kinemasë, nga ora 9:00 - 18:00.

Maj:

08.05.2026 - Tubim i partisë “Guxo” me strukturat në Mitrovicë.
Salla e Kinemasë, në ora 19:00.

12.05.2026 - Dokumentar i cili trajton historitë e personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë.
(BIRN Kosova).
Salla e Kinemasë, në ora 15:00.

21.05.2026 - Filharmonia e Kosovës dhe kori e orkestra e Fakultetit të Arteve.
Salla e Kinemasë, në ora 19:30.

23.05.2026 - Tubim elektorat nga “Vetëvendosje”.
Holli i Qendrës së Kulturës, në ora 11:30.

31.05.2026 - Akademi përkujtimore për heroin Safet Peci - Boletini.
Salla e Kinemasë, në ora 18:00.

Qershor:

01.06.2026 - Aktivitet për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve nga organizata: “Mundësia” “Down Syndrome Kosova” Shqipet e vogla” dhe “HandiKos Mitrovica”.
Salla e Kinemasë, në ora 16:00.

02.06.2026 - Tubim elektorat nga LDK.
Salla e Kinemasë, në ora 17:00.

03.06.2026 - Mitrovica Classical Competition - Gara e Muzikës Klasike.
Salla e Kinemasë, nga ora 8:00 - 16:00.

04.06.2026 - Festa e Abetares SHFMU “Shaban Idrizi”
Salla e Kinemasë, në ora 11:00 - 14:00.

05.06.2026 - Festa e Abetares SHFMU “Bedri Gjinaj”.

Salla e Kinemasë, në ora 12:00 - 14:00.

06.06.2026 - Mitrovica Classical Competition - Gara e Muzikës Klasike.

Salla e Kinemasë, në ora 08:00 - 18:00.

09.06.2026 - Festa e Abetares SHFMU "Ismail Qemajli".

Salla e Kinemasë, në ora 17:00 - 21:00.

Pjesëmarrja, rreth 30 persona.

Gjendja aktuale në Qendrën e Kulturës është relativisht e mirë. Në këtë institucion zhvillohen shumica e aktiviteteve kulturo-artistike në qytet, duke pasur parasysh se në këtë objekt veprimtarinë e zhvillojnë dy institucione kulturore. Vlen të theksohet se të gjitha aktivitetet në këtë institucion zhvillohen në sallën qendrore dhe hollin e qendrës, kurse salla e konferencave, si dhe salla e leximit, që nga renovimi i objektit kanë mbetur jashtë funksionit. Riaktivizimi i këtyre dy sallave do të kompletonte infrastrukturën kulturore brenda objektit.

Ky institucion ka një staf prej 8 punonjësish - drejtorin, stafin administrativ-financiar dhe stafin teknik dhe mbështetës. Institucioni ka Statutin, i cili e rregullon statusin juridik mbi funksionimin e Qendrës së Kulturës, por nuk ka Rregullore të brendshme dhe xhirollogari bankare. Sipas Rregullores për Tarifa, Taksa dhe Gjoha Komunale, Qendra e Kulturës mund të gjenerojë të hyra nga aktivitetet që zhvillohen në hapësirat e institucionit.

Duke e ditur se menaxhimi i objekteve që kanë hapësirë të madhe kërkon edhe mirëmbajtje dhe krijim të kushteve të përshtatshme për organizimin dhe avancimin e jetës kulturo-artistike, është shumë e dukshme mungesa e stafit higjieno-sanitar në këtë institucion. Po ashtu edhe mungesa e një përgjegjësi për operimin dhe kujdesin për ngrohjen qendrore. Ende është e dukshme gjendja e cila është shkaktuar nga renovimi, ani pse parë në disa aspekte teknike renovimi e ka rivitalizuar këtë objekt, por megjithatë janë të dukshme edhe disa dëme që janë shkaktuar gjatë kohës së renovimit sidomos nga rrjedhja e ujit atmosferik brenda objektit, por edhe mbikëqyrja jo e mirë e punimeve të zhvilluara në këtë kohë.

Objekti nuk ka roje fizike, por është i monitoruar nga kamerat brenda dhe jashtë objektit. Siguria në këtë objekt dhe rreth tij duhet të shikohet me prioritet si në angazhimin e sigurimit fizik, po ashtu edhe në shtimin e numrit të kamerave brenda dhe jashtë objektit.

Në hyrje të këtij institucioni dhe brenda tij mungojnë shënjestimet - tabelat informuese. Gjithashtu edhe qasje në internet ka vetëm te zyrat e stafit; është shumë e nevojshme që rrjeti të shpërndahet në të gjithë objektin. Alarm kundër zjarrit ka vetëm në sallën e renovuar dhe te pajisjet e dimmerave te skena e sallës, por jo edhe në hapësirat e tjera brenda objektit. Kurse sistem sigurie elektrike përveç sallës nuk ka në hapësirat tjera të objektit.

Ani pse në Bllokun A të Qendrës së Kulturës veprojnë dy institucione kulturore, pra Qendra e Kulturës dhe Teatri i Qytetit, ky bllok ka vetëm një hyrje si për stafin dhe audiencën e aktiviteteve po ashtu edhe për skenografi, vepra arti dhe rekuizita të ndryshme. Është shumë e nevojshme rihapja e hyrjes zyrtare si për dalje emergjente ashtu edhe për shërbime të tjera që do ta lehtësonin qasjen dhe mbarëvajtjen e punëve teknike në këto institucione.

Aktualisht, në këtë zonë ndodhet gjeneratori elektrik, i cili duhet të zhvendoset për të mundësuar hapjen e kësaj hyrjeje. Gjithashtu, është e nevojshme të rrenohet objekti afarist i ndërtuar aty dhe të bëhet rikonceptimi i të gjithë hapësirës nëëmenyrë që te integrohet shetitorja e lumit Ibë me Qendrën e Kulturës. Një tjetër problematikë është hyrja e institucionit. Përveç kablllove dhe shtyllës elektrike në oborrin e Qendrës së Kulturës, të cilat krijojnë një pamje joestetike, kërkohet edhe demolimi i dy zyrave që i janë shtuar hyrjes. Ridizajnimi dhe rikonceptimi i kësaj hapësire do t'i jepte objektit një pamje më dinjitoze dhe do të lironte një hyrje shtesë e cila gjendet në anën e majt te hyrjes kryesore.

Qasja për personat me aftësi të kufizuara është e kufizuar vetëm në hollin e qendrës dhe sallën kryesore. Për të pasur qasje edhe në sallat e tjera, duhet të riparohet ashensori, i cili është jashtë funksionit prej disa vitesh. Një sfidë tjetër në kushtet e punës dhe zhvillimit të aktiviteteve mbetet i ftohti që mbizotëron gjatë stinës së dimrit në hollin e qendrës, si dhe i nxehti gjatë stinës së verës në sallën e konferencave. Për zgjidhjen e këtyre dy problemeve, nevojitet kujdes në planifikimin dhe furnizimin me pelet, si dhe rregullimi i sistemit të klimatizimit dhe ventilimit në sallën e konferencave.

Për sa i përket hapësirave dhe funksionimit të organizatave të ndryshme që veprojnë në Bllokun B të Qendrës së Kulturës, gjendja në këtë pjesë është shumë e rëndë. Në këtë pjesë veprojnë afërsisht 11 organizata, disa prej të cilave nuk janë aktive prej vitesh. Në këto hapësira ka dëmtime të konsiderueshme në infrastrukturën e objektit, tualetet nuk janë funksionale, ndërsa rrjeti i energjisë elektrike është në gjendje shumë të dobët. Vlen të theksohet se në vitin 2023 ka pasur një vendim që të gjitha këto hapësira të lirohen, mirëpo nuk ka pasur vullnet nga ana e këtyre organizatave që ky vendim të zbatohet. Këto hapësira duhet të trajtohen me prioritet të njëjtë sikurse pjesa e bodrumeve në këtë bllok.

Përmbledhje:

Gjendja aktuale në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica” ka shënuar përmirësime të dukshme që nga viti 2023. Megjithatë, është tejet e nevojshme të rritet intensiteti i punës për zhvillimin e veprimtarisë kulturo-artistike dhe përmirësimin e përgjithshëm të institucionit. Kërkohet një bashkëpunim ndërinstitutional, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, me qëllim konsolidimin e kësaj qendre dhe realizimin e investimeve kapitale në infrastrukturën e objektit.

Vizioni:

Riaktivizimi i Kinemasë

Riaktivizimi i Ansamblit

Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike

Bashkëpunimi me institucione të ndryshme kulturore

Plotësimi i stafit me pozitat e lartpërmendura

Hartimi i rregullores së brendshme

Dizajnimi i llogarisë zyrtare të institucionit

Ngritja e profesionalizmit dhe performaces



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

SEKTORI PËR SPORT DHE RINI

**Raporti gjashtëmuor i Sektorit të Sportit dhe Rinisë
për vitin 2026.**

OBJEKTET SPORTIVE, GJENDJA, FUNKSIONALITETI DHE KAPACITETI I TYRE

Në Komunën e Mitrovicës gjenden një numër objektesh sportive të tipit të mbyllur dhe të hapur, të cilat janë në funksion të zhvillimit dhe masivizimit të sportit në komunën tonë. Këto objekte shërbejnë për aktivitetet e klubeve sportive dhe për rekreacionin e qytetarëve.

Gjendja, funksionaliteti dhe kapaciteti i tyre paraqiten si më poshtë:

PALESTRA E SPORTEVE “MINATORI”

Palestra e Sporteve “Minatori” është në gjendje relativisht të mirë, por kërkon investime të mëtejshme në renovim dhe mirëmbajtje.

Pjesa më e madhe e klubeve sportive të komunës sonë, përkatësisht klubet e basketbollit, hendbollit, volejbollit, xhudos, boksit dhe futsalli, zhvillojnë stërvitjet dhe ndeshjet zyrtare në të gjitha kategoritë në këtë palestër. Gjithashtu, palestra shërben edhe për aktivitete rekreative.

Objekti është në menaxhim të Komunës së Mitrovicës, përkatësisht të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS).

PALESTRA E SPORTEVE TË VOGLA “FATIME XHAKA”

Palestra e Sporteve të Vogla “Fatime Xhaka” është në menaxhim të Komunës së Mitrovicës, përkatësisht të DKRS-së. Objekti është i dëmtuar në masë të konsiderueshme, megjithatë aktualisht aty zhvillojnë aktivitetet e tyre dy klube sportive dhe një organizatë joqeveritare.

Palestra përbëhet nga salla gjimnastikore, terreni i hapur, lokalet përcjellëse dhe tribunat për shikues.

Ka një sipërfaqe prej afërsisht 1,500 m².

Kapaciteti i saj është rreth 1,000 shikues.

STADIUMI OLIMPIK “ADEM JASHARI”

Stadiumi Olimpik “Adem Jashari” ka qenë në menaxhim të KF “Trepça”, ndërsa që nga viti 2019 në të janë realizuar investime nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Punimet ende nuk kanë përfunduar dhe, si komunë, aktualisht nuk kemi qasje në objekt.

Kapaciteti i stadiumit ka qenë rreth 35,000 shikues.

STADIUMI I QYTETIT “RIZA LUSHTA”

Stadiumi i Qytetit “Riza Lushta” është në menaxhim të KF “Trepça '89”, e cila kujdeset për mirëmbajtjen e objektit dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Klubi ka realizuar një sërë investimesh, si rezultat i të cilave stadiumi është shumë funksional dhe i plotëson nevojat e destinimit të tij.

Kapaciteti i stadiumit është 10,000 shikues.

Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të Sektorit të Sportit në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe përfshin mbështetjen financiare të klubeve sportive për gjashtëmujorin e vitit 2026, si dhe raportimin e aktiviteteve të tyre.

Aktivitetet e implementuara gjatë kësaj periudhe kohore janë bazuar në Planin e Punës.

Sektori i Sportit, njëri nga tre sektorët e DKRS-së, është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve sportive dhe mbarëvajtjen e punës në këtë sektor.

Ky sektor i ka kushtuar vëmendje dhe përkushtim të veçantë klubeve sportive të qytetit tonë, përmes formave të ndryshme të organizimit institucional, duke realizuar aktivitete të ndryshme gjithëpërfshirëse.

Ndërsa, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS), përkatësisht Sektorit të Sportit, gjatë periudhës gjashtëmujore (janar – qershor 2026), janë realizuar një sërë aktivitesh sportive, rekreative dhe organizative, të cilat kanë kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e sportit në Komunën e Mitrovicës.

Aktivitetet janë zhvilluar pothuajse në çdo muaj të kësaj periudhe, në bashkëpunim me klubet sportive, institucionet arsimore, federatat sportive dhe organizata të ndryshme.

Më poshtë i gjeni aktivitetet e realizuara gjatë këtij gjashtëmujori, të shoqëruara me fotografi nga aktivitetet përkatëse. Aktivitetet janë paraqitur sipas rendit kronologjik dhe datave të realizimit të tyre.

Me datën 14.02.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, në bashkëpunim me Federatën e Karatesë së Kosovës, është mbajtur Kampionati Ndërkombëtar i Karatesë në Palestrën Sportive "Minatori", ku pjesëmarrës ishin karateistë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe diaspora.


Disa pamje/foto nga kampionati i mbajtur.





Me datën 16.02.2026,nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne futbollit për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, ku te pranishëm ishin 7 ekipe .

Fitues i këtij turneu ishte ekipi ETC-së. Disa pamje/foto nga turneu i mbajtur.



Me datën 18.02.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne ne futboll te madh për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës
Në këtë aktivitet morën pjesë: Veteranët e futbollit nga Kumanovë, Veteranët e Apolonia
Fier nga Fier, Veteranët e Kosovës, Veteranët e Mitrovicës. ⚽

Disa pamje/foto nga turneu i mbajtur.




Me datën 02.03.2026,në bashkëpunim me Shoqatën Sporti Shkollor dhe DKRS-ja – Sektori i Sportit i mbajt garat shkollore ne Basketboll , ku te pranishëm ishin 17 ekipe te shkollave

Disa pamje/foto nga garat komunale te mbajtura ne basketboll dhe hendboll.




Me datën 27.03.2026,në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit DKRS-ja – Sektori i Sportit u mbajt Striballi , ku te pranishëm ishin 12 ekipe te moshave te ndryshme


Disa pamje/foto nga mbajtja e Striballit.



Me datën 26.04.2026, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne futbolla dhe Shah për nder të heroit të kombit Shemsi Ahmeti "Shemi", ku të pranishëm ishin 7 ekipe, ndërsa në shah murrën pjesë 80 shahist nga trevat shqiptare.

Disa pamje/foto nga mbajtja e turnirit Shemsi Ahmeti "Shemi", në futboll dhe shah.





Me datën 31.05.2026,nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore, z. Faton Peci, u mbajt turne futboll për nder të heroit te kombit Safet Peci Boletini , ku te pranishëm ishin 7 ekipe.

Disa pamje/foto nga mbajtja e turnirit Safet Peci Boletini



Sektori i Rinisë

Aktivitetet e Sektorit të Rinisë

Gjatë gjashtëmujorit raportues, Sektori i Rinisë ka zhvilluar një sërë aktivitete me qëllim fuqizimin e rolit të të rinjve në komunitet, promovimin e jetesës së shëndetshme, zhvillimin e kreativitetit dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore.

Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me shkolla, organizata rinore, institucione shëndetësore dhe partnerë lokalë.

Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të Sektorit të Rinisë në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe përfshin periudhën kohore 2026.

Ky Sektor vëmendje dhe përkushtim të vecantë i ka kushtuar fuqizimit të të rinjve, përmes formave të ndryshme të organizimit institucional duke shënuar aktivitete të ndryshme gjithpërfshirëse.

Në veçanti DKRS njih rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje në të gjitha proceset që e prekin stautin e të riut dhe zhvillim individual si qytetarë aktiv sot dhe bazë për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës tani dhe në të ardhmën..

Me datë 13.02.2026 ishim ne nje aktivitet me OJQ -REC me bashkëpunim me me UNDP të financuar nga bashkimi evropian në forumin e dialogut me komunitete me temën anti diskriminimi ne praktikë, besimi dhe siguria ndërektike.

Muaji: Mars 2026

Tema: Bullizmi në Shoqëri

Aktiviteti me temën “Bullizmi në shoqëri” u realizua me sukses në ambientet e Shkollës së Mesme të Ulët “Shaban Idrizi” – Zhabar, me pjesëmarrjen e nxënësve, mësime dhënëse dhe përfaqësuesve të sektorit të rinisë.

Gjatë tryezës së diskutimit, pjesëmarrësit patën mundësinë të shprehin mendimet dhe përvojat e tyre lidhur me fenomenin e bullizmit, duke e trajtuar atë si një ndër sfidat më të pranishme në jetën e të rinjve sot.

Çfarë u diskutua

Diskutimi u fokusua në disa çështje kryesore:

- **Kuptimi i bullizmit dhe format e tij**
Nxënësit identifikuan forma të ndryshme të bullizmit, përfshirë bullizmin fizik, verbal, psikologjik dhe atë në rrjetet sociale. U theksua se bullizmi nuk ndodh vetëm në shkollë, por edhe në komunitet dhe online.
 - **Ndikimi i bullizmit**
U diskutua për pasojat negative që bullizmi ka në shëndetin mendor, vetëbesimin dhe performancën shkollore të të rinjve. Disa nxënës ndanë përvoja personale ose raste të vëzhguara, duke theksuar ndikimin emocional që shkakton bullizmi.
 - **Roli i bashkëmoshatarëve dhe mësimitdhënësve**
Pjesëmarrësit diskutuan rëndësinë e reagimit ndaj bullizmit dhe mosqëndrimit indiferent. U theksua se mbështetja nga shokët dhe ndërhyrja e mësimitdhënësve janë kyçe për parandalimin e rasteve.
 - **Strategjitë për parandalim dhe përballim**
U propozuan mënyra konkrete për të luftuar bullizmin, si: raportimi i rasteve, krijimi i një ambienti më gjithëpërfshirës, organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe fuqizimi i komunikimit mes nxënësve dhe stafit shkollor.
 - **Ndërtimi i një kulture respekti**
Diskutimi përfundoi me theksimin e rëndësisë së respektit, empatisë dhe bashkëpunimit si vlera themelore për një shoqëri më të sigurt dhe mbështetëse.
-

Përfundime

Aktiviteti u karakterizua nga pjesëmarrje aktive dhe diskutim i hapur nga ana e nxënësve. Ai kontribuo në rritjen e ndërgjegjësimit për bullizmin dhe inkurajoi të rinjtë të jenë më të kujdesshëm dhe mbështetës ndaj njëri-tjetrit.

Gjithashtu, u vërejt gatishmëri nga pjesëmarrësit për të qenë pjesë e iniciativave të ardhshme që synojnë parandalimin e bullizmit dhe promovimin e një mjedisi më pozitiv në shkollë dhe komunitet.

Kohëzgjatja e aktivitetit

60 – 90 minuta

Vendi i mbajtjes

Shkolla e Mesme e Ulët “Shaban Idrizi” – Zhabar

19.03.2026

Me datën 30.04.2026 Takimi me Ministrinë e Sportit dhe Rinisë.

Ne ket takim u diskutua nisma per themelimin e Këshillit Qendror Rinor ne Kosovë.

Qellimi i keti takimi ishte ifnormimi i organizatave të shoqeris civile , qendrave rinore, organizatave studentore, dhe strukturave te tjera rinore mbi bazën ligjore te themelimit te KQR-ës, rolin dhe mandatin e ti, si dhe procedurat dhe kriteret per përfshirje ne procesin e themelimit.

Gjithashtu ne sektorin e rinisë kemi vazhduar takime me OJQ ne kuadër te politikave rinore ne Mitrovicë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

Drejtoria për Shëndetësi

DATE/A:	11.06.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit të Komunës
CC:	z. Nazmi Jashari – Sekretar i Kuvendit
PËRMES/PREKO/THROUGH	z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Albina Kastrati Rama - Drejtore e DSH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë për gjendjen në shëndetësi



Bazuar në planin e punës së Drejtorisë për Shëndetësi ju paraqesim raportin për gjendjen në Shëndetësi

Derjtoria për Shëndetësi detyrat dhe përgjegjësit e veta i ushtron përmes:

- Sektorit për Administratë
- Qendrën Kryesore të Mjekësisës Familjare

I. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË QKMF-së

Misioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor është ofrimi i shërbimeve parandaluese shëndetësore për gjithë popullatën e Komunës së Mitrovicës pa dallim etnie, përmes zbatimit të konceptit të Mjekësisë Familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës. Aktivitetet kanë qenë të përqendruara në planin e punës së QKMF për vitin 2026, Statutit të QKMF-së ,Strategjisë së KPSH dhe politikave të MSh , si dhe legjislacionit në fuqi .

Objektivat kanë qenë të bazuara në:

- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për përparimin, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet.
- Përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësorë, kujdesin akut përfshirë ofrimin e kujdesit emergjent, stabilizimin dhe transportin deri në institucionet referente .
- Kujdesin për shëndetin mendor të bazuar në bashkësi
- Rehabilitimin dhe kujdesin paliativ/terminal

- Kujdesin shtëpiak përmes vizitave në komunitet
- Edukimi shëndetësor i stafit dhe popullatës,
- Imunizimin dhe Vaksinimin
- Promovimi i shëndetit oral, parandalimin e kariesit të dhëmbëve si kujdesi themelor stomatologjik .
- Kujdesin shëndetësor para, pas lindjes dhe atë riprodhues
- Zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse, dhe raportimi i në QRSHP
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore diagnostike-analizave laboratorike dhe rëntgenologjike në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor.
- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i personelit shëndetësor dhe atij jo shëndetësor
- Menaxhimi dhe distribuimi i medikamenteve dhe materialit sanitar
- Kontinuiteti i ofrimit të shërbimeve në të gjitha institucionet shëndetësore

II- ORGANIZIMI I PUNËS

Struktura organizative e QKMF-së bazohet në Statutin e QKMF dhe përbëhet nga Departamentet, Sektorët dhe Njësitë.

III- RRJETI I KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR

KPSH funksionon përmes :

1 Qendre Kryesore të Mjekësisë Familjare,

1.1 Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni”

2 Qendrave të Mjekësisë Familjare

2.1 Qendra e Mjekësisë Familjare – Ilirid

2.2 Qendra e Mjekësisë Familjare – Bair

2.3 Qendra e Mjekësisë Familjare – Bair 2

2.4 Qendra e Mjekësisë Familjare – Ura e Gjakut

2.5 Qendra e Mjekësisë Familjare – Shipol

2.6 Qendra e Mjekësisë Familjare – Zhabar

2.7 Qendra e Mjekësisë Familjare – Shupkovc

2.8 Qendra e Mjekësisë Familjare – Tunel i Parë

2.9 Qendra e Mjekësisë Familjare – Sheshi i Vjeter

2.10 Qendra e Mjekësisë Familjare – Koshtovë

2.11 Qendra e Mjekësisë Familjare – Bare

3. Ambulanteve Shëndetësore

3.1 Ambulantat e Mjekësisë Familjare - Kciq i Madh

3.2 Ambulantat e Mjekësisë Familjare - Fidanisht

3.3 Ambulantat e Mjekësisë Familjare - Gushavc

3.4 Ambulantat e Mjekësisë Familjare – Broboniq

3.5 Ambulantat e Mjekësisë Familjare – Rashan

3.6 Ambulantat e Mjekësisë Familjare - Bajgorë

- 3.7 Ambulantat e Mjekësisë Familjare - Vllahi
- 3.8 Ambulantat e Mjekësisë Familjare – Zabergjë
- 3.9 Ambulantat e Mjekësisë Familjare - Selac
- 3.10 Ambulantat e Mjekësisë Familjare – Kaqandoll
- 3.11 Ambulantat e Mjekësisë Familjare – Frashër

Për momentin ky rrjet i plotëson nevojat për ofrimin e shërbimeve shëndetësore duke u bazuar në Planin Gjithëpërfshirës i KPSH bazuar në qasjen, distancën dhe numrin e kërkueseve të shërbimeve.

Distribuími i tanishëm i Institucioneve mundëson qasjen në shërbime për më shumë se 95% të popullatës.

IV – BURIMET NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese numri i punëtorëve është 262

- 56** -janë Doktor, prej tyre,
- 17- Doktor Specialist të Mjekësisë Familjare,
- 3- Doktor në Specializim në Mjekësi Familjare,
- 1- Doktor në Specializim në Radiologji,
- 19- Doktor të Mjekësisë,
- 4- Doktor Specialist të Stomatologjisë,
- 2- Doktor të Stomatologjisë në Specializim,
- 10- Doktor të Stomatologjisë.
- 166**- Infermier, prej tyre:
- 83- Infermier në Sektorin e Mjekësisë Familjare,
- 22- Laboranta,
- 7- Infermier në Vaksinim,
- 2- Infermier në Rentgen,
- 4- Infermier në Intervencë,
- 3- Punëtor operator në SISH,
- 4- Infermier në Barnatore,
- 1- Infermiere në Edukim Shëndetësor,
- 16- Infermier në Urgjencë,
- 23 -Asistent Stomatolog,
- 1- mami.

40- Staf jo mjekësor prej tyre:


- 10- Punëtor në Administratë,
- 1- Punëtor në Rrobalarje,
- 3- Punëtor Sigurimi,
- 8- Punëtor në Shërbimin Teknik,
- 5-Punëtor të Higjienës dhe
- 13- Punëtor në Shërbimin e Transportit.

Nr. i tërësishëm i personelit të QKMF –së për muajin maj në listën e pagave është gjithësej **262**.

NUMRI I BANORVE NE KOMUNEN E MITROVICËS

Popullësia	64742
Femra	32101
Meshkuj	32641

Further information about the population structure:



https://www.citypopulation.de/en/kosovo/admin/mitrovic%25C3%25AB/11__mitrovic%25C3%25AB_e_jugut/?utm_source=chatgpt.com

NATALITETI – MORTALITETI

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në Komunën e Mitrovicës gjatë vitit 2025 këto janë të dhënat sipas muajve për lindje dhe vdekje si vijon:

LINDJET 2025 – MITROVICË

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTALI
142	124	128	160	136	143	180	160	165	122	131	145	1736

VDEKJET 2025 – MITROVICË

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOT	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTALI
40	42	36	35	31	27	27	36	41	30	36	37	412

MORBIDITETI \ SËMUNDËSHMËRIA

Morbiditeti përfaqëson një nga indikatorët më të rëndësishëm të gjendjes shëndetësore të popullatës dhe përbën bazën kryesore për planifikimin strategjik të shërbimeve shëndetësore. Analiza e strukturës së sëmundshmërisë lejon identifikimin e problemeve kryesore shëndetësore, grupeve më të rrezikuara të popullsisë dhe tendencave epidemiologjike që kërkojnë ndërhyrje parandaluese dhe terapeutike. Ky raport paraqet një analizë të detajuar të morbiditetit të popullatës së Komunës së Mitrovicës për tremujorin e parë të vitit 2026. Të dhënat janë të klasifikuara sipas ICD-10 dhe të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshave, duke mundësuar një vlerësim të thelluar të shpërndarjes së sëmundjeve në popullatë. Qëllimi kryesor i raportit është:

- të identifikojë sëmundjet më të shpeshta në komunitet
- të analizojë shpërndarjen e tyre sipas moshës dhe gjinisë
- të evidentojë ndryshimet sezonale të morbiditetit
- të ofrojë rekomandime për përmirësimin e shëndetit publik

Ky raport synon të shërbejë si dokument orientues për institucionet shëndetësore dhe vendimmarrësit lokalë në hartimin e strategjive parandaluese.

METODOLOGJIA

Analiza është bazuar në të dhënat mujore të raportuara nga shërbimet shëndetësore të kujdesit parësor në Komunën e Mitrovicës gjatë muajve janar, shkurt dhe mars 2026. Diagnozat janë klasifikuar sipas ICD-10 dhe janë ndarë sipas:

- gjinisë (femra / meshkuj)
- grupmoshave standarde epidemiologjike

Metoda e analizës ka përfshirë:

- analizë deskriptive statistikore
- krahasim mujor të incidencës së sëmundjeve
- identifikim të grupeve më të rrezikuara

Analiza është fokusuar kryesisht në:

- sëmundjet kronike jo-ngjitëse
- sëmundjet respiratore
- diabetin
- sëmundjet muskuloskeletale
- sëmundjet malinje
- çrregullimet mendore

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Analiza e të dhënave tregon qartë se struktura e morbiditetit në Mitrovicë dominohet nga sëmundjet kronike jo-ngjitëse. Ky trend është karakteristik për shoqëritë në tranzicion epidemiologjik dhe lidhet ngushtë me ndryshimet në stilin e jetesës, plakjen e popullatës dhe rritjen e faktorëve të rrezikut si sedentarizmi, obeziteti dhe duhanpirja.

Sëmundjet më të shpeshta gjatë tremujorit janë: Sëmundja Numri total i rasteve -----

Hipertensioni arterial 1,046 raste,

-Sëmundjet kronike të mushkërive 868 raste,

- Sëmundjet e shtyllës kurrizore 444 raste

- Sëmundja Diabetes mellitus 207 raste

Këto katër grupe përbëjnë boshtin kryesor të barrës së sëmundjeve në komunitet.

ANALIZA E MORBIDITETIT SIPAS GRUPEVE TË SËMUNDJEVE SËMUNDJET KARDIOVASKULARE

Hipertensioni arterial rezulton të jetë problemi më dominant shëndetësor në komunitet, me gjithsej 1,046 raste të raportuara gjatë tremujorit. Rritja e vazhdueshme e rasteve me moshën tregon lidhjen e fortë midis plakjes së popullatës dhe rritjes së prevalencës së sëmundjeve kardiovaskulare. Në grupmoshat mbi 55 vjeç, hipertensioni paraqet një nga diagnozat më të shpeshta. Hipertensioni është faktor kryesor rreziku për:

- sëmundjet koronare
- infarktin e miokardit
- insultin cerebral
- insuficiencën renale

Dominimi i kësaj sëmundjeje tregon nevojën për programe të gjera skriningu dhe edukimi shëndetësor.

SËMUNDJET RESPIRATORE KRONIKE

Sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive paraqesin një barrë shumë të lartë, me 868 raste të raportuara. Janari shënon kulmin e incidencës, që lidhet me:

- temperaturat e ulëta
- ndotjen e ajrit
- infeksionet respiratore sezonale
- rritjen e përdorimit të ngrohjes me lëndë djegëse.

Këto sëmundje prekin kryesisht moshat mbi 55 vjeç dhe kanë lidhje të fortë me duhanpirjen dhe ekspozimin ndaj ndotjes.

DIABETES MELLITUS

Diabeti paraqet një problem serioz të shëndetit publik me 207 raste të raportuara. Sëmundja shfaqet kryesisht në:

- moshat 35+
- popullatën urbane
- individët me stil jetese sedentare Diabeti lidhet me komplikime serioze:
- sëmundjet kardiovaskulare
- neuropatitë
- retinopatitë
- nefropatitë

SËMUNDJET MUSKULOSKELETALE

Sëmundjet e shtyllës kurrizore përbëjnë një nga shkaqet kryesore të vizitave në kujdesin parësor. Rritja e rasteve në mars sugjeron ndikimin e:

- rikthimit në aktivitet pune
- faktorëve ergonomikë
- aktivitetit fizik të pamjaftueshëm.

Këto sëmundje ndikojnë drejtpërdrejt në produktivitetin e popullatës aktive.

SËMUNDJET MALINJE

Tumoret shfaqen kryesisht në moshat mbi 55 vjeç.

Më të shpeshtat:

- kanceri i mushkërive
- kanceri i gjirit
- kanceri i kolonit
- kanceri i prostatës

Këto rezultate tregojnë rëndësinë e skriningut dhe diagnostikimit të hershëm.

SHËNDETI MENDOR

Çrregullimet mendore shfaqen kryesisht në moshat aktive. Dominuan:

- çrregullimet neurotike
- çrregullimet e disponimit
- shizofrenia

Kjo tregon rritjen e barrës së stresit dhe presionit social.

ANALIZA SIPAS GRUPMOSHAVE

Morbiditeti rritet ndjeshëm me moshën.

Fëmijët-

Dominim i sëmundjeve respiratore dhe astmës.

Moshat aktive- Dominim i:

- dhimbjeve të shpinës
- diabetit
- çrregullimeve mendore

Të moshuarit Grupi më i rrezikuar për:

- hipertension
- COPD
- tumore
- insuficiencë renale

ANALIZA SIPAS GJINISË

Femrat:

- më shumë hipertension
- më shumë probleme muskuloskeletale

Meshkujt:

- më shumë sëmundje respiratore
- më shumë tumore të mushkërive

TENDENCAT MUJORE

Janar:

- kulm i sëmundjeve respiratore

Shkurt:

- stabilizim i situatës

Mars:

- rritje e problemeve muskuloskeletale

DISKUTIM EPIDEMIOLOGJIK

Struktura e morbiditetit reflekton tranzicionin epidemiologjik drejt sëmundjeve kronike jo-ngjitëse dhe nevojën për ndërhyrje parandaluese.

PËRFUNDIME


Morbiditeti dominohet nga sëmundjet kronike. Popullata e moshuar mbetet grupi më i rrezikuar.


REKOMANDIME


- Skrining për hipertension dhe diabet
- Programe kundër duhanpirjes
- Promovim i aktivitetit fizik
- Skrining për kancer
- Fuqizim i shërbimeve të shëndetit mendor

Sëmundjet Kryesore


Të dhënat tregojnë prevalencë të lartë të hipertensionit, sëmundjeve respiratore kronike, diabetit dhe sëmundjeve të shtyllës kurrizore.







Semundje_te_shtylles_kurrizore (Jan-Mar 2026)



Vaksinimi dhe imunizimi

Vaksinimi paraqet një nga masat më efektive të shëndetit publik për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës. Shërbimet e imunizimit në komunën tonë ofrohen në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe njësisë përkatëse, në përputhje me Programin Kombëtar të Imunizimit.


Gjatë periudhës raportuese është vazhduar administrimi i vaksinave të rregullta për fëmijë sipas kalendarit të vaksinimit, si dhe janë ndërmarrë aktivitete për identifikimin dhe vaksinimin e fëmijëve me doza të paplota. Niveli i mbulueshmërisë me vaksina mbetet një indikator i rëndësishëm i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe kërkon angazhim të vazhdueshëm për ruajtjen e standardeve të larta të imunizimit.

Sfidat kryesore përfshijnë lëvizjen e popullsisë, hezitimin ndaj vaksinimit në raste të caktuara dhe nevojën për fuqizimin e aktiviteteve informuese dhe edukative për qytetarët.

Mbulueshmeria me vaksinim të rregullt të femive 0-15 muaj – Janar – Maj 2026

Emertimi i vaksinës	%	Numri i të vaksinuarve
BCG në lindje	37%	294
Hep.B ne lindje	37%	294
DTaP-IPV-Hib 1/HepB/hexa	42%	330
DTaP-IPV-Hib 2/Penta	45%	350
DTaP-IPV-Hib 3/HepB/hexa	36%	281
Rota 1	41%	324
Rota 2	43%	338
PCV 1	42%	330
PCV 2	45%	350
PCV 3	36%	281
MMR 1 (12-15 muaj)	48%	376
DTaP-IPV-Hib (12-15 muaj)Penta	30%	242

MBULESHMËRIA ME VAKSINIM TË RREGULLT TË FËMIJËVE 0 - 15 MUAJ



Numri i vizitave, shërbimeve dhe aktiviteteve sipas njësive organizative

#	MJEKËSIA FAMILIARE		EMERGIENCA		VAKSINIMI		STOMATOLOGJIA		LABORATORI		RTG		PARKU VOZITËS				BARNATORJA				GJITHSEJ	
	vizita	shërbime	vizita	shërbime	vizita	shërbime	vizita	shërbime	vizita	shërbime	vizita	shërbime	v. urbane		v. ndërrurbane		receptura		furnizimet		vi- zita/ raste	shër- bime
													raste	shërbime	raste	shërbime	pacienta	shërbime	nr. i furniz.	ortikuj		
janar	11200	14413	3460	6246	475	1067	1097	3597	2519	60626	216	300	152	0	12	0	1471	4643	63	775	20602	90955
shkurt	11486	14203	2702	5007	297	651	1608	4008	2556	64543	270	440	152	0	12	0	1260	1805	63	572	20343	90720
mars	11587	14625	3034	5854	394	847	1187	3842	2282	53919	251	450	238	0	11	0	1552	2248	80	921	20536	81865
prill	12063	15142	3039	5643	200	369	1118	3249	2516	66419	252	400	306	0	22	0	3589	4738	78	1082	23105	96038
maj	10767	13748	3159	5932	478	970	1106	3191	2353	64853	246	393	318	0	22	0	2896	3678	58	598	21345	92823
g j i t h s e j	57103	72131	15394	28682	1844	3904	6116	17887	12226	3E+05	1235	1983	1166	0	79	0	10768	17112	342	3948	105931	452401

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Rajonin e Mitrovicës sipas QRSHP-së JANAR

Sëmundjet/shkaktarët	Viti 2024		viti 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	0	0	0	0
ITPR - Pneumonia/ARI	174	86.7	93	46.3
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	0	0	0	0
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	2139	1066.1	1102	549.2
Influenca A	24	11.9	0	0
Influenca B	107	53.3	0	0
RSV	0	0	0	0
Rhinovirus	0	0	0	0
Diarea acute	810	403.7	450	224.2
Variçela	83	41.3	54	26.9
Sindromi meningjeal	0	0	1	0.5
EHSV	0	0	0	0
Helmimet me ushqim	0	0	5	2.5
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus	0	0	0	0
Rota virus	0	0	0	0
Salmonella enteritidis	2	1	0	0
Shigelloza	0	0	0	0
Gastroenterokolitet	0	0	0	0
Hepatiti akut B	1	0.5	0	0
Hepatiti akut C	0	0	0	0
E.coli patogjene	0	0	0	0
Parotiti epidemik	0	0	2	1
Dyshim ne Pertussis	0	0	0	0
Tularemia	1	0.5	0	0
Brucelosis	0	0	0	0
Dyshim ne Morbill	0	0	0	0
Dyshim ne Rubeoll	0	0	0	0
Sëmundja Lyme	0	0	0	0
HIV/AIDS	0	0	0	0
IST	1	0.5	0	0
TBC raste te reja	0	0	0	0
Kafshim qeni	0	0	0	0
*Sëmundjet tjera ngjitëse	66	32.8	5	2.5
Gjithsej	3409	1699.1	1712	853.3

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Rajonin e Mitrovicës sipas QRSHP-së

SHKURT

Sëmundjet/shkaktarët	Viti 2024		viti 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	0	0	0	0
ITPR - Pneumonia/ARI	148	73.7	59	29.4
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	0	0	0	0
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	1895	944.5	529	263.6
Influenca A	21	10.4	0	0
Influenca B	111	55.3	0	0
RSV	0	0	0	0
Rhinovirus	0	0	0	0
Diarea acute	601	299.5	409	203.8
Variçela	49	24.4	41	20.4
Sindromi meningjeal	0	0	2	1
EHSV	0	0	0	0
Helmimet me ushqim	0	0	23	11.4
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus	0	0	0	0
Rota virus	0	0	0	0
Salmonella enteritidis	0	0	1	0.5
Shigelloza	0	0	0	0
Gastroenterokolitet	0	0	0	0
Hepatiti akut B	0	0	1	0.5
Hepatiti akut C	0	0	0	0
E.coli patogjene	0	0	0	0
Parotiti epidemik	0	0	0	0
Dyshim ne Pertussis	0	0	0	0
Tularemia	1	0.5	0	0
Brucelosis	0	0	0	0
Dyshim ne Morbill	0	0	0	0
Dyshim ne Rubeoll	0	0	0	0
Sëmundja Lyme	0	0	0	0
HIV/AIDS	0	0	0	0
IST	0	0	0	0
TBC raste te reja	0	0	0	0
Kafshim qeni	0	0	0	0
*Sëmundjet tjera ngjitëse	45	22.4	11	5.5
Gjithsej	2868	1429.5	1076	536.3

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Rajonin e Mitrovicës sipas QRSHP-së

MARS

Sëmundjet/shkaktarët	Viti 2025		viti 2026	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	0	0	0	0
ITPR - Pneumonia/ARI	120	59.8	73	36.3
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	0	0	0	0
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	1112	554.2	582	290
Influenca A	5	2.4	0	0
Influenca B	22	10.9	0	0
RSV	0	0	0	0
Rhinovirus	0	0	0	0
Diarea acute	458	228.2	504	251.2
Variçela	49	24.4	45	22.4
Sindromi meningjeal	0	0	3	1.5
EHSV	0	0	0	0
Helmimet me ushqim	1	0.5	16	8
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus	0	0	0	0
Rota virus	0	0	0	0
Salmonella enteritidis	5	2.4	0	0
Shigelloza	0	0	0	0
Gastroenterokolitet	0	0	0	0
Hepatiti akut B	0	0	0	0
Hepatiti akut C	0	0	0	0
E.coli patogjene	0	0	0	0
Parotiti epidemik	2	1	1	0.5
Dyshim ne Pertussis	0	0	0	0
Tularemia	0	0	0	0
Brucelosis	0	0	0	0
Dyshim ne Morbill	0	0	0	0
Dyshim ne Rubeoll	0	0	0	0
Sëmundja Lyme	0	0	0	0
HIV/AIDS	0	0	0	0
IST	0	0	0	0
TBC raste te reja	0	0	0	0
Kafshim qeni	0	0	0	0
*Sëmundjet tjera ngjitëse	54	22.4	9	4.5
Gjithsej	1802	898.1	1233	614.5

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat,erizipella

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Rajonin e Mitrovicës sipas QRSHP-së

PRILL

Sëmundjet/shkaktarët	Viti 2024		viti 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	0	0	0	0
ITPR - Pneumonia/ARI	105	52.3	85	42.3
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	0	0	0	0
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	598	298	484	241.2
Influenca A	0	0	0	0
Influenca B	0	0	0	0
RSV	0	0	0	0
Rhinovirus	0	0	0	0
Diarea acute	566	281.6	0	0
Variçela	30	14.9	48	24
Sindromi meningjeal	0	0	2	1
EHSV	0	0	0	0
Helmimet me ushqim	34	14.9	16	8
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus	0	0	0	0
Rota virus	0	0	0	0
Salmonella enteritidis	0	0	0	0
Shigelloza	0	0	0	0
Gastroenterokolitet	0	0	0	0
Hepatiti akut B	1	0.5	0	0
Hepatiti akut C	0	0	0	0
E.coli patogjene	0	0	0	0
Parotiti epidemik	0	0	0	0
Dyshim ne Pertussis	0	0	1	0.5
Tularemia	0	0	0	0
Brucelosis	0	0	0	0
Dyshim ne Morbill	0	0	0	0
Dyshim ne Rubeoll	0	0	0	0
Sëmundja Lyme	0	0	0	0
HIV/AIDS	0	0	0	0
IST	0	0	1	0.5
TBC raste te reja	0	0	0	0
Kafshim qeni	0	0	0	0
*Sëmundjet tjera ngjitëse	5	2.5	3	1.5
Gjithsej	1373	684.3	1110	553.2

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster,Erizipella

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Rajonin e Mitrovicës sipas QRSHP-së
MAJ

Sëmundjet/shkaktarët	Viti 2025		viti 2026	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	0	0	0	0
ITPR - Pneumonia/ARI	85	42.3	59	29.4
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	0	0	0	0
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	491	244.7	346	172.4
Influenca A	0	0	0	0
Influenca B	0	0	0	0
RSV	0	0	0	0
Rhinovirus	0	0	0	0
Diarea acute	646	321.9	409	203.8
Variçela	43	21.4	38	18.9
Sindromi meningjeal	0	0	0	0
EHSV	0	0	0	0
Helmimet me ushqim	0	0	21	10.40
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus	0	0	0	0
Mononukleozë infektive	0	0	0	0
Salmonella enteritidis	2	1	0	0
Shigelloza	0	0	0	0
Gastroenterokolitet	0	0	0	0
Hepatiti akut B	1	0.5	0	0
Hepatiti akut C	0	0	0	0
E.coli patogjene	0	0	0	0
Parotiti epidemik	1	0.5	0	0
Dyshim në Pertussis	0	0	0	0
Tularemia	0	0	0	0
Brucelosis	0	0	0	0
Dyshim në Morbill	1	0.5	0	0
Dyshim në Rubeoll	0	0	0	0
Sëmundja Lyme	0	0	0	0
HIV/AIDS	0	0	0	0
IST	1	0.5	1	0.5
TBC raste të reja	0	0	0	0
Kafshim qeni	0	0	0	0
*Sëmundjet tjera ngjitëse	61	30.4	12	6
Gjithsej	1332	663.9	886	441.6

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, mikozat, candida

SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË RAJONIN E MITROVICES JANAR

SËMUNDJA	Pneumonia/ARI	ILI	Diarrhea ac	Varicella	Sindroma meningociale	Parotitis epidemike	Helmintimet me ushqim	Entamoeba histolytica	Sëm.tjera ngjitëse	Erizipela	Totali
KOMUNA											
MITROVICË	87	880	375	26		1	4		4	1	1378
SKËNDERAJ	6	141	49	15							211
VUSHTRRI	0	81	26	13	1	1	1				123
TOTALI	93	1102	450	54	1	2	5		4	1	1712

*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

** Raste të importuara- Malarie, Mpox, Morbiill

SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË RAJONIN E MITROVICES SHKURT

SËMUNDJA	Pneumonia/ARI	ILI	Diarrhea ac	Varicella	Sindroma meningociale		Hepatitac. B	Helmimet me ushqim	Salmonelloza	Infeksionet streptokoksinë të gr. A	Sëm.tjera ngjitëse	Totali
KOMUNA					Meningococci	Sepsis Meningococica						
MITROVICË	49	430	319	29			1	2			10	840
SKËNDERAJ	1	80	64	4				1				150
VUSHTRRI	9	19	26	8	1	1		20	1	1		86
TOTALI	59	529	409	41	1	1	1	23	1	1	10	1076

**Sëmundjet tjera infektive: Herpes Zooster, Erizipella, mikoizat

SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË RAJONIN E MITROVICES MARS

SËMUNDJA					Suaro a					
KOMUNA	Pneu monia /ARI	ILI	Diarrhea ac	Variçella	Meningji t serosa	Parotitis epidemic	Helminet me ushqim	Sëm.tjer a ngjitëse	Erizipela	Totali
MITROVICË	73	475	388	21	2		1	8		968
SKËNDERAJ	0	83	54	15			2		1	155
VUSHTRRI	0	24	62	9	1	1	13			110
TOTALI	73	582	504	45	3	1	16	8	1	1233

**Sëmundjet tjera infektive: Herpes Zooster, Erizipella, mikoizat

SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË RAJONIN E MITROVICES PRILL

anex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave Prilli 2

SËMUNDJA						Suaro a					
KOMUNA	Pneumon ia/ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Variçell a	Meningji t serosa	Helmine t me ushqim	IST	Sëm.tjer a ngjitëse	Erizip ela	Totali
MITROVICË	77	0	411	366	20		0		3	1	878
SKËNDERAJ	2	0	54	55	19		1				131
VUSHTRRI	6	0	19	49	9	2	15	1			101
TOTALI	85	0	484	470	48	2	16	1	3	1	1110

*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykostat, Mononucleoza

** Raste të importuara- Malarie, Mpox, Morbiill

SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË RAJONIN E MITROVICES MAJ

SËMUNDJA									
KOMUNA	<i>Pneumonia/ARI</i>	<i>ILI</i>	<i>Diarrheac</i>	<i>Variçella</i>	<i>Helmimet me ushqim</i>	<i>IST</i>	<i>Sëm.tjera ngjitëse</i>	<i>Erizi pela</i>	<i>Totali</i>
MITROVICË	52	301	282	23	1		9	1	669
SKËNDERAJ	2	37	41	5					85
VUSHTRRI	5	8	86	10	20	1		2	132
TOTALI	59	346	409	38	21	1	9	3	886

*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

** Raste të importuara- Malarie, Mpox, Morbiill

**Sëmundjet tjera infektive: Herpes Zooster, Mikoizat

Ky raport paraqet një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes shëndetësore të popullatës në Komunën e Mitrovicës, duke u bazuar në të dhënat dhe informacionet e siguruar nga Qendra Rajonale e Shëndetit Publik (QRShP), Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe në bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Shëndetësisë.

Të dhënat e paraqitura synojnë të ofrojnë një vlerësim të situatës aktuale shëndetësore, nevojave të qytetarëve, sfidave ekzistuese dhe prioritetëve për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore.

Drejtoria e Shëndetësisë mbetet e përkushtuar në forcimin e kujdesit parësor shëndetësor, përmirësimin e qasjes së qytetarëve në shërbime cilësore, promovimin e shëndetit dhe zbatimin e masave parandaluese në bashkëpunim me institucionet relevante.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut



02-052/01-VJ33947/16
11.06.26

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIMIT RURAL

DATË/A	09.06.2026
REFERENC-Ë	
PËR/ZA:	z.Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit - Këshilltarët Komunal në Mitrovicë
PËRMES/PREKO/THROUGH	z.Faton Peci - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM	Remzije Tmava Tupella Drejtoresh e Drejtorisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Informat Planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026

Të nderuar,

Sipërfaqja e gjithëmbarshme e Komunës së Mitrovicës është rreth 33.596 ha prej të cilave 5.600 ha tokë të punuar, ku 400 ha pas luftës së fundit janë tjetërsuar nga ndërtimet e egra dhe gjithësejtë kanë mbetur 5.200 ha tokë e punuar. Mbrenda komunës së Mitrovicës ka ndryshime të konsiderueshme si në kultivimin e kulturave bujqësore po ashtu edhe në sipërfaqet e tokës (madhësinë e fermës). Në disa pjesë (fshatra) të komunës së Mitrovicës ka dallime në zhvillimin e sektorëve të bujqësisë.

Mund të thuhet se pjesë e madhe e territorit të Komunës është mbuluar me tokë pjellore dhe ka klimë të përshtatshme që garanton prodhimtari ekonomike dhe profitabilitet të drithërave, pemëve, perimeve dhe blegtorisë.

Tabela me të dhëna të planifikuara dhe të realizuara me mbjellje të kulturave pranverore për vitin 2026

Nr.	KULTURAT	Sipërfaqja e planifikuar/ha	Sipërfaqja e realizuar/ha
1.	Misër për kokërr	650	610
2.	Misër me fasule	30	25
3.	Misër i gjelbër	80	70
4.	Elb	7	4
6.	Tërshër	110	70
7.	Bimë furagjere	1550	1540
8.	Bimë industriale		
9.	Perime në serra	10.93	10.93
10.	Perime ne fushë te hapur	180	160
11.	Patate	150	140
12.	Fasule monokultur	4	3


*Shenim: Bimë foragjere janë: jongja, terfili, leguminozet etj në përgjithësi përdorën si ushqime për kafshë.

- Furnizimi është bërë nga tregtret vendor
 - Çmimet e farës së misërit sillet nga 40 € deri 52 €/thes.
 - Çmimet e plehut artificial sillet nga 0.58 € deri 0.62 €/kg.
- Kushtet e pa favorshme klimatike kan ndiku në vështërsit e mbjelljes



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



DATË/A:	18.06.2026
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi, Kryesues i Kuvendit të Komunës në Mitrovicën e Jugut
NGA/OD/FROM:	z. Shefki Begu, Drejtor i Arsimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Sqarim lidhur me zëvendësimin e mësimdhënësve dhe kompensimin e orëve të humbura mësimore



I nderuari Kryesues,

Duke pasur parasysh se në seancën e fundit të kuvendit u ngritën pyetje lidhur me zëvendësimin e mësimdhënësve dhe kompensimin e orëve të humbura mësimore, si dhe në përputhje me kërkesën tuaj që në seancën vijuese të ofrohet një përgjigje me shkrim, më poshtë po paraqesim sqarimet lidhur me këtë çështje.

Fillimisht, është me rëndësi të theksohet se situata me orët mësimore të pambajtura nuk është krijuar gjatë kësaj periudhe, por paraqet një gjendje të trashëguar nga periudhat e mëhershme. Ne kemi ndërmarrë veprime konkrete për menaxhimin dhe adresimin e pasojave të kësaj situate.

Sistemi arsimor ka qenë i ngarkuar me norma përtej kufijve të përcaktuar nga qarkorja buxhetore, gjë që ka pamundësuar shpalljen e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës. Megjithatë, Drejtoria e Arsimit ka ndërmarrë masat e nevojshme për stabilizimin e gjendjes dhe garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor, duke angazhuar mësimdhënës me kualifikime përkatëse përmes orëve shtesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Falë këtyre masave, është arritur të realizohen rreth 99% e orëve mësimore, duke minimizuar ndikimin e mungesave të stafit në procesin edukativo-arsimor dhe duke siguruar vazhdimësinë e tij.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	26.05.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0028867-3/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 26.05.2026, pasi shqyrtoi Raportin e punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Raportin e punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025.
2. Raporti i punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025 i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Raporti i punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	26.05.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0028867-2/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 26.05.2026, pasi shqyrtoi Raportin mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Raportin mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026.
2. Raporti mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026 i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Raporti mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026*